



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Librazhd**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë**

**BASHKIA LIBRAZH D**

**Tiranë, 2024**

<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3-7
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-5
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	7-11
1	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2	Identifikimi i çështjes	7-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-8
5	Kriteret e Vlerësimit	8-10
6	Standartet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-11
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	11-85
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11-12
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	12-85
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	12-14
2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	15-17
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2023	17-32
2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023	33-36
2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	36-68
2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	68-73
2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	73-77
2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	77-85
2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	85-85
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	86-98
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	98-104

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e **Librazhdit** është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe gjashtë ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 7 njësi administrative si vijon: njësia administrative Librazhd (qyteti), njësitë administrative Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis dhe Orenjë. Qyteti i Librazhdit.

**Misioni** i Bashkisë Librazhd është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë** Librazhd si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Librazhd si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, përperiudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Librazhd. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Shënim:** Çështja; “Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023” nuk është shqyrtuar nga Grupi i KLSH për arsye se, auditimi në terren u krye në kohën apo gjatë afatit ligjor deri 31 mars 2024 të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2023 dhe nuk u bë mundur auditimi i saktësisë dhe plotësisë së informacionit kontabël në lidhje me transaksionet financiare dhe mbylljen e llogarive financiare të kësaj njësie shpenzuese.

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të

likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodën e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe ka dhënë 28 rekomandime, nga ku masa organizative me 12 gjetje dhe 23 rekomandime, 2 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **362,915 lekë** dhe 2 gjetje-rekomandime në vlerën 11,255,000 lekë në fushën e të ardhurave.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- **Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit**
  - Në **2 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 362,915 lekë** projektet e investimit me objekt: “*Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Polis*” dhe “*Rikonstruksion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis*”.
  - Në të dyja rastet e mësipërme rezultuan diferenca në volume pune të pakryera.
- **Procedurat e prokurimit publik** për punë publike, mallra dhe shërbime:
  - Në **5 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.
  - Në **4 raste** kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.
- **Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit**
  - Në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore.
  - në **2 (dy) raste**, Bashkia Librazhd nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.
  - në **1 (një) rast** Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve (DPZHMT), Bashkia Librazhd ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të lejes së zhvillimit.
  - Në **1 (një) rast**, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Librazhd, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit.
- **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**
  - Të ardhura të munguara në vlerën 9,049 mijë lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjare.
  - Të ardhura të munguara në vlerën 83,713 mijë lekë nga detyrimet tatimore, detyrime të cilat janë detyrime nga biznesi i madh, i vogël etj.,
  - Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi nga 7 kundravajtës i vlerës prej 3,855,000 lekë të gjobave të vëna nga IMT.
  - Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë dhe detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerën 2,206 mijë lekë.

#### **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe rregjistrimin e aseteve**

Nga auditimi pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Librazhd dhe Njësi Administrative Orenjë, Polis, Qendër Bashkia Librazhd, Stebleve, Hotolisht, Lunik nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë

të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

- Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **4,484 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **1,446 pasuri në pronësi** dhe **2,941 pasuri në përdorim**. Në total në pronësi të Bashkisë Librazhd janë 1,446 pasuri nga të cilat 228 pasuri janë certifikuar deri më 2023 pasuri janë të pajisura me certifikatë pronësie dhe 1011 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie. Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura.

**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **224,115 lekë pa tvsh** nga OE “B ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1424 prot datë 16.03.2023, me objekt “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjia Mirakë Plane Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

- Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **138,800 lekë pa tvsh** nga BOE “A ” ShPK & “Z ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1967 prot datë 11.04.2023, me objekt “Rikonstrukcion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

- Njësia e Prokurimit Bashkia Librazhd, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

- Kryetari i Bashkisë Librazhd për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

- Nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla.

- Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd duhet të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve, siç janë: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, të hartuara sipas dispozitave ligjore, rregullatorë dhe normativave, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me certifikatën paraprake të energjisë, ngarkimi në sistem i të gjithë dokumentacionit shoqërues për profesionistët që kanë hartuar projektet ndërtimore, etj.

- Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd duhet të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në

sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve, siç janë: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, të hartuara sipas dispozitave ligjore, rregullatorë dhe normativave, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me çertifikatën paraprake të energjisë, ngarkimi në sistem i të gjithë dokumentacionit shoqëruar për profesionistët që kanë hartuar projektet ndërtimore, etj.

- Nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT) dhe Bashkia Librazhd të marrin të gjitha masat për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi në mungesë të lejes së zhvillimit ose Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore ku ndodhet parcela në zhvillim.

- Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, për pasurit e pa regjistruara, të marrin masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Librazhd.

- Bashkia Librazhd të marrë masa për eliminimin e praktikave të marrjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, me qëllim uljen e rrishtit për lindjen e detyrimeve shtesë financiare, si rezultat i mos respektimit të detyrimeve kontraktuale me kontraktorët.

- Bashkia Librazhd, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerë **9,049 mijë lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

### **Për auditimin e përputhshmërisë.**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Librazhd për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

### **Opinionin:**

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Bashkia Librazhd janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar/kualifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

### **Baza për opinionin:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Bashkisë Librazhd rezultuan:

- Në auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike të lidhura nga Bashkia Librazhd, rezultoi se janë kryer likuidime në vlerën **362** mijë lekë pa TVSH, për punime të pakryera, me efekt dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit janë konstatuar mangësi në hartimin e kërkesave

për kualifikim, që lidhen me kapacitetet teknike, specifikimet teknike, dhe informacionin tjetër specifik i nevojshëm, në argumentimin teknik, të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit dhe disponimit të fuqisë punëtore dhe makineri-pajisjeve nga ana e OE për realizimin e kontratës sipas specifikimeve teknike.

- Në **4** procedura prokurimi të audituara nga Bashkia Librazhd, me vlerë kontrate **173,898 mijë lekë** pa TVSH, OE/BOE e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura.

- Mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për asete të marra me qira, në vlerën **2,206** mijë lekë pa TVSH, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

- Mos respektimin e detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për asete të marra me qira, në vlerën **2,206** mijë lekë pa TVSH.

- Bashkia Librazhd në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në **7 raste** nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi dhe çertifikatë përdorimi.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 32/1, datë 10.01.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-<sup>së</sup>, nga data 15.01.2024 deri në datë 16.02.2024, në subjektin Bashkia Librazhd për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë”, për prokurimet nga data 01.05.2023 deri në 31.12.2023, nga grupi i auditimit me përbërje:

1.A.G, auditues, përgjegjës grupi;

2.E.S, auditues;

3.A.D, auditues;

4.A.Z, auditues;

5.P.XH, auditues.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1.Objektivat e auditimit.

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Librazhd kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Librazhd është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### **Identifikimi i çështjes.**

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Librazhd, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Planifikimi, realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i kontratave të lidhura për investime në punë publike;
6. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
7. Planifikimi dhe zhvillimi i teritorrit;
8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Niveli drejtues i Bashkisë Librazhd (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontroleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit. Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Librazhd, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Librazhd kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

### **Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra



nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

**Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera

nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimit, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njesisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfytesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periodhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën

gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit*<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohem nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

*Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **Dokumentimi i auditimit.**

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse

<sup>1</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksionin të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt-Konstatimeve dhe Akt-Verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projektraport Auditimi.

### **III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Librazhd”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

#### **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

##### **2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin i Brendshëm.**

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;

8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësi i Vetëvlerësimit.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Krijimi dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në njësitë e sektorit publik është thelbësor për sigurimin e mirëmenaxhimit financiar, që mundëson realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në mënyrë etike, duke shfrytëzuar burimet në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente. Për shkak të kompleksitetit të tij, sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të përshatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, proces i cili realizohet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, performuar dhe raportuar nga nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme si dhe nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm e të jashtëm.

Në drejtim të vlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Librazhd, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimin e objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

**Situata:** Bazuar në vlerësimin e kryer për zhvillimin dhe funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2023, janë evidentuar devijime të nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi për fushën e kontrollit të brendshëm të cilat në gjykimin profesional të grupit të auditimit ndikojnë në progresin e funksionimit të këtij sistemi dhe justifikojnë paraqitjen e një konkluzioni për vlerësimin e kryer, duke e vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm pjesërisht efektiv.

Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

**“Mjedisi i Kontrollit”**

- Nuk dokumentohet komunikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2023 mbi rregulloren e brendshme.
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Librazhd për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.
- Për vitin 2023 nuk është hartuar dhe miratuar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Gjithashtu në rregulloren e brendshme, jo për çdo strukturë të Bashkisë Librazhd, përcaktohet afat për raportimin ndaj eprorit, mbi realizimin e planit të punës/objektivave.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar (Sektori juridik, prokurimeve dhe apelimit tatimor është bërë Sektori Juridik dhe i Prokurimeve; Po kështu edhe Sektori i Burimeve Njerëzore, Administratës, Arkivit, Protokollit, Sekretarisë duke kaluar në nivel Drejtorie, etj) pavarësisht ndryshimeve që

ka pësuar struktura e Bashkisë Librazhd, ç'ka ndikon negativisht në linja të qarta raportimi, komunikimi dhe llogaridhënie.

- Gjithashtu konstatohet anomali në strukturën e ndryshuar me Urdhrin nr.747, datë 07.07.2023, për vitin 2023, ku Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, është në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Pra nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i bashkisë (pra Kryetarit të Bashkisë Librazhd).

- Në Bashkinë Librazhd nuk janë hartuar “Hartat e proçeseve të punës”.

- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA.

-Konstatohet se nga GMS nuk janë zbatuar plotësisht detyrat e përcaktyara në pikën 5 të nenit 13 në rregulloren e brendshme të Bashkisë Librazhd, të cilat janë si më poshtë vijon:

- Miratimin e strategjisë së riskut – Nuk dokumentohet hartimi i strategjisë së riskut, i cili më pas t’i vendoset në dispozicion GMS për miratim.

- Menaxhimin efektiv të riskut në të gjithë bashkinë – Nuk dokumentohet asnjë masë e marrë nga GMS për të kërkuar nga të gjitha strukturat e Bashkisë Librazhd, që të hartojnë regjistrinë e riskut<sup>2</sup>, me qëllim miratimin dhe menaxhimin e tij.

- Miratimin e planit të veprimit për reagimin ndaj risqeve – Nuk dokumentohet miratimi i regjistrit të riskut.

- Zbatimin e planit të veprimit dhe planit të kontrollit gjatë vitit vlerësimin përfundimtar të risqeve të identifikuar në bashki – Nuk dokumentohet nëse GMS i është vendosur në dispozicion regjistri i riskut dhe plani i veprimit të MFK, me qëllim marrjen e masave për zbatimin e tij.

- Të sigurojë se regjistri i riskut për programe dhe objektiva specifike rishikohet jo më pak se dy herë në vit – Nuk është zbatuar.

-Konstatohet se përbërja e GMS nuk është në përputhje me nenin 27 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pasi nuk janë miratuar si anëtar të GMS të gjithë menaxherët e nivelit të lartë.

#### **“Menaxhimi i Riskut”**

- Nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).

- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

- Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.

- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Librazhd.

#### **“Aktivitetet e Kontrollit”**

- Bashkia Librazhd nuk ka proçedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

- Në Bashkinë Librazhd nuk ka një proçedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Në Bashkinë Librazhd, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

-Nuk ka proçedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

#### **“Informimi dhe Komunikimi”**

<sup>2</sup> Në dispozicion të grupit të auditimit është vendosur një dokument me titull “Regjistri i Riskut, viti 2023”, i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm. Ky dokument nuk nr., protokoll dhe datë, nuk është miratuar nga Titullari i Bashkisë Librazhd, nuk përfshin risqet për çdo strukturë të bashkisë, si dhe nuk është përditësuar, me qëllim vlerësimin nëse për aktivitete të vlerësuara me risk të lartë, pas marrjes së masave të parashikuara është ulur niveli i riskut. Në këtë dokument nuk pasqyrohet matrica e riskut.

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

**“Monitorimi dhe Raportimi”**

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por nuk administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Bashkia Librazhd lidhur me pyetëtorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2023 nuk e ka raportuar në MFE.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, duke ngarguar me përgjegjësi: **Znj. A.A , Drejtore e Financës dhe Buxhetit, Znj. N.B, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe R.M , Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e regjistrit të riskut.**

**2.1.1. Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Librazhd;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

**Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.**

Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 1061 datë 30.12.2022, i ndryshuar, si pjesë përbërëse e strukturës organizative për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 104 datë 28.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Librazhd”. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Librazhd, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në manualin e procedurave të auditimit të brendshëm publik dhe kartën e auditimit.

Sektori i Auditit të Brendshëm në Bashkinë Librazhd është i organizuar me 3 (tre) punonjës, 1 (një) përgjegjës auditit dhe 2 (dy) specialist auditit duke u bazuar në nenin 10 në Ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe në pikën 3 të VKM-së nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e sektorit të Auditit të Brendshëm.

Struktura e njësisë AB për vitin 2023

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimi	Vjetërsi në profesion	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime	Larguar
	<b>Për vitin 2023</b>								
1.	R.M	Përgjegjës	20.07. 2023	I Lartë	35	1.6	Jo	Jo	
2.	S.K	Përgjegjës	31.03. 2023	I Lartë	6	0.7	Jo	1 herë	05.10.2023
3.	A.H	Specialiste	31.03. 2023	I Lartë			Jo	1 herë	31.07.2023
4.	I.H	Specialiste	26.06. 2023	I Lartë			Jo	1 herë	18.12.2023
5.	Z.A	Specialiste	06.12. 2023	I Lartë	0	0.2	Jo	Jo	
6.	G.T	Specialiste		I Lartë	3	3	Po	Po	07.02.2023

**Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023.**

Për vitin 2023, plani vjetor i auditimeve i miratuar, përcaktuar për auditim 9 subjekte, është përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE me shkresën nr.9740/1 prot., datë 20.10.2022. Në zbatim të planit vjetor, janë miratuar programet për auditimin e 4 subjekteve, si më poshtë:

Nr	Periodha	Të dhëna sipas raportimit									
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit						IT	Zb.Rek
				Përputh	Financ	Kombin	Perform	Tematik			
1	Viti 2023	9	4	2	1	1					

Nr	Subjektet e audituara
1	Klubi i Futbollit “Sopot” Sh.A
2	Sektori i Mbrojtës Civile
3	Drejtoria e Shërbimit pyjor
4	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social

-Për aktivitetin e vitit 2023 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 640 prot., datë 12.02.2024.

-Plani strategjik 2023-2025 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 6669 prot., datë 17.10.2023.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, rezulton se janë dhënë 28 rekomandime gjithsej. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave janë zbatuar 4 dhe 24 janë në proces zbatimi. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa Zbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2023	28	4	24		3	1		2
<b>Totali</b>		<b>28</b>	<b>4</b>	<b>24</b>		<b>3</b>	<b>1</b>		<b>2</b>

Burimi: NJAB Librazhd, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Për vitin 2023, struktura e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “b” të pikës 2 në nenin 11 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pasi drejtuesi i NJAB, z. R.M , nuk plotëson 2 kritere, të cilat janë: Certifikimin si auditues i brendshëm dhe përvojë pune në auditim jo më pak se 3 vjet.

-Gjithashtu struktura nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, sipas të cilës NJAB përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, ndërkohë janë të punësuar vetëm 2, si dhe nuk janë certifikuar si auditues të brendshëm.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm.

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit.

-Nuk është kryer vlerësimi i riskut për çdo subjekt/fushë që përbën objekt të auditimit nga NJAB. Konkretisht nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se vlerësimi i riskut është bërë për 9 subjekte/fusha auditimi, ndërkohë janë 21 subjekte/fusha objekt i punës audituese të NJAB Bashkia Librazhd.



-Për vitin 2023 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për t'u kryer 9 auditime dhe janë kryer 4 gjithësej.

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Librazhd, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Prokurimeve, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, pasi për fusha të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit.

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2023 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së miratuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe për çdo rekomandim të pazbatuar.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri i MFE nr.4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016", lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2023, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi R.M, Përgjegjes i Sektorit të Auditit të Brendshëm.*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me shkronja "b" në nenin 6, pika 1 në nenin 9, shkronja "b" në pikën 2 në nenin 11, shkronja "b" në nenin 12, shkronjat "a" dhe "ç" në nenin 14, shkronja "d" në nenin 16 të Ligjit nr.114/2015 "Për Auditin e Brendshëm Publik", i ndryshuar; Pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar; Neni 21 në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016"; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, planifikimi i veprimtarisë audituese, plani strategjik, afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor.

## **2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2023.**

### **➤ Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;

4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;

5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;

6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.

7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;

8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin "EXCEL", si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023.**

- Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.54 datë 21.01.2022 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 9 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxheti i vitit 2023, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

-Kryetari i Bashkisë ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, i cili, është miratuar me VKB nr.100 datë 29.12.2021, i konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr. prot 1465/1 datë 10.01.2022 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1.

-Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është miratuar me VKB nr.63, datë 29.07.2022 nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025" dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

- Në këtë programim është përgatitur dhe përfshirë Instrumenti të planifikimit financiar , shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është dërguar në MFE me shkresën nr.prot.4077, datë 15.09.2022 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarinja e ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimit e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2023-2024-2025.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZSHH. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2023-2025 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Librazhd në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe

-Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projekt-buxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”.

- Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 107, datë 28.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 25/1 datë 13/01/2023, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	166,861	
2	Të ardhura nga Transferata e Pakushtëzuar	330,723	
3	Të ardhura nga Transferata e Pakushtëzuar Sektoriale	157,075	
4	Paga (600)		228,211
5	Sigurime shoqërore (601)		36,810
6	Shpenzime operative (602)		150,853
7	Transferata (604 - 609) Fondi Rezervë		33,033
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		118,959
9	Investime ne proces		86,793
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>654,659</b>	<b>654,659</b>

Me Vendim të KB nr.12 datë 17.02.2023 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguarave nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.258/1 datë 22.02.2023, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Grant i pashperndare (detyrimet e prapambetura)	4,558	
2	Transferatë e pakushtëzuar e papërdorur	110,347	
3	Të ardhurta të trashëguara	78,184	
4	Të çelura të papërdorura	14,431	
5	Transferatë e pakushtëzuar sektoriale e papërdorur	19,954	
6	Paga (600)		47,575
7	Sigurime shoqërore (601)		9,371
8	Shpenzime operative (602)		19,524
9	Transferata (604 - 609) Fondi Rezervë		6,578
10	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		41,663
11	Investime ne proces		102,763
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>227,474</b>	<b>227,474</b>

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 654,659 mijë lekë dhe me trashëgimet e fondeve në vlerën 227,474 mijë lekë.

- Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan fillestar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	265,021	289,997	-24,976
2	Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	183,886	170,414	13,472
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	205,752	160,599	45,153
4	Investime nga FZSHS			
<b>Total I planit fillestar</b>		<b>654,659</b>	<b>621,010</b>	<b>33,649</b>
<b>Shtesat nga Pushteti Qendror</b>				
5	Shpenzime për pagat (600+601)			
6	Shpenzime (602.604.609)			
7	Grant i kushtëzuar (230-231)			
<b>Gjithsej</b>		<b>654,659</b>	<b>621,010</b>	<b>33,649</b>

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2023 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2023-2025, rezulton se ka diferencë prej plus 33,649 mijë lekë. Diferenca prej 33,649 mijë lekë rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA vjen si rezultat i rritjes së burimeve të financimit dhe sistemit të fondeve brenda llogarive (nga 600-609 dhe llogarisë 231) e cila është vlera e shtuar nga efekti i rritjes së pagës minimale sipas VKM Nr. 604, datë 14.9.2022” Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

➤ **Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Librazhd dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Librazhd.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Si konkluzion, nga Bashkia Librazhd janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme në të gjitha rastet për të cilat janë bërë ndryshime në buxhet gjatë vitit ushtrimor 2023.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Pakësuar/shtuar artikulli (me emër)			
	Nr./datë	Vlera	Nr./datë	Vlera	Shtesa art.	shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2023	Nr. 107, dt 28/12/2022	654,659,440	Nr.44 dt.12.05.023	893,000	Shpen.oper 602	893,000	Fond rezerv 609	893,000
			Nr.45 dt.15.05.023	479,887	Investime 231	479,887	Shpen.operative 602	479,887
			Nr.51 dt.12.05.023	99,884,423	Investim 231	99,884,423	Investim 231	99,884,423
			Nr.55 dt.30.05.023	2,514,962	Fond rezerve 609	2,514,962	Investime 231	2,514,962
			Nr.81 dt.18.08.02	3,737,104	Fond rezerve 609	3,737,104	Investime 231	3,737,104
			Nr.84 dt.18.08.023	12,547,584	Shpenz. Paga-sig 600-601	12,547,584		
			Nr.91 dt.20.09.023	3,400,000	Fond rezerve 609	3,400,000		
			Nr.101 dt.31.10.023	3,404,691	Investime 231	3,404,691	Fond rezerve 609	1,836,654
							Investime 231	1,568,037

Burimi: Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Librazhd

➤ **Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Librazhd, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Librazhd, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2023, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat

e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. nga auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Librazhd u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	299,973	271,965	91
2	Sigurime shoqërore 601	50,665	44,625	88
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	177,991	125,207	72
4	Transferime 604(Kësh.Qarkut,e-civile ,Sporti)	20,467	20,078	98
5	Nd/Ekonom invalid 606	582,802	547,884	94
6	Investime (230/231 )	486,153	399,628	82
7	Mjete ne ruajtje 466		12,922	
8	Grant i pashpërndarë në fund të vitit	45,086		
	<b>Totali</b>	<b>1,663,137</b>	<b>1,422,309</b>	<b>85%</b>

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2023** janë realizuar 1,422,309 mijë lekë nga 1,663,137 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%.

Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërat e buxhetit:

a. Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 72% ky tregues vjen si rezultat i kontratave marrëveshje kuadër që shtrijnë afate kohore përtej vitit 2023.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë transferimet tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti, ndjekur nga shpenzimet për investime dhe shpenzimet për paga personeli ,tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja ndaj totalit
		Viti 2023
1.	Transferime	38%
2.	Investime	28%
3.	Shpenzime për paga	19%

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2023 është në total në shumën 16,493 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar e deri në fund të vitit buxhetor me VKB dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

- Miratimi fillestar me VKB nr. nr. 107, datë 28.12.2022 në vlerën 13,093 mijë lekë

- Shtesë fondi rezervë me VKB nr.91, datë 20.09.2023 në vlerën 3,400 mijë lekë,

Përdorimi i Fondit Rezervë në vlerën 11,213 mijë lekë, konkretisht:

-V.K.B nr.44 dt.12.05.023 bashkëfinancim ndërtim ure tip Baily në vendin Zalli i Madh Nj.Adm. Orenjë në vlerën 893 mijë lekë;

-V.K.B nr.55 datë 30.05.023 bashkëfinancim Ndërtim i shkollës së mesme Polis + palestër në vlerën 2,515 mijë lekë;

-V.K.B nr.64 dt.21.06.023 shtesë fondi për Mbikëqyrje kolaudime në vlerën 1,000 mijë lekë;

-V.K.B nr.81 dt.18.08.023 bashkëfinancim Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetë të varfëra dhe të pafavorizuara në vlerën 3,737 mijë lekë;

-V.K.B nr.91 dt.20.09.023 shtesë fondi rezervë në vlerën 3,400 mijë lekë;

-VKB nr.99 dt. 31.10.023 bashkëfinancim në projektin Mbështetje për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve komunitare dhe asistencë teknike në banesë” në vlerën 1,470 mijë lekë;

-VKB nr.101 dt.31.10 023 për “Rikonstruksion i tarracës së godinës Nj. Adm. Qendër” në vlerën 1,837 mijë lekë;

- Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2023, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6. Për vitin 2023 është dërguar “Raport monitorimi Buxhetit Janar – Prill” me shkresën nr. prot.3766 date 30.05.2023, “Raport monitorimi Buxhetit Janar – Gusht” me kërkesë të Ministrisë Financës është dërguar me email më date 25 shtator 2023, Jemi duke punuar për hartimin e Raportit të monitorimit buxhetit Janar – Dhjetor 2023.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

➤ ***Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, dhe mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij .

• ***Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara***

Me fondet e vitit buxhetor 2023, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministrinë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602	Llog. 230-231
Viti 2023	2,035,749	2,035,749	VKB nr.3 datë 30.01.2024	283,300	1,752,449

*Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave.*

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

***Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2023:***

Detyrime e NJQV	Detyrimi progresiv më 31.12.2022	Detyrimi i krijuar 01.01.2023-31.12.2023	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë 2023	Hequr me shresen nr 7894, date 20.12.2023	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022
a	1	2	3=1+2	4	5	6=3-4-5
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHH	8,534,111		8,534,111		8,534,111	
b. Investime nga Bashkia	856,474	1,752,449	2,608,923	120,000	736,474	1,752,449
<b>INVESTIME :</b>						
Mallra dhe shërbime	60,000	283,300	343,300	60,000		283,300
Vendime gjyqësore	300,000		300,000	300,000		
<b>Totali :</b>	<b>9,750,585</b>	<b>2,035,749</b>	<b>11,786,334</b>	<b>480,000</b>	<b>9,270,585</b>	<b>2,035,749</b>

*Burimi: Drejtoria ekonomike Bashkia Librazhd*

Referuar shkresës nr. 595 prot., datë 31.01.2023, “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” të Bashkisë Librazhd dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2022, detyrimet progresive të Bashkisë Librazhd, në datën 31.12.2022 kanë vlerën 9,750,000 lekë.

Nga këto detyrime janë likuiduar 480,000 lekë gjatë vitit 2023, ndërsa diferenca prej 9,270,585 lekë është për dy detyrime të paraqitura për objektet:

- Rikualifikim Urban në zonat Perëndimore të Qytetit Librazhd në vlerën 8,534,111 lekë
- Azhornim për regjistrimin fillestar të zonës kadastrale të fshatit Qarrishtë në vlerën 736,474 lekë.

Pra detyrimi sipas kontratës që Bashkia Librazhd ju ka patur kontraktorve, nuk është likuiduar, pasi kontraktorët për të njëjtën vlerë, bazuar në kontratën dypalëshe janë penalizuar nga Bashkia Librazhd për shkelje të detyrimeve kontraktuale. Për këtë arsye detyrimi nuk paraqitet më në listën e detyrimeve.

Për pretendimet e tyre ne lidhje me mbajtjen e penaliteteve, operatorët ekonomik i janë drejtuar gjykatës dhe çështja është në proces gjyqësor.

Si përfundim detyrimi në 31.12.2022 në vlerën 9,750,000 lekë është zeruar në datën 31.12.2023, pasi një pjesë e tij është likuiduar gjatë vitit 2023 (vlera 480,000 lekë), ndërsa pjesa tjetër (9,270,585 lekë), është zbritur si detyrim për arsyet e mësipërme.

Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 2,035,749 lekë, prej së cilës vlera 1,337,300 lekë ka si arsye mungesën e fondeve buxhetore nga të ardhurat e veta të Bashkisë Librazhd, ndërsa vlera prej 698,449 lekë ka si burim financimi buxhetin e shtetit.

Vlera 2,035,749 lekë përbëhet nga detyrimi për 4 fatura si më poshtë:

1- Detyrimi për faturën e datës 09.03.2023, për kontratën me objekt “Mbikëqyrje e objektit “Ndërtim i ujësjellësit të fshatit Polis Gostim, Nj.Adm.Polis”, në vlerën 698,449 lekë (me burim financimi nga buxheti i shtetit), likuiduar me urdhër shpenzimi nr 142, datë 22.02.2024

2- Detyrimi për faturën e datës 04.10.2023, për kontratën me objekt: “Hidroizolimi i shkollave dhe institucioneve”, në vlerën 54,000 lekë.

3- Detyrimi për faturën e datës 18.09.2023, për kontratën me objekt “Blerje pemë dekorative, farë bari, lule dhe pesticide etj.”, në vlerën 283,300 lekë, likuiduar me urdhër shpenzimi nr.96 datë 08.02.2024.

4-Detyrimi për faturën e datës 03.08.2023, për kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Cercan”, në vlerën 1,000,000 lekë, likuiduar me urdhër shpenzimi nr. 136, datë 22.02.2024.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

**Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. A.A me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e nëpunëses zbatuese.**

Vlera e detyrimit progresiv prej 2,035,749 lekë në datën 31.12.2023, për 4 fatura, me të dhëna të detajuara jepen në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Subjekti	Objekti I kontratës	Numri i faturës	Data e faturës	Gjendje me 31.12.2022	Pagesat gjatë vitit 2023	Shtuar gjatë vitit 2023	Hequr me shresen nr 7894, datë 20.12.2023	Gjendje në 31.12.2023
1	L SHPK	Azhor -regjistri fillestar zones kadast fsh Qarrisht faza e II	48	30.11.2019	736,474			736,474	
2	E.L	Perkthim faqesh	14/2022	21.10.2022	60,000	60,000			
3	A.P	Blerje materiale, dyer dritare alumini dhe xhama	136/2022	09.08.2022	120,000	120,000			

4	N	Mbik. Ndertim i ujes.fshatit Polis Gostim,Nj.Adm.Polis,	11/2023	09.03.2023			698,449		698,449
5	F shpk	Mbikqyrje Hidroizolimi i shkollave dhe institucioneve	36/2023	04.10.2023			54,000		54,000
6	M.B	Blerje peme deko, fare bari,lule dhe pesticide etj	30/2023	18.09.2023			283,300		283,300
7	KMK	Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Cercan	19/2023	03.08.2023			1,000,000		1,000,000
I.		<b>Totali I</b>			<b>916,474</b>	<b>916,474</b>	<b>2,035,749</b>	<b>736,474</b>	<b>2,035,749</b>
II		<b>Fatura te palikujduara me financim nga FZHR</b>							
12	V SHPK .	Rikualif urban Zona Perendim 5 Qytet Librazhd,prita lumore	5	01.09.2018	8,534,111			8,534,111	
		<b>TOTALI II</b>			<b>8,534,111</b>			<b>8,534,111</b>	
III		<b>Vendime gjyqesore te palikujduara</b>							
	Objekti vendimit	Emri i personit/subjektit	Nr.vendimi t	Vlera/leke	Gjendje me 31.12.2022	Paguar gjate Vitit 2023	Shtuar gjate vitit 2023	Hequr me shresen nr 7894,date 20.12.2023	Pa likujduar 31.12.2023
3	Kontratë investimi	Shoqeria "R "shpk	1310	2,557,933	300,000	300,000			0
		<b>TOTALI III</b>			<b>300,000</b>	<b>300,000</b>			<b>0</b>
		<b>TOTALI I Pergjithshem ME 31.12.2023 I+II+III</b>			<b>9,750,585</b>	<b>1,216,474</b>	<b>2,035,749</b>	<b>9,270,585</b>	<b>2,035,749</b>
		5% tengurtesuar			39,305,272	12,422,846	20,457,990		47,340,416

Burimi: Drejtoria ekonomike Bashkia Librazhd

Detyrimet e prapambetura për vitin 2023 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.485 prot., datë 26.01.2024 jepen në tabelën si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua sftatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>2,035,749</b>		<b>0.30%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>283,300</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime	283,300		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
<b>b</b>	<b>Shenzime kapitale</b>	<b>1,752,449</b>		
b,1	Insitucione buxhetore	1,752,449		
b,2	Subjekte private			
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>0</b>		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>2,035,749</b>	<b>675,307,742</b>	<b>0.30%</b>

### Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara (të akumuluar)** në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën **2,035,749 lekë** dhe **fondet e miratuara** për shpenzime të këtij viti janë në vlerën **675,307,742 lekë** (1,663,137,419 lekë totali i planifikuar – 710,193,325 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet; investime, -45,086,025 lekë grant i pa



shpërndarë -227,474,325 lekë buxheti i trashëguar për vitin 2023 - 5,076,002 lekë të ardhura jashtë limitit.) Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 1 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Librazhd nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2023, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është në nivelin prej 25 %, sipas nenit 56, “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre. Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të Bashkisë Librazhd.
  - Për **vitin 2023** janë planifikuar fonde për investime në shumën **486,152,432 lekë** (nga të cilat 362,432,386 lekë janë nga grant i pakushtëzuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura dhe 123,720,046 lekë transfert e kushtëzuar M. linje), realizuar dhe likjuar në vitin 2023 në vlerën 412,049,700 lekë me një realizim në masën 82%. Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre pasqyrohen në kapitullin Anekse – **Aneksi nr.3**, tabela nr.1, bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e **29** projekteve të investimeve Bashkia Librazhd, rezultoi se janë ndjekur hapat: Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Librazhd. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Librazhd dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	Real.%
1	<b>Paga 600</b>	<b>299,972,631</b>	<b>271,965,318</b>	<b>91</b>
	grant i kushtëzuar	8,500,992	7,811,428	92
	grant i pakushtëzuar + tarsnsferta sektoriale	282,391,346	259,349,756	92
	te ardhura	9,080,293	4,804,134	53
2	<b>Sigurime shoqërore 601</b>	<b>50,665,413</b>	<b>44,624,664</b>	<b>88</b>
	grant i kushtëzuar	864,905	788,406	91
	grant i pakushtëzuar + tarsnsferta specifike	49,575,728	43,643,114	88
	te ardhura	224,780	193,144	86
3	<b>Shpenz.operative 602+ F.rezerve</b>	<b>177,991,322</b>	<b>125,207,137</b>	<b>72</b>
	grant i kushtëzuar	355,644	355,644	100
	grant i pakushtëzuar + tarsnsferta specifike	104,933,355	74,547,392	71
	te ardhura	72,702,323	50,304,101	69
4	<b>K.Qarkut Transferime 604</b>	<b>20,467,499</b>	<b>20,078,152</b>	<b>98</b>
	grant	12,000,000	12,000,000	100
	grant i kushtëzuar	6,467,499	6,078,152	94
	te ardhura	2,000,000	2,000,000	100
5	<b>Nd ekonomike invalid 606 ,bonus strehimi ,ndihma financiare</b>	<b>582,802,097</b>	<b>547,884,216</b>	<b>94</b>
	grant i kushtëzuar	570,284,239	537,191,489	94
	grant i pakushtëzuar + tarsnsferta specifike	10,557,024	8,829,935	84
	te ardhura	1,960,834	1,862,792	95
6	<b>Investime 230-231</b>	<b>486,152,432</b>	<b>399,626,854</b>	<b>82</b>
	grant i kushtëzuar	123,720,046	117,546,006	95
	grant i pakushtëzuar + trasnsferta specifike	180,947,851	139,239,544	77
	te ardhura	181,484,535	142,841,304	79
7	466 te likjuara		12,422,846	

8	Grant I pashperndare	45,086,025		
	<b>Totali Bashkia Librazhd</b>	<b>1,663,137,419</b>	<b>1,422,308,842</b>	<b>85%</b>

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2023 në masën 1.7%
- Shpenzimet në artikullin 601 “Kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2023 në masën 0.43%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2023 në masën 40 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2023 në masën 35.7 %.
- Shpenzimet në artikullin 604 “transferime” për vitin 2022 në masën 9.9%.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2023** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 202,006,380 lekë ose në masën 14.2 %, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 537,609,741 lekë ose në masën 37.7%, nga transfertat e kushtëzuar në shumën 670,269,875 lekë ose në masën 47%.

### **2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023*
- *Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.*
- *Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.*
- *Rakordimet me agjentët tatimor.*
- *Evidenca e planifikimit të të ardhurave.*
- *Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.*
- *Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.*
- *Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.*

#### ***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:***

Drejtoria e Taksave Vendore mbulon 6 njësi administrative, të cilat janë: NJA Qendër, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis, Orenjë dhe ka në përbërje: Sektorë (Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Tregjeve). Kjo drejtori ka 13 punonjës: 1 (një) drejtor, 1 (një) përgjegjës sektori 5 specialistë sektori, dhe 6 inspektor taksash dhe tarifash vendore. Inspektori përgjigjet për taksat familjare fshat (taksë ndërtese, truall, taksën e tokës bujqësore, tarifa etj.).

Paketa fiskale për periudhën objekt auditimi është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 95, datë 14.11.2022 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1358/1 Prot., datë 05.12.2022.

Planifikimi i Buxhetit për periudhën objekt auditimi është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 107, datë 28.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 95/1 Prot, datë 13.01.2023.

Vendim të Këshillit Bashkisë nr.91, datë 20.09.2023 “Për një shtesë në Buxhetin e vitit 2023” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1060/1 Prot., datë 27.09.2023.

Vendim të Këshillit Bashkisë nr.107, datë 30.11.2023 “Për një shtesë dhe pakësim plani në Buxhetin e vitit 2023” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1295/1 Prot., datë 11.12.2023.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2023, subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit te bizneseve			Për vitin 2023
	Gjendja fillim 31.12.2022	Biznese të reja gjatë vitit 2023	Biznese të mbyllura, pezulluara gjatë vitit 2023	Gjendja me 31.12.2023
Biznes i Vogël	627	39	54	612

Biznes i Madh	127	29	15	141
Institucione	35	1	1	35
<b>Gjithësej</b>	<b>789</b>	<b>69</b>	<b>70</b>	<b>788</b>

Për vitin 2023, kanë ushtruar aktivitet 788 subjekte, nga të cilat 612 subjekte të biznesit të vogël, 141 subjekte të biznesit të madh dhe 35 institucione.

Bazuar në paketën fiskale, afati i pagesës së detyrimeve për taksapaguesit familjar dhe për biznesin e vogël është në datën 30 shtator dhe biznesin e madh 30.06.2023

Për vjeljen e detyrimeve familjare në qytet për vitin 2023 për taksa e tarifa vendore janë përgatitur listat dhe janë dërguar tek agjenti tatimor sipas VKB, Nr. 4 datë 24.01.2023 “Për caktim Agjenti Tatimor për Vitin 2023”, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, sipas akt marrëveshjes së lidhur me shkresë të Bashkisë Librazhd, Nr.1317 Prot., datë 10.03.2023 e shkresa me Nr. 446 Prot., datë 15.03.2023 të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, me nr. 2533 familje me vlerë 7,777,824 lekë. Taksat e tarifave vendore familjare do të vilen për një periudhë 6 mujore sipas marrëveshjes mes palëve.

Taksat e Tarifave vendore për familjarët në qytet mbledhen nëpërmjet Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime ShA, i cili vepron si agjent tatimor. Këto taksa për qytetin janë: taksa e ndërtesës, tarifa e pastrimit dhe ndriçim gjelbërimit. Ndërsa taksat që UK ShA mbledh për familjarët.

UK ShA nuk mbledh taksa dhe tarifa për familjarët e njësive administrative. Taksat familjare të NJA mbledhen nga specialistët e taksave. Për këtë kategori familjarësh (NJA), lloji i taksave dhe tarifave janë: taksa e ndërtesës, tarifa e pastrimit (për ato fshatra ku shtrihet ky shërbim), taksë trualli dhe tarifa e druve të zjarrit.

Sipas rakordimit dy palësh në datën 31.12.2023, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime ShA nuk ka mbledhur për llogari të Bashkisë Librazhd 2,819,814 lekë, ndërsa për vlerën 5,114,663 lekë është shuma e mbledhur dhe pa xhiruar për llogari të bashkisë. Vlera e arkëtuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime ShA gjatë vitit 2023 është 2,933,953 lekë, (xhirimet e bëra). Bashkia Librazhd gjatë vitit 2023 ka bërë sistemime për taksapagues të kategorisë të cilët përjashtohen nga taksa e ndërtesës dhe kanë lehtësira në tarifave vendore (invalid etj.), komisione për pagesën e agjentit tatimor.

Për sa më lart, debitorë familjare për taksa e tarifa vendore që mbeten deri 31.12.2023 nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime janë në vlerën 7,934,477 lekë (nga këto 5,114,663 lekë janë të arkëtuara dhe të pa xhiruara ndaj bashkisë dhe 2,819,814 lekë të pa arkëtuara e xhiruara nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime ShA, detyrime të prapambetura nga viti 2011-2023, (sipas akt- rakordimit të datës 17.01.2023 për gjendjen 31.12.2023).

Bashkia Librazhd sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2023. Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore pasqyrohen në kapitullin Anekse – **Aneksi nr.3**, tabela nr.2, bashkëlidhur raportit të auditimit. Për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithësej, nga 169,761,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 151,241,560 lekë ose 89.09 %, me një mosrealizim në vlerën 18,519 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

**Taksa e tokës bujqësore**, nga 5,450,000 lekë i planifikuar është realizuar 2,597,087 lekë ose 48 %, me një mosrealizim në vlerën 2,853,000 mijë lekë. Për këtë taksë Bashkia Librazhd ka hartuar rregjistrin e taksapaguesve për tokën bujqësore. Numri i taksapaguesve që ngarkohen me detyrime është 7,156. Rregjistri është hartuar mbi bazën e të dhënave që vetë njësitet

administrative administrojnë, si dhe sipas dokumentacionit që ka drejtorja e bujqësisë pranë Bashkisë Librazhd.

Nr.	Njësia Administrative	Familje (Nr)	Tokë Bujqësore (Ha)
1	NjësiaAdministrative Hotolisht	1,170	909
2	NjësiaAdministrative Qendër	1,802	1,904
3	NjësiaAdministrative Lunik	414	725
4	NjësiaAdministrative Stebleve	711	463
5	NjësiaAdministrative Orenjë	1,559	1,050
6	NjësiaAdministrative Polis	1,500	621
	<b>TOTALI</b>	<b>7,156</b>	<b>5,672</b>

Taksa mbi ndërtesat, nga 16,000,000 lekë i planifikuar është realizuar 12,424,701 lekë ose 78 %, me një mosrealizim në vlerën 3,575 mijë lekë.

Nga të dhënat e Drejtorisë e Taksave Vendore, për vitin 2023 të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore të cilat mbliidhen me agjent tatimorë, sipas përqindjeve të mëposhtme dhe planifikimit e realizimit të tyre:

- 97 % nga taksa e kalimit të drejtës së pronësisë
- 5 % nga taksa e rentës minerare
- 25 % nga taksa e regjistrimit të automjeteve
- 2 % tatimi mbi të ardhurat personale

Tabela si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2023	
		Plan /000 lekë	Fakt /000 lekë
1	Taksa e kalim të drejtës së pronësisë (agjenti kadastra)	800	956
2	Taksa e regjistrimit përvitshëm te automjeteve (agjenti DSHTR)	14,500	13,458
3	Renta minerare	360	110
4	Tatim mbi të ardhurat personale	10,000	12,207
	<b>Totali</b>	<b>25,660</b>	<b>26,731</b>
	<b>Realizimi</b>	<b>104.17%</b>	

### ***Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023.***

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore progresive për periudhën 2011-2023, janë krijuar debitorë në vlerën **92,762,894** leke, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 23,731,228 lekë nga 91 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 14,606,819 lekë nga 283 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 3,029,351 lekë nga 66 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 9,049,334 lekë nga 213 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 42,346,162 lekë nga taksapaguesit familjarne qytet dhe ne njesite administrative

Vetëm për vitin 2023, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifave vendore është 19,894,582 lekë, ose 21.44% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 7,256,268 lekë nga 58 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 2,441,949 lekë, nga 132 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 745,539 lekë nga 62 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 1,445,103 lekë nga 18 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 1,409,973 lekë nga 202 familjarët në qytet taksapaguesit familjar, detyrimi prej 6,595,750 lekë nga 4473 familjarët në gjashtë njësitë administrtrative taksapaguesit familjar.

Në formë tabele, të dhënat për debitorët jepen si vijon:

	Në fillim të vitit 2023(trashëguar nga vitet e mëparshme2011-2022)		Krijuar brenda vitit 2023		Arkëtuar debitorë për periudhe 11-22		Në fund të vitit 2023	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlerë
Biznesi i Madh	74	27,208,335	58	7,256,268	32	10,733,375	91	23,731,228
Biznesi Vogël	303	15,809,650	132	2,441,949	124	3,644,780	283	14,606,819
Ndërtesat social ekonomike	96	3,924,422	62	745,539	53	1,640,610	66	3,029,351
Legalizimet	283	10,260,919	18	1,445,103	88	2,656,688	213	9,049,334
Familjet	355	3,223,566	202	1,409,973	226	1,409,841	428	2,819,814
Familjet ne njesite administrative	4913	35,737,891	4473	6,595,750	1265	2,806,842	5134	39,526,348
<b>SHUMA</b>	<b>6,024</b>	<b>96,164,783</b>	<b>4,945</b>	<b>19,894,582</b>	<b>1,788</b>	<b>22,892,136</b>	<b>6,215</b>	<b>92,762,894</b>

Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave Vendore, konstatohet se në datën 01.01.2023, situatë e debitorëve është si vijon:

TAKSAPAGUESIT	Krijuar brenda vitit 2022		Në fillim të vitit 2023 (trashëguar nga vitet e mëparshme 2011-2022)	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
Biznesi i Madh	46	18,646,196	74	27,208,335
Biznesi Vogël	175	3,594,774	303	15,809,650
Ndërtesat	92	1,948,955	96	3,924,422
Legalizimet	49	2,011,853	283	10,260,919
Familjet	1584	3,552,791	5268	38,961,457
<b>SHUMA 1</b>	<b>1,946</b>	<b>29,754,569</b>	<b>6,024</b>	<b>96,164,783</b>

Nga krahasimi i vlerës së debitorëve midis dy viteve 2022 dhe 2023, si vlerës progresive, ashtu edhe vlerës së krijuar brenda secilit vit, konstatohet se është ulur vlera debitorëve.

Sa më sipër nga Drejtoria e Taksave Vendore, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12, germën “g”, dhe kushtet e kontratave të lidhura, subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratave me listë janë dërguar Drejtorisë së Financës për kontabilizim.

Pasqyra e subjekteve debitorë biznesi vogël, madh, ambulante e ndërtesa (lloji i aktivitetit: social ekonomik) etj, (2011-2023) datë 31.12.2023.

Nr	Njësi Administrative	Subjekte Gjithësej	Vlera Gjithësej	Biz. Vogël nd qira Nr	Biz.Vog Vlerë	Biz. Madh Nr.	Biz. Madh Vlerë
1	Bashkia Librazhd	440	41,367,398	349	17,636,170	91	23,731,228
	<b>Totali</b>	<b>440</b>	<b>41,367,398</b>	<b>349</b>	<b>17,636,170</b>	<b>91</b>	<b>23,731,228</b>

Jo të gjithë subjektet që janë debitor janë aktiv. Një pjesë e tyre edhe pse nuk kanë mbyllur aktivitetin në QKB, për shkak të detyrimeve që kanë, ata janë konstatuar nga Drejtoria e taksave se praktikisht nuk zhvillojnë aktivitet.

Drejtoria e Taksave Vendore, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Afatet e pagesave sipas paketës fiskale:

Për biznesin e madh data 30.06.2023. Për biznesin e vogël 30.11.2023, dhe mbas datës së afatit është llogaritur kamata vonës sipas evidences kamata është arkëtuar në vlerën 1,727,700 lekë sipas evidencës.

Për detyrimet tatimore të pa mbledhura janë ndjekur procedurat për mbledhjen me forcë të tyre, ku procedura e pare është njoftim vlerësimi për detyrimet e prapambetura, për biznesin e madh, biznesin e vogël, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, etj. Njoftim vlerësimet për detyrimet e prapambetura janë bërë më shkasën Nr. 4580, Prot., datë 13.10.2022 për biznesin

e madh, shkresën Nr. 373 Prot., datë 19.01.2023 për biznesin e vogël, ndërtesat me qira, ambulante etj.

Mbas njoftim vlerësimit për subjektet debitorë janë kryer procedurat bllokim llogarie hipoteke, barrë siguroese, qkb.

- Me shkresën Nr. 5365 Prot., datë 25.11.2022, është bërë bllokimi i llogarive bankare për biznesin e madh, ndërsa me shkresën nr. 1104. prot., datë 27.02.2023, është bërë bllokimi i llogarive bankare për biznesin e vogël.

- Me shkresën nr. 1151 prot., datë 01.03.2023 është bërë vendosje e barrës hipotekore të pasurisë së paluajtshme pranë ASHK me nr.1102 prot., datë 27.02.2023.

- Me shkresën nr.1103 prot., datë 27.02.2023 është bërë vendosje e barrës së siguroese për mjetet e transportit.

Ndaj subjekteve debitorë është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite është ngritur urdhër pune nr. 720, datë 03.07.2023 sipas shkresës nr. 4550 prot., datë 03.07.2023 “Për të monitoruar në vend subjektet debitorë për taksa e tarifa Vendore me një numër subjektësh prej 77 subjekte me vlerën 13 milion lekë. Nga ana e Drejtorisë së Taksave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Ndërsa vlera debitorë familjare prej 42,346,162 lekë për një numër prej 5562 familje përbëhet nga 5.134 familje në gjashtë njësite administartive me vlerën 39,526 mijë lekë dhe 428 familje në qytet me vlerën 2,820 mijë lekë për taksat e tarifatat vendore me datë 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve, për periudhën 2011-2023, sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr	Bashkia Librazhd	Taksa vendore			Tarifa Vendore	Shuma taksa tarifa	Numri i familjeve
		Taksë Toke	Taksë Ndërtese	Taksë Trualli			
1	Familjaret Qytet	-	377	-	2,443	2,820	428
2	Njesia Adm. Hotolisht	2,723	2,585	390	468	6,166	1,179
3	Njesia Adm.Lunik	985	291	-	366	1,642	305
4	Njesia Adm.Orenje	3,570	1,175	-	-	4,745	482
5	Njesia Adm.Polis	1,735	3,444	127	208	5,514	620
6	Njesia Adm. Stebleve	3,906	1,115	62	-	5,083	635
7	Njesia Adm Lib Qender	8,432	6,710	98	1,136	16,376	1913
	<b>Shuma</b>	<b>21,351</b>	<b>15,697</b>	<b>677</b>	<b>4,621</b>	<b>42,346</b>	<b>5,562</b>

*Burimi: Bashkia Librazhd*

Likuidimi i kontratave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe detyrimi i ngelur pa likuiduar në 31.12.2023. pasqyrohen në kapitullin Anekse – **Aneksi nr.3**, tabela nr.3, bashkëlidhur raportit të auditimit.

*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundor.*

Në Bashkinë Librazhd për vitin 2023 kanë zhvilluar aktivitet 7 subjekte për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Nga të dhënat e bashkisë Librazhd konstatohet se të gjitha këto subjekte janë pajisur me autorizime (licenca), sipas të dhënave të mëposhtme:

	Subjektet	Data e lëshimit të licencës	Data e përfundimit të afatit të licencës
1	S	31.05.2018	31.05.2023 në proces
2	K	10.11.2023	10.11.2028
3	S	03.04.2019	03.04.2024
4	M	02.04.2019	02.04.2024
5	H	03.09.2019	03.09.2024

6	H	06.07.2022	06.07.2027
7	D.M	19.06.2020	19.06.2025

*Nga auditimi përlikujdimin e detyrimeve për kontrata të lidhura për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullor.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Bashkia Librazhd janë lidhur 73 kontrata për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullor, arkëtimi i të cilave ndiqet nga Drejtoria e pyjeve dhe kullotave dhe arkëtohen nga Drejtoria e Taksave Vendore. Nga të dhënat e kësaj drejtorie konstatohet se detyrimi vjetor për këto kontrata me një numër 73 subjekte në vlerën 15,565,631 lekë. Në datën 31.12.2023, detyrimi i pa paguar për këto kontrata është në vlerën 2,206,200 lekë, Është paguar shuma me një numër 63 subjekte në vlerën 13,359,431 lekë dhe kanë mbetur 10 subjekte deri më 31.12.2023 në vlerën 2,206.200 lekë pa u arkëtuar. Vlera 2,206.200 lekë konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd, sipas pasqyrës si mëposhtme:

*Nga auditimi për likujdimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë legalizim, konstatohet se në datën 31.12.2022, vlera progresive e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është 10,261 mijë lejë, e cila përbehet nga 283 raste (legalizime objektesh) të pa likuiduara.

Për vitin 2023 janë kryer pagesa për llogari të detyrimeve të prapambetura dhe detyrimit të vitit në vlerën 2,656 mijë lekë, për 82 raste (objekte). Kjo pagesë e shprehur në përqindje përbën 29% të numrit total progresiv të objekteve të legalizuara, ose 25.88% të vlerës së detyrimit progresiv, sipas tabelës në vijim

Për të gjitha dosjet e ardhura nga aluizni (ASHK) janë bërë llogaritjet për çdo m2 sipërfaqe, për çdo pronar ku ndodhet pasuria e lloji i pasurisë dhe numri i objektit që legalizon.

Numri total i objekteve të legalizuara për vitin 2023 nga ASHK Elbasan, kanë ardhur 38 dosje objekte të legalizuara me vlerë të llogaritur 2,666 mijë lekë.

Në vitin 2023 janë arkëtuar / paguar 102 dosje objekte legalizimi me vlerë 3,710 mijë lekë sipas % e llojit të ndërtesës përcaktuar me VKM e VKB dhe 6 dosje në vlerën 168 mijë lekë janë sitemuar pasi kanë ardhur 2 herë (5 dosje konfirmuar nga ASHK) dhe një e Bashkisë Prrenjas.

Pagesat që janë bërë në vitin 2023 si më poshtë:

13 Dosje legalizimi të vitit 2016 janë arkëtuar në vlerën 368,847 lekë

12 Dosje legalizimi të vitit 2017 janë arkëtuar në vlerën 248,738 lekë

1 Dosje legalizimi të vitit 2018 janë arkëtuar në vlerën 18,545 lekë

5 Dosje legalizimi të vitit 2019 janë arkëtuar në vlerën 107,301 lekë

3 Dosje legalizimi të vitit 2020 janë arkëtuar në vlerën 75,239 lekë

27 Dosje legalizimi të vitit 2021 janë arkëtuar në vlerën 718,261 lekë

21 Dosje legalizimi të vitit 2022 janë arkëtuar në vlerën 951,298 lekë

20 Dosje legalizimi të vitit 2023 janë arkëtuar në vlerën 1,221,859 lekë

Gjendja debitorë 31.12.2023 janë 213 dosje me vlerë 9,049,334 lekë.

Në total debitorët nga viti 2016 deri më 31.12.2023 janë 213 dosje /objekte legalizime me vlerë 9,049 mijë lekë pa u arkëtuar për llogari të Bashkisë.

Dosje më 31.12.2022 janë 283, dhe 213 dosje 31.12.2023

Vlera më 31.12.2023 është 10,261 mijë lekë dhe 31.12.2023 është 9,049 mijë lekë.

*Në /000 lekë*

Nr	Gjendja me 31.12.2022		Dosje të hyra Janar – Dhjetor 2023		Pagesa të kryera Janar – Dhjetor 2023		Gjendje me 31.12.2023 Subjekte debitorë	
	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000
2	283	10,261	38	2,666	108	3,878	213	9,049

Në bashkinë Librazhd nga të dhënat progresive, deri në datën 31.12.2023, nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, 213 persona me vlerë **9,049 mijë lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd.**

Vlera 9,049 mijë lekë perbehet nga detyrimi prej 6,373 mijë lekë nga debitorët familjare për mospagesën e taksës të ndikimit në infrastrukturë për objektet me destinacion banimi, si dhe detyrimi prej 2,675 mijë lekë nga debitorët për mospagesën e taksës të ndikimit në infrastrukturë për objektet me destinacion biznesi. Nga auditimi u konstatua se për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve pasi janë nxjerë vetëm njoftim vleresimet për detyrimin dhe nuk është lejuar masa të tjera shtrenguese.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me kreun 11 të Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar të Ligjit Nr;9920 datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore progresive për periudhën 2011-2023, janë krijuar debitorë në vlerën 83,713,560 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 23,731,228 lekë nga 91 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 14,606,819 lekë nga 283 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 3,029,351 lekë nga 66 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 42,346,162 lekë nga taksapaguesit familjar në qytet dhe në njësitë administrative. Vetëm për vitin 2023, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifave vendore është 19,894,582 lekë, ose 21.44% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 7,256,268 lekë nga 58 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 2,441,949 lekë, nga 132 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 745,539 lekë nga 62 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 1,445,103 lekë nga 18 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 1,409,973 lekë nga 202 familjarët në qytet taksapaguesit familjar, detyrimi prej 6,595,750 lekë nga 4473 familjarët në gjashtë njësitë administrative taksapaguesit familjar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Paketa fiskale për periudhën objekt auditimi është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 95, datë 14.11.2022 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1358/1 Prot., datë 05.12.2022; Planifikimi i Buxhetit për periudhën objekt auditimi është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.107, datë 28.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 95/1 Prot., datë 13.01.2023; Vendim të Këshillit Bashkisë nr.91, datë 20.09.2023 “Për një shtese në Buxhetin e vitit 2023” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1060/1 Prot., datë 27.09.2023; Vendim të Këshillit Bashkisë nr.107, datë 30.11.2023 “Për një shtese dhe pakesim plani në Buxhetin e vitit 2023” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1295/1 Prot, datë 11.12.2023.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Bashkia Librazhd janë lidhur 73 kontrata për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullësor, arkëtimi i të cilave ndiqet nga Drejtoria e pyjeve dhe kullotave dhe arkëtohen nga Drejtoria e Taksave Vendore. Nga të dhënat e kësaj drejtorie konstatohet se detyrimi vjetor për këto kontrata me një numër 73 subjekte në vlerën 15,565,631 lekë. Në datën 31.12.2023, detyrimi i pa paguar për këto kontrata është në vlerën 2,206,200 lekë, Është paguar shuma me një numër 63 subjekte në vlerën 13,359,431 lekë dhe kanë mbetur 10 subjekte deri më 31.12.2023 në vlerën 2,206 mijë lekë pa u arkëtuar. Vlera 2,206 mijë lekë konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, Datë 29.07.1994 “Për K.C.R.SH-në” neni 826 i tij; të VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”; Ligjin



Nr. 57/2020 “Për Pyjet”; Ligjin Nr.9693/2007“Për fondin kullor” si dhe Udhëzim Nr.1/2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

**Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:** *Z. M.D me funksionin Kryetar i Bashkisë Librazhd; Znj. L.SH me detyrë Drejtor në Drejoria e të Ardhurave Vendore, Z. A.B më detyrë Drejtor i DPKM dhe Z. Q.F me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.*

### **2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**Shënim:** Për shkak të vonesës së vendosjes në dispozicion të grupit të auditimit, më datë 12.03.2024, të pasqyrave financiare të vulosura nga Dega e Thesarit Librazhd, si dhe pamjaftueshmërisë së kohës së mbetur në dispozicion të grupit të auditimit, pra 16.03.2024, sqarojmë se pasqyrat financiare të vitit 2023 (pika 2.3.1-2.3.3), do të auditohen në auditimin e radhës.

### **2.3.4. Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si edhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

Në zbatim të rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Librazhd miratuar me Urdhrin nr. 20, datë 28.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë struktura e cila merret me administrimin e pasurive është Sektori i Aseteve. Ky sektor e ka vazhduar aktivitetin e vetë deri më datë 31.07.2023, më pas ky sektor ka përsuar një riorganizimin sipas strukturës organizative miratuar me Urdhrin nr. 1061, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë duke u formuar Sektori i Strehimit dhe Menaxhimit të Aseteve Publike”.

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Librazhd, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Librazhd i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Librazhd. Me qëllim pasqyrimit real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Librazhd duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

**a.** Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Librazhd dhe Njësi Administrative Orenjë, Polis, Qendër Bashkia Librazhd, Stebleve, Hotolisht, Lunik nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Librazhd. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Librazhd, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për

inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastër.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

c. Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **4,484 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **1,446 pasuri në pronësi** dhe **2,941 pasuri në përdorim** si më poshtë:

➤ **Bashkia Librazhd**

-Me VKM-në nr. 1086, datë 28.10.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Librazhd, të Qarkut Elbasan”, është miratuar lista inventarit në total **422 pasuri**. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 422 (katërqind e njëzet e dy) dhe përbëhet me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë ndryshuar me:

a. VKM nr. 366, datë 18.05.2016, Bashkisë Librazhd i është transferuar **1 pasuri** sipas listës së inventarit bashklidhur, gjithsej një fletë, me emërtimin Reparti PMNZZH (Zjarrfiksjë).

b. VKM nr. 502, datë 30.07.2014, Bashkisë Librazhd i është transferuar **1 pasuri** sipas listës së inventarit bashklidhur, gjithsej një fletë, me emërtimin “Gjykatë e Rrethit Librazhd”, dhe sipërfaqe funksionale.

c. VKM nr. 367, datë 18.05.2016, Bashkisë Librazhd i është transferuar **1 pasuri** sipas listës së inventarit bashklidhur, gjithsej një fletë, me emërtimin “Shërbimi Informativ i Shtetit”.

ç. VKM nr 915, datë 11.11.2015, Bashkisë Librazhd “Për transferimin në pronësi të rrjetit të rrugëve rurale dhe të Aseteve të lujatshme dhe të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve” si dhe VKM nr. 661, datë 21.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 915, datë 11.1.2015.

➤ **Ish-Komuna Orenjë sot Njësia Administrative Orenjë e Bashkisë Librazhd**

-Me VKM nr. 1414, datë 28.10.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore të Komunës Orenjë, të Qarkut Elbasan”, Lista me 100 fletë dhe përfundon me numër Rendor 744, dhe VKM nr. 741, datë 28.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pasurive “Pyje dhe Kullota” që do transferohen në pronësi është 9 fletë, dhe përfundon me numër rendor 350, është miratuar lista inventarit me **744 pasuri total** nga të cilat **350 pasuri në pronësi** dhe **394 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Polis sot Njësia Administrative Polis e Bashkisë Librazhd**

-Me VKM nr. 891, datë 19.08.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore të Komunës Polis, të Qarkut Elbasan”, Lista me 64 fletë dhe përfundon me numër rendor 405, dhe VKM nr. 806, datë 04.06.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pasurive “Pyje dhe Kullota” që do transferohen në pronësi është 3 fletë, dhe përfundon me numër rendor 90, është miratuar lista inventarit me **405 pasuri total** nga të cilat **90 pasuri në pronësi** dhe **315 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komunës Qendër sot Njësia Administrative Qendër e Bashkisë Librazhd**

-Me VKM nr. 313, datë 25.03.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore të Komunës Qendër, të Qarkut Elbasan”, Lista me 131 fletë dhe përfundon me numër rendor 951, dhe VKM nr. 804, datë 04.06.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pasurive “Pyje dhe Kullota” që do transferohen në pronësi është 8 fletë, dhe përfundon me numër rendor 309, është miratuar lista inventarit me **951 pasuri total** nga të cilat **309 pasuri në pronësi** dhe **642 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komunës Stebleve sot Njësia Administrative Stebleve e Bashkisë Librazhd**

-Me VKM nr. 377, datë 08.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore të Komunës Stebleve, të Qarkut Elbasan”, Lista me 80 fletë dhe përfundon me numër rendor 543, dhe VKM nr. 607, datë 05.09.2012, “Për miratimin e listës përfundimtare të pasurive “Pyje dhe Kullota” që do transferohen në pronësi është 6 fletë, dhe

përfundon me numër rendor 209, është miratuar lista inventarit me **543 pasuri total** nga të cilat **209 pasuri në pronësi** dhe **334 pasuri në përdorim**. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 209 (dy qind e nëntë).

➤ **Ish-Komunës Hotolisht sot Njësia Administrative Hotolisht e Bashkisë Librazhd**

-Me VKM nr. 579, datë 28.05.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore të Komunës Hotolisht, të Qarkut Elbasan”, Lista me 97 fletë dhe përfundon me numër rendor 705, dhe VKM nr. 807, datë 04.06.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pasurive “Pyje dhe Kullota” që do transferohen në pronësi është 5 fletë, dhe përfundon me numër rendor 185, është miratuar lista inventarit me **705 pasuri total** nga të cilat **185 pasuri në pronësi** dhe **520 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komunës Lunik sot Njësia Administrative Lunik e Bashkisë Librazhd**

-Me VKM nr. 1413, datë 22.10.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore të Komunës Lunik, të Qarkut Elbasan”, Lista me 83 fletë dhe përfundon me numër rendor 609, dhe VKM nr. 682, datë 21.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pasurive “Pyje dhe Kullota” që do transferohen në pronësi është 5 fletë, dhe përfundon me numër rendor 198, është miratuar lista inventarit me **609 pasuri total** nga të cilat **198 pasuri në pronësi** dhe **411 pasuri në përdorim**.

**c. Në total në pronësi të Bashkisë Librazhd janë 1,446 pasuri nga të cilat 228 pasuri janë certifikuar deri më 2023 pasuri janë të pajisura me certifikatë pronësie dhe 1011 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie.** Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat mbi certifikimin e pasurive të Bashkisë Librazhd si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njësiti Administrative	Nr. Pasurive të transferuara (pronësi)	Nr. i Praktikave të Certifikuar deri Dhjetor 2022	Nr. Praktikave të Certifikuar 2023	Pasuri të pa Rregjistruara
1	Bashkia Librazhd	107	52	1	54
2	Hotolisht	185 (E.K pyjore)	57	18	104
3	Orenjë	350 (E.K.pyjore)	15 (ekonomi pyjore)		335
4	Lunik	198 (E.K.pyjore)			
5	Stebleve	209 (E.K.pyjore)	18 (ekonomi pyjore)	4 (ekonomi pyjore)	181
6	Polis	90 (E.K.pyjore)		51 (ekonomi pyjore)	39
7	Qendër	309 (E.K.pyjore)	12 (ekonomi pyjore)	0	298
<b>Totali</b>		<b>1446</b>	<b>154</b>	<b>74</b>	<b>1011</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Librazhd.

-Në bashkinë Librazhd Drejtoria e Planifikimit dhe Territorit Sektori i Aseteve me urdhër pune Nr.928 datë 04.10.2023 ka ngritur komisionin për krijimin e inventarizimit fizik të përgjithshëm të pronave në pronësi të Bashkisë dhe të transferuara sipas VKM përkatëse .

-Në Bashkinë Librazhd me urdhër NR:1114 datë 30.11.2023 është ngritur komisioni për krijimin e inventarizimit të përgjithshëm të mallrave dhe materialve të Bashkisë.

Nr	Emertimi i Rrugës	gjatësia km
1	Rruge Nac/Ura Mirake -Gurshpate -Vilan	25
2	Rruge Nacionale-Dragostunje	7
3	Rruge Nacionale /Librazhd-Babje-Dardhe	17
4	Rruge Nacionale /Librazhd -Qarrishte	28
5	Rruge Nacionale Rrapun -Kuturman	5
6	rruge Nacionale-Fushe Studen-Zabzun	4
7	Rruge Nacionale/Hotolisht-Kokreve-Kokreve Katund	4
8	Rruge Nacionale /Lunik-Lunik fshat	4
9	K/Borove-Borove	4
10	Qaf Drize-Zdrajsh Orenjë	21
	Shuma (KM)	119

-VKM nr.1108 datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural, dhe Administrimit të ujrave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, sipas listës e cila pasqyrohet në kapitullin Anekse – **Aneksi nr.4**, tabela nr.1, bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Konstatim:** Nga totali prej 1446 prona te transferuara sipas VKM janë regjistruar gjithësej 228 prona (viti 2022 e më parë 154 prona dhe viti 2023 janë regjistruar 74 prona) të paregjistruara 1011 prona. Gjithashtu të gjitha pronat “Pyjore” të certifikuara deri tani, janë ndjekur nga struktura përgjegjëse për Pyjet dhe Kullotat që nga krijimi i saj në vitin 2016, ku kjo drejtori ka ndjekur procedurat për regjistrimin e pasurive të llojit Pyll, Kullotë dhe Shkëmbore. Regjistrimi është filluar nga kompania SNVP Albania, në marrëveshje me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, që para krijimit të Drejtorisë në vartësi të Bashkisë. Certifikimet e pronave Pyjore nga viti 2019 e në vazhdim, është krijuar një tjetër marrëveshje me kompaninë “D.”, dhe Ministrisë.

Sot DKPM – Bashkia Librazhd ka në listën e inventarit sipas Shtojcës 18 të VKM-së 684, datë 02.09.2020 1554 pasuri të transferuara në pronësi.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

#### **2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.**

##### -Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

##### -Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.05.2023 – 31.12.2023, nga subjekti Bashkia Librazhd referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë zhvilluar gjithsej **31** procedura prokurimi me fond limit **224,289,938 lekë pa TVSH**, me vlerë kontrate **191,648,645 lekë pa TVSH**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **32,641,293 lekë pa TVSH**, ose **14.5%**. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.05.2023 – 31.12.2023	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
<b>GJITHESEJ</b>	<b>31</b>	<b>224,289,938</b>	<b>191,648,645</b>
-Të hapura	3	202,335,865	172,149,739
- Kërkesë me propozim	0		
- Shërbim konsulence	0		
- Negocim pa shpallje	0		
- E hapur e thjeshtuar	4	9,057,890	7,623,782
- Me vlerë të vogël	24	12,896,183	11,875,124
<b>Sipas objekteve</b>			
-Objekte në fushën e punëve publike	15	212,297,853	181,875,360
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	16	11,992,085	9,773,285

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej 385 OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar 163 OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej 3 procedura ose 10% e procedurave të zhvilluara në total për periudhën objekt auditimi.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjodhi për auditim:

-9 procedura prokurimi me vlerë kontrate **179,460,194 lekë**, ose 93.6% të fondit të kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi 01.05.2023-31.12.2023;

*Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon<sup>3</sup>:*

### **Periudha 01.05.2023-31.12.2023**

#### Prokurimet me vlerë të lartë

1. Tenderi me objekt: “Blerje fouristrade SUV për administratën e Bashkisë”;
2. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësitë Administrative”;
3. Tenderi me objekt: “Ndertim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj.Adm. Polis Bashkia Librazhd”;
4. Tenderi me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”;
5. Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim i rruges Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”.

#### Prokurimet me vlerë të vogël

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Dekori i Qytetit Viti i Ri”;
7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Pastrim Pyjesh AH”;
8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje Stufa Zjarri”;
9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion i Taracës së Godinës Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd.

**1. Tenderi me objekt: “Blerje fouristrade SUV për administratën e Bashkisë”, me këto të dhëna:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje fouristrade SUV per administraten e Bashkise”.</b>			
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-79525-09-11-2023 Urdhri nr.837 prot., datë 06.09.2023	<b>2.Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr.836, datë 06.09.2023 1.E.H -Kryetar 2.G.P -Anëtar 3.I.C -Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 837, datë 06.09.2023 1.D.B - Juriste 2.B.K - Ing Topog 3.A.H - Ing. Mjedis	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr.843 prot., datë 08.09.2023 1.J.I - (Kryetar) 2.C.V - (Anëtar) 3.K.LL - (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh):</b> 2,916,667 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh):</b> OE “A ” Shpk – 2,890,000 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh):</b> 26,667 lekë	
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 22.09.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit.	<b>10.Operatorët Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S'kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE	
<b>11. Ankimime AK-s'ka/ka; ka</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b>	

<sup>3</sup> Ndikimi, kriteri, shkaku dhe rekomandimi janë dhënë në fund të trajtimit të procedurave të prokurimit në mënyrë të përmbledhur, me qëllim eliminimin e përsëritjes.

APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka		S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.6385 datë 02.10.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH):</b> 3,468,000 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës - 3,468,000 lekë me TVSH</b>
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë: 30 dite</b>	<b>19. Zgjatja e kontratës: Jo</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përlllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

**AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;** Nga auditimi i dokumentacionit<sup>4</sup> për përlllogaritjen e fondit limit, konstatohet se nga grupi i punës, ngritur me urdhrin nr. 836 datë 06.09.2023, nuk është dokumentuar metoda e ndjekur për përlllogaritjen e fondit limit. Pra referuar përcaktimit të bërë në pikën 1 të nenit 76 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, AK duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave për përlllogaritjen e fondit limit dhe më pas mbështetur në pikën 2 të nenit 76 të VKM së mësipërme, ka detyrimin e argumentimit dhe dokumentimit të përlllogaritjes së fondit limit.

Për mos zbatimin e përcaktimeve ligjore të mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi komisioni për përlllogaritjen e fondit limit me përbërje z. E.H , z. G.P dhe z. I.C .

Gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi, personi përgjegjës për procedurën e prokurimit, znj. D.B , i cili në zbatim të përcaktimit të bërë në shkronjat “ç” dhe “e” të pikës 3 në nenin 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duhet të përgatiste dokumentet e tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre, si dhe administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, etj.

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 11.09.2023, nga NJP.**

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga NJP e përbërë nga znj. D.B (Juriste), z. B.K (Inxh. Topograf) dhe znj. A.H (Inxh. Mjedisi).

Nga auditimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, u konstatua se:

**Në pikën 2.1** përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale - Nuk është kërkuar që OE, i cili do të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të jetë i pajisur me licencën të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimn e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, nënkategoria VII.3.B.1 dhe/ose VII.3.B.2 ku përfshihet shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, të reja dhe/ të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, kjo për të garantuar që OE ushtron aktivitet në përputhje me kuadrin rregullator, si dhe për të përmbushur deklaratën e garancisë, pra riparimin e defekteve brenda afatit 1 vjeçar<sup>5</sup>.

**Pika 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përlllogaritur të

<sup>4</sup> Theksojmë referuar DST, pika 2.10, në Seksionin 1, formularit të njoftimit të kontratës, urdhrin të prokurimit, pasi vetëm në këto dokumente pasqyrohet informacioni për vlerën e fondit limit.

<sup>5</sup> Këtu OE për të përmbushur deklaratën e garancisë, mund të paguaj një servis të licencuar për të kryer riparimet e nevojshme në rast se krijohet nevoja, por në këtë rast duhet të që servisi të deklarojë se merrë përsipër dhe për llogari të OE, kryerjen e riparimeve brenda afatit 1 vjeçar.

kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kritereve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

**Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. D.B , z. B.K dhe znj. A.H.**

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 13.06.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 17.06.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Me shkresën nr.1988 prot., datë 22.06.2022 nga OE “A ” Sh.P.K është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Librazhd.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, përkatësisht:*

1.OE “A ” Sh.P.K me ofertë ekonomike 2,890,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 26,667 lekë/1% më pak. Në përfundim të fazës së vlerësimit të ofertave është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A ”.

### **Konkluzion:**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>6</sup>, nga OE “A ” Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

### **Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara.**

-Me urdhrin nr.920, datë 03.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të automjetit, me përbërje si vijon: z. V.K (Drejtor i Sigurisë Publike), z. E.H (Përgjegjës/ Mjeteve të Transportit) dhe z. E.S (Magaznier).

-Për marrjen në dorëzim të mjetit dhe verifikimin e tij, nga komisioni i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbali pa nr. prot., datë 03.10.2022;

-Kontrata e lidhur ndërmjet palëve nr.6385 prot., datë 02.10.2023, me afat lëvrimi të mallit 1 muaj nga lidhja e kontratës, pra deri më datë 02.11.2023;

-Fatura tatimore e lëshuar nga OE “A ” ShPK, është me nr., 5878/2023, datë 03.10.2023 me vlerën 3,468,000 lekë me TVSH;

-Urdhër shpenzimi nr.1022, datë 14.11.2023;

-Në procesverbal është pasqyruar se mjeti foristrade SUV është sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

### **2. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësitë Administrative”, me këto të dhëna:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësi Administrative”.</b>			
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-69295-05-15-2023 Urdhri nr. 527 prot., datë 16.05.2023	<b>2.Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr.414, datë 07.04.2023	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 527, datë 16.05.2023 1.D.B – Juriste 2.B.K – Ing. Topog 3.A.H - Ing.Mjedisi	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 527/1 prot., datë 16.05.2023 1.M.G - Kryetar 2.M.M - Anëtar 3.K.LL - Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E hapur e thjeshtë	1.J.M 2.T.H 3.A.H		

<sup>6</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>5. Fondi Limit (pa tvsh):</b> 2,913,400 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese (pa tvsh):</b> OE "B" Shpk - 1,748,500 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh):</b> 1,164,900 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 26.05.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit.	<b>10. Operoret Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b) S'kualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 5 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës:</b> Nr.4129 datë 14.06.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH):</b> 2,098,820 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës – 2,098,200 lekë me Tvsh</b>
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë:</b> 12 Muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës: Jo</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 15.05.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë minimalisht deri në 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën "b" të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: "*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*", pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. D.B , z. B.K dhe znj. A.H .*

***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 26.05.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 01.06.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 12.06.2023 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 7 OE, përkatësisht:*

- 1.OE "B" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 1,748,500 lekë pa TVSH.
- 2.OE "D" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,412,200 lekë pa TVSH.
- 3.OE "A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,491,000 lekë pa TVSH.
- 4.OE "H" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,583,800 lekë pa TVSH.
- 5.OE "M" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 1,555,500 lekë pa TVSH.



6.OE “S ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,498,800 lekë pa TVSH.

7.OE “G.H ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 1,937,500 lekë pa TVSH.

-Nga OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	OE “A ” shpk	2,491,000	S’kualifikuar për shkak se OE nuk ka dorëzuar mostrat për artikujt, ditën e hapjes së tenderit para zyrës së protokollit të Bashkisë Librazhd, OE nuk plotëson pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të DST.
2	OE “M ” shpk	1,555,500	S’kualifikuar për shkak se OE nuk ka dorëzuar mostrat për artikujt, ditën e hapjes së tenderit para zyrës së protokollit të Bashkisë Librazhd, OE nuk plotëson pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të DST.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “B ” Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 1,748,500 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,164,900 lekë/40% më pak. Është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

**Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>7</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk plotësohet **pika 2.2.1 në DST**, mbi xhiron vjetore për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare, nga OE është dorëzuar xhiro vjetore për vitin 2021 dhe 2022.

### **Konkluzion.**

OE “B ” shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

*-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. M.G , Kryetar, znj. M.M dhe znj. K.LL , Anëtar.*

**3. Tenderi me objekt: “Ndertim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj.Adm. Polis Bashkia Librazhd”, me këto të dhëna:**

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj.Adm. Polis Bashkia Librazhd”.		
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-72742-06-13-2023 Urdhri nr. 648 prot., datë 15.06.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr.621, datë 07.06.2023 1.J.B -Kryetar 2.M.D - Anëtar 3.A.T -Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 648 prot., datë 15.06.2023 1.D.B –Juriste 2.J.M –Ing Ndërtimi 3.A.H –Ing. Mjedisi
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit - E hapur</b>		<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 753 prot., datë 10.06.2023 1.E.P (Kryetar) 2.XH.B (Anëtarë) 3.K.LL (Anëtarë)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh):</b> 93,146,734 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh):</b> OE “E ” SHPK - 87,693,553 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh):</b> 5,453,181 lekë
<b>8.Data e hapjes së tenderit:</b> Data 05.07.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit.	<b>10. Operatorët Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) S’kualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 2 OE
<b>11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.5271 datë 11.08.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH):</b> 104,004,584 lekë	<b>16.Likuiduar pjesërisht sipas kontratës</b> 47,513,039 lekë me Tvsh
<b>17.Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18.Afati i kontratës në ditë:</b> 6 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës: Jo</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

<sup>7</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 16.06.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.2,** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë:

N.P-1 B (Punime gjurmimi në tokë).

N.P-2 C (Ndertime civile dhe industriale).

N.P-3 C (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada).

N.P-12 B (Punime të inxhinierisë së mjedisit).

N.S-1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve).

N.S-2 A (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre).

N.S-3 A Impiante gritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues).

N.S-4 C (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

N.S- 8 A (Ndertime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri).

N.S-12 B (Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit).

N.S-14 B (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj).

N.S-18 A (Punime topogjeodezike).

N.S-19 A (Sisteme kundra zhurmes per infrastructure).

N.S-20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë).

-Në procesverbal nuk argumentohet dhe të pasqyrohet lloji i punimeve që do të kryhet me llojin e licencës dhe kategorinë e saj të kërkuar. Në veçanti nuk argumentohet kërkesa për licencat e mëposhtme:

**N.P-12 B** - Punime të inxhinierisë mjedisore, e cila në mënyrë të thjeshtuar përfshin procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe rryllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte. - Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence.

**N.S-3 A** - Impiante gritese dhe transportuese (ashensore, shkallë levizese, transportues) Konsiderohet, montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. - Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence.

**N.S-18 A** - Punime topogjeodezike, Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence.

**N.S-20 A** - Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë, Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse. Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence.

**Pika 2.3.3,** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të përfshirë në liçencën e shoqërisë me kontratë noteriale punë me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit

të punimeve për këtë objekt të vërtetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa për 3 (tre) muajt e fundit si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi (profile strukturist)
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhiner Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

**Pika 2.3.5** OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt të vërtetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Ndërtimi /strukturist

1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

-Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontraktojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Pra pse duhet të jetë 3 muaj në listëpagesë dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjykojmë se kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale, lidhur me disponimin e inxhinierëve, ezarohen duke kërkuar disponimin e tyre gjatë pjesëmarrjes në procedurë, përfshirjen e tyre si drejtues teknik. Gjithashtu sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite punë eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)<sup>8</sup>. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Vendosi e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

-Nuk argumentohet kërkesa se përse duhen 3 inxhinier ndërtimi drejtues teknik dhe jo vetëm 1 prej tyre të jetë drejtues teknik. Gjithashtu nuk argumentohet me analizë teknike kërkesa edhe për 1 inxhinier ndërtimi si staf mbështetës.

<sup>8</sup> Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kërkesa për inxhinierin elektronik është e panevojshme, pasi sipas preventivit të punimeve nuk kemi punime që kërkojnë inxhinier elektronik.

-Kërkesa për inxhinierin e mjedisit është e paargumentuar, pasi sipas preventivit të punimeve nuk kemi punime që kërkojnë inxhinier mjedisi. Gjithashtu çdo projekt i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Zbatimi i masave të përcaktuara në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, është objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Elbasan, strukturë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Inxhinieri i mjedisit shërben gjatë fazës së projektimit, ku edhe përcakton masat që do të zbatohen për mbrojtjen e mjedisit, zbatimi i të cilave respektohet dhe monitorohet nga inxhinierët civil.

-Ekspertiza profesionale e Arkitektit është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike. Në lidhje me kërkesën për Arkitekt duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e arkitektit. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga arkitekti.

**Pika 2.3.6,** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Sasia
1	Punonjës teknik ndërtimi	(1 person)
2	Punonjës teknik mekanik	(2 persona)
3	Punonjës teknik topograf	(1 persona)
4	Hidraulik	(2 person)
5	Elektriciist	(3 persona)
6	Betonues	(3 persona)
7	Murator	(3 persona)
8	Bojaxhi	(5 persona)
9	Hekurkthyes	(2 persona)
10	Hidroizolues	(2 persona)
11	Karpertier	(2 persona)
12	Suvatues	(4 persona)
13	Pllakashtrues	(3 persona)
14	Specialist per sistemet e kondicionimit	(3 persona)
15	Specialist per punime gipsi	(2 persona)
16	Specialist per punimet ne lartesi	(2 persona)
17	Punëtoare ndërtimi	(15 persona)
18	Manovratorë të mjeteve të rënda	(5 persona)
19	Shoferë kamionash	(5 persona)
	<b>Total</b>	<b>14</b>

Kërkesa e mësipërme e cila kërkon 5 shoferë dhe 5 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës **2.3.15 të DST** për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohen shoferët dhe manovratorët. Konkretisht janë kërkuar 10 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit, dhe po 10 mjete tjera për të cilat kërkohet disponimi i manovratorit për drejtimin e tyre. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjetesh të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 6 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

**Pika 2.3.15,** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
2	Kamiona vetshkarkues, kapaciteti mbajtës mbi 15 ton	Në pronësi ose me qera	Copë	3
3	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtës minimalisht deri në 10 ton	Në pronësi ose me qera	Copë	3
4	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtës minimalisht 3.5–5 ton	Në pronësi ose me qera	Copë	1
6	Kamioncine me kapacitet mbajtës jo me shume se 1 ton	Në pronësi ose me qera	Copë	2
7	Autobetonierë	Në pronësi ose me qera	Copë	3
8	Autopompe betoni	Në pronësi ose me qera	Copë	1
9	Rimorkiator	Pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi	Copë	1
10	Fadrome	Në pronësi ose me qera	Copë	1
11	Pompe suvatimi	Në pronësi ose me qera	Copë	2
12	Matrapik per thyerje betoni	Në pronësi ose me qera	Copë	2
13	Autobot uji	Në pronësi ose me qera	Copë	1
14	Betoniere / vellimi 1 m3	Në pronësi ose me qera	Copë	2
15	Autovinc	Në pronësi ose me qera	Copë	1
16	Minieskavator	Në pronësi ose me qera	Copë	2
17	Minifadroma	Në pronësi ose me qera	Copë	1
18	Krik ngrites	Në pronësi ose me qera	Copë	3
19	Kantier stacionar	Në pronësi ose me qera	Copë	1
20	Gjeneratore	Në pronësi ose me qera	Copë	2
21	Tranxhe hekuri	Në pronësi ose me qera	Copë	1
22	Skele suvatimi	Në pronësi ose me qera	M2	3500
23	Nivelues per shtresa betoni	Në pronësi ose me qera	Copë	2
24	Pirun ngrites	Në pronësi ose me qera	Copë	1
25	Kompresor	Në pronësi ose me qera	Copë	2
26	Vinxh Kulle 40 m	Në pronësi ose me qera	Copë	1

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Sa më sipër është kërkuar kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton (3 cop), mbi 10 ton (3 copë), me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton (1 copë) dhe kamionçinë jo më shumë se 1 ton (2 copë) numër i paargumentuar me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës.

Janë kërkuar 1 fadromë, 2 minieskavator dhe 1 minifadromë, por në asnjë rast nuk argumentohet me analizë teknike. Pra sasia e dheut që do të gërmohet në një ditë pune (8 orë) dhe më pas në 1056 orë pune gjithësej (6 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të mjeteve të sipërcituara.

-Veç autovinç për ngritjen e materialeve është kërkuar edhe vinç kull për ngritjen e materialeve në lartësi, kërkesë e paargumentuar teknikisht, pasi materialet mund të transportohen në lartësi edhe me autovinç. Kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e OE që nuk kanë një vinç kullë, por kanë autovinç dhe transportimi i materialeve kryhet përsëri. Gjithashtu është kërkuar 1 pirun ngritës për ngritjen dhe transportimin e mjeteve të caktuara në lartësi dhe 3 krik ngritës për ngritjen/mbajtjen e materialeve, mjeteve në lartësi.

**-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. D.B , z. J.M dhe znj. A.H**

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 24.07.2023 për hapjen e tenderit, për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim me procesverbalin nr.s'ka, datë 03.08.2023. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 24.07.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 OE (renditur OE diferenca më e lartë nga fondi limit – diferenca më e ulët), përkatësisht:*

1. OE “2T” Sh.P.K me ofertë ekonomike 70,569,188 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 22,577,546 lekë/24% më pak;
2. BOE “A ” Sh.P.K dhe “U ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike 79,118,200 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 14,028,534 lekë/15% më pak;

3. OE “B ” Sh.P.K me ofertë ekonomike 89,611,599 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,535,135 lekë/4% më pak;
4. OE “E ” Sh.P.K me ofertë ekonomike 87,693,553 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 5,453,181 lekë/6% më pak;
5. OE “B ” Sh.P.K me ofertë ekonomike 90,350,235 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,796,499 lekë/3% më pak;

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s’kualifikimit
OE “ 2T SHPK ”	Skualifikuar për shkak se, nuk ka arritur të përmbushë kriteret e vecanta të përcaktuara në DST, konkretisht: Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Në dokumentet standarte të tenderit sigurimi i ofertës është një nga kriteret për pranimin e operatorit në procedurë. Për shkak se operatori nuk e ka paraqitur këtë kriter atëherë nuk mund të kualifikohet .
“B ” SHPK	S’kualifikuar për shkak se, nuk ka arritur të përmbushë kriteret e vecanta të përcaktuara në DST, konkretisht: Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Në dokumentet standarte të tenderit sigurimi i ofertës është një nga kriteret për pranimin e operatorit në procedurë. Për shkak se operatori nuk e ka paraqitur këtë kriter atëherë nuk mund të kualifikohet.
“A ” SHPK & “U ” SHPK	S’kualifikuar për shkak se: 1- Asnjë nga operatorët Ekonomik si dhe Licencën III.1.B të cilat janë kërkuar në dokumentat e tenderit. 2- Sipas ndarjes së përqindjeve Operatori Ekonomik Z ka marrë përsipër të gjitha punimet për betonin duke deklaruar vetëm një karpentier nga 2 që kërkohen si dhe për punonjësit manovrator nuk janë deklaruar numrat e regjistrimit të dëshmime referuar kërkesës në dst. 3- Operatori ekonomik U ka marrë përsipër të kryej punime të Sistemeve ngrohje ftohje pa paraqitur asnjë punëtor të specializuar për kryerjen e këtyre punimeve, si dhe mungojnë autorizimet nga ana e këtij operatori për kryerjen e këtyre punimeve.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “E ” Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 87,693,553 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 5,453,181 lekë/6% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>9</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk është plotësuar pika **2.2.3 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Cerrik, Bashkinë Durrës dhe Bashkinë Fier përgjatë periudhës 2022-2023.

-Nuk është plotësuar pika **2.3.4 e DST**, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të ketë drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 (tre) mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e dokumentacionit të inxhinierve për tre mujorin duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit – OE në formularin “shtojca 8” ka deklaruar z. H.P Inxhinier Topograf i cili nuk figuron në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, si dhe nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë në muajin maji. Gjithashtu në pikën **2.3.5 e DST**, OE pjesëmarrës ka deklaruar si staf mbështetës znj. E.DH , Arkitekte e cila nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë në muajin maji.

-Nga OE E shpk nuk është plotësuar kërkesa e vendosur në pikën **2.3.6** të DST, konkretisht:  
-Për punonjësin L.S është plotësuar deklarata “shtojca 8” si hekurkthyes, për të cilin nuk është dorëzuar kontratë pune. Pra ngelet 1 hekurkthyes nga 2 që janë deklaruar. Sa i përket dokumentacionit të dorëzuar për punonjësin E.B , nuk konsiderohet, pasi është punonjës i padeklaruar në shtojcën 8.

Për mjetet e mëposhtme janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e kërkuar në DST;

-Autovinç me targë AB226CS, kontrolli teknik i dorëzuar fizikisht, ka përfunduar afatin e vlefshmërinë më datë 28.06.2023.

<sup>9</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës deri në 10 ton, me targë AA351AY, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:4913 Nr.Kol:2783 me subjektin “F.B ”, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

### **Konkluzion.**

OE “E ” Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. E.P , Kryetar, z. XH.B dhe znj. K.LL , Anëtarë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 145/1 prot., datë 12.04.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 32/5 prot., datë 18.04.2024, “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” znj. D.B , znj. A.H , z. J.M , znj. K.LL , z. XH.B , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se për këtë objekt prokurimi, është cituar se janë aplikuar kriteret kualifikimi të paargumentuara dhe jo në përputhje me rregullat e LPP, konkretisht: Njësia e Prokurimit për këtë objekt prokurimi sqaron se: Në procesverbalin e hartimit të dokumentave të tenderit, për çdo kriter kualifikues është vendosur baza ligjore, në bazë të të cilit është kërkuar si kërkesë kualifikuese.

1.Kërkesa e DST, për 3 inxhinier ndërtimi, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe Agjensia e Prokurimit Publik e ka cilësuar të saktë këtë kërkesë, në zbatim të plotë të projektit, specifikimeve teknike dhe zërave të preventivit. APP e ka vlerësuar si kriter të saktë dhe të rregullt.

2.Kërkesa për mjetet e kërkuar dhe shoferët, janë kërkesa të cilat përputhje me objektin e prokurimit, zërat e punimeve dhe specifikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu për çdo procedurë prokurimi Titullari i AK, ka ngritur grupe pune të vecantë për përlllogaritjen e fondit limit, hartimit të kriterëve të vecanta teknike, listës së mjeteve, grafikut të punimeve etj. Njësia e Prokurimit mbështetur në analizën teknike dhe ligjore të këtij komisioni ka përcaktuar edhe në DST, formulimin e kriterëve teknike të vecanta në DST, sikurse kriteri 3.6 dhe 3.7 në DST, përfshirë stafin teknik, mjetet e nevojshme, shoferët, manovratorët etj. Vendosja e çdo kriteri të vecantë është e dokumentuar dhe argumentuar teknikisht dhe ligjërisht me dosjen teknike të përlllogaritjes së fondit limit. Në fillim nga Njësia e Prokurimit janë kërkuar 5 shofere, dhe APP ka kërkuar uljen e numrit të shoferëve, për këtë arsye Njësia e Prokurimit ka ulur numrin e shoferëve nëpërmjet një shtojce.

3.Në lidhje me përcaktimin e kriterit pika 3.7/c, e DST, për mjetet dhe makineritë e nevojshme për realizimin e kontratës, është kërkuar ndër të tjera që mjetet me qera të kenë në objekt të tyre edhe objektin e kontratës, për të garantuar që mjetet do të jenë në dispozicion të realizimit të veprës dhe jo në objekte të tjera. Kjo kërkesë është përcaktuar për të garantuar që punimet të realizohen në kohë dhe në cilësi.

4.Njësia e Prokurimit gjykon dhe argumenton se është e padrejtë që përgjegjësia ligjore ti mbetet njësisë së prokurimit për kriteret e vecanta teknike, për të cilat Titullari i AK, ka përcaktuar një komision të vecantë për hartimin dhe përcaktimin e tyre në përputhje me objektin e prokurimit, sikurse është e sanksionuar shumë mirë në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik. Ashtu sikurse, duhet të vlerësohet fakti që Njësia e Prokurimit ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me APP, dhe ka pranuar çdo sugjerim apo rekomandim të tyre për çdo procedurë prokurimi, për të respektuar dhe zbatuar në mënyrë të plotë parimin e transparencës dhe të një vendimmarrje të drejte.

-Për sa më sipër, Këto kriteret mbështeten në vlerën e objektit të prokurimit, tipologjia e punimeve, analiza teknike e kryerjes së punimeve, shtrirjen gjeografike të kryerjes së veprës, projektit teknik, zërave të preventivit dhe materialeve të nevojshme për përmbushjen me sukses të investimit, edhe kthimin e gjëndjes së terrenit ku do të punohet të rehabilituar, pa cënuar dhe dëmtuar mjedisin përreth.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Librazhd, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**4. Tenderi me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”, me këto të dhëna:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-80105-09-15-2023 Urdhri nr. 860 prot., datë 14.09.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr.835, datë 06.09.2023 1.J.B -Kryetar 2.A.H -Anëtar 3.A.T -Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr.860 prot., datë 14.09.2023 1.J.B –Ing. Topog 2.A.H -Ing.Mjedisi 3.D.B –Juriste
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E hapur - Pune		<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 892 prot., datë 21.09.2023 1.J.M -Kryetar 2.XH.B -Anëtar 3.K.LL -Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh):</b> 25,952,112 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh):</b> BOE “R ” Sh.P.K & “V ” SHPK - 24,666,872 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh):</b> 1,285,240 lekë
<b>8.Data e hapjes së tenderit:</b> Data 03.10.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit.	<b>10. Operoret Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
<b>11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.7253 datë 16.11.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH):</b> 29,600,246 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës:</b> 15,964,986 lekë me Tvsh
<b>17. Situacion Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë: 80 dite</b>	<b>19. Zgjatja e kontratës: Jo</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 14.09.2023, nga NJP, i ndryshuar, nëpërmjet shtojcës nr. ska datë 20.09.2023.**

**Pika 2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 44 punonjës të siguar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave - Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 21 punonjës (1 inxhinier dhe 20 staf teknik), pra ngelen edhe 23 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

**Pika 2.3.5.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

Nr	Emërtimi	Sasia
1	Teknik Ndërtimi	(1 person)
2	Karpentier	(3 persona)
3	Shofere për përdorimin e mjeteve	(4 persona)
4	Hekurkthyes	(2 persona)
5	Suvatues	(4 persona)
	<b>Total</b>	<b>14</b>

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur për disponimin në listë-pagesë, si dhe numri. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit.

**Pika 2.3.6.** Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:



Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Njesi	Sasia
1	Kamioncine me kapacitet 1.5-2 ton	Në pronësi ose me qira	cope	2
2	Kamion me kapacitet 10-15 ton	Në pronësi ose me qira	cope	2
3	Kamioncine me kapacitet deri 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	cope	2
4	Kompresor	Në pronësi ose me qira	cope	1
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	cope	2
6	Autopompe betoni	Në pronësi ose me qira	cope	2
7	Autovinç	Në pronësi ose me qira	cope	1
8	Vibratore betoni	Në pronësi ose me qira	cope	2
9	Betoniere	Në pronësi ose me qira	cope	3
10	Skela metalike dhe rrjete mbrojtese per punime ne lartesi	Në pronësi ose me qira	M2	700
11	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	cope	1

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve që kërkohet dhe lloji i tyre, në përputhje me natyrën, sasinë dhe grafikun e punimeve.

-Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi si kamion vetëshkarkues 7-12 ton, kamioncinë deri në 3.5 ton, minieskavator dhe autobot uji, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i manovratorë/Automakinist për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara.

**Pika 2.3.9** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme);

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme);

Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme)

**Pika 2.3.10** Operatori ekonomik Ofertues duhet të dispononjë të paktën

-1 (një) punonjës pjesë e stafit të shoqërisë, të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”, nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,

-4 (katër) specialist të certifikuar për "Punime në lartësi", të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Detyrimisht të paraqitet kontratë pune dhe certifikata përkatëse të tyre.

-1 (një) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet të jetë detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

-Duke qenë se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi certifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet certifikuese ndaj dhe kjo certifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon OE për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. D.B , znj. J.B dhe znj. A.H .**

***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 25.10.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 02.11.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim me nr.s’ka datë 02.11.2023. Me shkresën nr. prot., s’ka datë 12.10.2023, NJP i është drejtuar BOE “R ” Sh.P.K dhe “V ” Sh.P.K për dorëzimin e dokumentacionit pranë Bashkisë Librazhd.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE (renditur OE diferenca më e lartë nga fondi limit – diferenca më e ulët), përkatësisht:*

1-OE “B ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike 24,559,760 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,392,352 lekë/5.4% më pak;

2-BOE “R ” Sh.P.K dhe “V ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike 24,666,872 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,285,240 lekë/4.9% më pak;

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e S’kualifikimit
OE “B ” Shpk	Skualifikuar: për shkak se: -Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se inxhinierët e deklaruar për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. -Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, nuk janë të angazhuara në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vleresimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Për shkak se punëtorja e publikuar dhe disa nga mjetet e publikuara nga operatori ekonomik janë të angazhuara në një procedurë tjetër që përfundon më 11.02.2024 operatori ekonomik nuk mund të kualifikohet fitues në këtë procedurë prokurimi.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues BOE “R ” Sh.P.K dhe “V ” Sh.P.K me ofertën ekonomike me vlerë 24,666,872 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,285,240 lekë/25.6% më pak.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>10</sup>, nga BOE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nga OE “R ” Shpk shpallur fitues nuk është dorëzuar vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara për energjinë elektrike të maturuara për muajin gusht 2023, duke qënë se data e hapjes së tenderit është 03.10.2023.

-Nga OE “V ” Shpk shpallur fitues nuk është dorëzuar vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara për energjinë elektrike të maturuara për muajin gusht 2023, duke qënë se data e hapjes së tenderit është 03.10.2023.

-Për mjetet e marra me qira nga OE “V ” Sh.P.K nuk plotësohet pika 2.3.6/c e DST, pasi AK ka kërkuar që *Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

-Nuk plotësohet pika 2.3.6, nuk është dorëzuar dokumentacioni për 2 autopompa betoni, nga BOE.

### **Konkluzion.**

BOE “R ” Sh.P.K dhe “V ” Sh.P.K, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

*-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. J.M , Kryetar, z. XH.B dhe znj. K.LL , Anëtarë.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 145/1 prot., datë 12.04.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 32/5 prot., datë 18.04.2024, “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” znj. D.B , znj. A.H , z. J.M , znj. K.LL , z. XH.B , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimi i Subjektit:*** Sqarojmë se, për këtë objekt prokurimi, është cituar se janë aplikuar kriteret kualifikimi të paargumentuara dhe jo në përputhje me rregullat e LPP, konkretisht: Njësia e Prokurimit për këtë objekt prokurimi sqaron se: Në procesverbalin e hartimit të dokumentave të tenderit, për çdo kriter kualifikues është vendosur baza ligjore, në bazë të të cilit është kërkuar si kërkesë kualifikuese.

*1.Për sa i përket faktit të përcaktimit në kriterin pika 3.3, të periudhës kohore të dëshimit të fuqisë punëtore për periudhën 3 muaj e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, argumentojme se ky përcaktim nuk është aspak kërkesë e paargumentuar dhe është në përputhje me LPP dhe RRPP. Periudha kohore 3 muaj, është një periudhë kohore tepër e shkurtër duke marrë në konsideratë grafikun e punimeve për realizimin e kontratës. Fakti që ligji përcakton psh., kërkimin e punëve të ngjashme për një periudhë kohore mbi 2 vite, e bën këtë kërkesë për dëshminë për disponimin e fuqisë punëtore të pranueshëm dhe tepër të thjeshtë për tu përmbushur nga OE.*

10 Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

2.Kërkesa e pikës 3.4 të DST, për 1 inxhinier mjedisi, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe Agjensia e Prokurimit Publik e ka cilësuar të saktë këtë kërkesë, në zbatim të plotë të projektit, specifitimeve teknike dhe zërave të preventivit. APP e ka vlerësuar si kriter të saktë dhe të rregullt.

3.Kërkesa e pikës 3.6 dhe 3.7 të DST, për mjetet e kërkuar dhe shoferet, janë kërkesa të cilat përputhje me objektin e prokurimit, zërat e punimeve dhe specififikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu për çdo procedurë prokurimi Titullari i AK, ka ngritur grupe pune të veçantë për përlllogaritjen e fondit limit, hartimit të kriterëve të vecanta teknike, listës së mjeteve, grafikut të punimeve etj. Njësia e Prokurimit mbështetur në analizën teknike dhe ligjore të këtij komisioni ka percaktuar edhe në DST, formulimin e kriterëve teknike të vecanta në DST, sikurse kriteri 3.6 dhe 3.7 në DST, përfshirë stafin teknik, mjetet e nevojshme, shoferet, manovratorët etj. Vendosja e çdo kriteri të vecantë është e dokumentuara dhe argumentuar teknikisht dhe ligjërisht me dosjen teknike të përlllogaritjes së fondit limit. Në fillim nga Njësia e Prokurimit janë kërkuar 4 shoferë, dhe APP ka kërkuar uljen e numrit të shoferëve, për këtë arsye Njësia e Prokurimit ka ulur numrin e shoferëve nëpërmjet një shtojce.

4.Në lidhje me përcaktimin e kriterit pika 3.7/c, e DST, për mjetet dhe makineritë e nevojshme për realizimin e kontratës, është kërkuar ndër të tjera që mjetet me qira të kenë në objekt të tyre edhe objektin e kontratës, për të garantuar që mjetet do të jenë në dispozicion të realizimit të veprës dhe jo në objekte të tjera. Kjo kërkesë është përcaktuar për të garantuar që punimet të realizohen në kohë dhe në cilësi.

5.Kërkesa 3.13 e DST për një ekspert për mbrojtjen nga zjarri, nuk është aspak një kërkesë e tepert, duke marrë në konsideratë faktin që kemi të bëjmë me punime në rreth 38 banesa të shperndara në fshatra të ndryshme dhe me zëra të punimeve sikurse instalime elektrike, hidraulike, ulluqe etj. Kemi menduar dhe gjykuar bazuar edhe në praktikën e mëparshme se është e domosdoshme që kompania të disponojë një ekspert zjarrfikës, për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve në banasa dhe sigurinë e tyre. APP e ka vlerësuar si kriter të saktë dhe të rregullt.

6.Kërkesat e përcaktuara në pikat 2.2.3 (për taksat vendore) dhe 3.11 në DST, janë të sakta dhe të mirëargumentuara. Fakti që këto kriterë nuk janë të vendosura në të gjithë DST të publikuara nga AK Bashkia Librazhd, nuk do të thotë që ne kemi vepruar me dy standarte, pasi AK i referohet edhe objekteve të mëparshme të ngjashme, dhe në asnjë dispozitë ligjore apo normative të prokurimeve publik nuk citohet apo shkruhet që duhet të kemi e njëjtet kriterë të vecantë teknike për çdo lloj procedure prokurimi, pasi objektet e prokurimit mund të kenë edhe kriterë teknike të vecanta referuar llojit të objektit të prokurimit, tipologjise së punimeve, vlerës së fondit limit, faktit që kemi të bëjmë me asfaltim rruge apo rikonstruksion banesa etj. Pra vendosja e tyre është specifike në varësi të objektit të prokurimit dhe të mirëargumentuara, sikurse janë të vlerësuar në tilla edhe nga APP. Por kjo nuk do të thotë aspak që këto kriterë vendosen me dy standarte sikurse vendosja e kriterëve pika 2.2.3 dhe 3.11 e DST. Ky konstatim i grupit të audituesve nuk qëndron dhe besojmë se duhet të hiqet në projektraport si i pambeshtetur.

7.Njësia e Prokurimit gjykon dhe argumenton se është e padrejtë që përgjegjësia ligjore të mbetet në njësisë së prokurimit për kriteret e vecanta teknike, për të cilat Titullari i AK, ka përcaktuar një komision të vecantë për hartimin dhe përcaktimin e tyre në përputhje me objektin e prokurimit, sikurse është e sanksionuar shumë mirë në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik. Ashtu sikurse, duhet të vlerësohet fakti që Njësia e Prokurimit ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me APP, dhe ka pranuar çdo sugjerim apo rekomandim të tyre për çdo procedure prokurimi, për të respektuar dhe zbatuar në mënyrë të plotë parimin e transparencës dhe të një vendimmarrje të drejtë. Ndodhur në këto rrethana do të kërkonim një gjykim me të drejtë kundrejt anëtar të njësisë së prokurimit pasi kanë respektuar pothuajse në mënyrë të plotë çdo rekomandim të APP.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Librazhd, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

6. Tenderi me objekt: **“Sistemim asfaltim i rrugës Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”**, me këto të dhëna:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rruges Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”.</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-73584-06-26-2023 Urdhri nr.557 prot., datë 25.05.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 553, datë 24.05.2023 1.J.B -Kryetar 2.A.H -Anëtar 3.XH.B -Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr.557 prot., datë 25.05.2023 1.D.B – Juriste 2.J.B – Ing.Topog 3.A.H – Ing. Mjedisi	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 755 prot., datë 11.07.2023 1.H.H -Kryetar 2.XH.B -Anëtar 3.K.LL -Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E hapur - Punë			
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh):</b> 83,237,019 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh):</b> OE “B ” Shpk - 59,789,314 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh):</b> 23,447,705 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 13.07.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit.		<b>10. Operatorët Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) S’kualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 5 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka		<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.5270 datë 11.08.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH):</b> 71,747,177 lekë		<b>16. Likuiduar pjesërisht sipas kontratës –</b> 22,056,048 lekë me Tvsh
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë:</b> 180		<b>19. Zgjatja e kontratës: Jo</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 26.06.2023, i ndryshuar, nga NJP.**

**Pika 2.3.3.** Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndërtimore, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**

Për secilin nga drejtuesit teknikë si me sipër të paraqitet :

- a) Kontratë pune;
- b) Diplomë ;
- c) Librezë pune;
- d) CV

Ekspertizat profesionale e Inxhinierit të Mjedisit është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në lidhje me kërkesën për **inxhinier mjedisi**, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit në fjalë.

**Pika 2.3.3/a.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit.

**Pika 2.3.3/b.** Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit.

**Pika 2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licencë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B”, së bashku me aktin e miratimit. - Në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të kërkojë disponimin e kësaj licence. Subjekti mund të lidhë kontratë shërbimi me një subjekt tjetër që ofron shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, pa qenë e nevojshme që të kryejë vetë këtë shërbim. Gjithashtu sipas paketës fiskale të vitit 2022 Bashkia Librazhd aplikon tarifën e grumbullimit dhe pastrimit nga mbetjet, tarifën e ndotjes, pra në kushtet kur bashkia e siguron shërbimin e pastrimit si dhe e tarifon subjektin për kohëzgjatjen e kantierit, është e panevojshme vendosja e kërkesës për disponimin e licencës së mësipërme.

**Pika 2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 3 pllakashtrues dhe 4 (katër) Manovratorë, nga të cilët 2 automakinistë dhe 2 eskavatoristë. Për manovratorët e mjeteve të renda, të paraqitet kontratë pune, dëshmi e drejtimit nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**Pika 2.3.6/a.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 4 (katër) Shoferë, te paraqitet kontrate pune, dëshmi e drejtimit nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Kërkesa e pikës 2.3.6 dhe 2.3.6/a në DST e cila kërkon 4 shoferë dhe 4 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës 2.3.12 të DST për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohen shoferët dhe manovratorët. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjetesh të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 6 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

**Pika 2.3.9.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 60 (gjashtëdhjetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për një periudhë 3 mujore nga data e zhvillimit të tenderit.

Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 60 të punësuar me formimin profesional hidraulik, karpentier, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër që në kërkesat 2.3.5, 2.3.6, 2.3.6/a, është përcaktuar përsëri numri i punonjësve dhe formimi profesional që kërkohet për zbatimin e kontratës. Në pikat 2.3.5, 2.3.6, 2.3.6/a, kërkohen gjithësej 13 punonjës dhe në këto kushte kur është përcaktuar numri dhe profesioni për zbatimin e kontratës, atëherë s’ka arsye të kërkohen edhe 47 punonjës të tjerë. Nuk argumentohet periudha prej 3 muajsh, se si ndikon në përmbushjen e kapaciteteve teknike. Për AK, sa i përket përmbushjes së kapaciteteve teknike, është e rëndësishme që në momentin kur OE merrë pjesë në procedurë, të ketë numrin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

**Pika 2.3.10.** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë

në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjise. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme, ose ekuivalente
- b) ISO 45001:2018 “Shëndetin dhe sigurimin në punë” e vlefshme,
- c) **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente.

-Kjo certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është e zaturuar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përhumbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor<sup>11</sup> që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkrete për përcaktimin/nejojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.<sup>12</sup>

**Pika 2.3.12.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës 10-12 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinq	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine kapaciteti mbajtës minimum 3.5-5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1-3 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	4 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Ekskavator me goma	4 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire me peshë 9 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet 10-13 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet 18 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompaktor	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	3 copë	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri prerese asfalti (sharre)	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri Vijezi	1 copë	Pronësi ose me qera
Paisje gjeodezike tip Nivelues me aksesore përkatës	1 copë	Pronësi ose me qera
Paisje gjeodezike tip Total station me aksesore përkatës	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike asfaltbetoni e pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 copë	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 copë	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Fabrike e prodhimit të elementeve të betonit, bordurave & pllakave	1 copë	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Fabrike Betoni	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	4 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Kulle ndriçimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator mbi 50 kva	1 copë	Pronësi ose me qera
Badipald per sinjalistike	1 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qera

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Sa më sipër është kërkuar kamion vet me kapacitet mbajtës mbi 20 ton (2 copë) dhe 10-12 ton (1 copë), numër i paargumentuar me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës.

<sup>11</sup> Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

<sup>12</sup> Pika 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

Janë kërkuar 4 eskavator me goma, 1 eskavator me zinxhirë me peshë 9 ton dhe 1 minieskavator me goma por në asnjë rast nuk argumentohet me analizë teknike. Pra sasia e dheut që do të gërmohet në një ditë pune (8 orë) dhe më pas në 1056 orë pune gjithësej (6 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të eskavatorëve.

Nuk analizohet kërkesa për fadrom dhe buldozer njëkohësisht, pasi të dy mjetet kryejnë zbankimin dhe rafshimin e dheut. Për më tepër që sipas zërave të punimeve, shoqëruar me analizë teknike, nuk parashikohet në asnjë rast përdorimi i buldozerit.

Është kërkuar rul me peshë mbi 18 ton, kërkesë e paargumentuar, për më tepër që në specifikimet teknike të projektit, është përcaktuar se rulat mund të jenë me peshë 5-12 ton.

**-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. D.B , znj. J.B dhe znj. A.H .**

***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 25.07.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 26.07.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe në datën 07.08.2023 është mbajtur raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 14.07.2023, KVO i është drejtuar OE “B ” Shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 07.08.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 6 OE/BOE, përkatësisht:*

OE “2 T” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 61,686,288 lekë pa TVSH.

OE “A ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 62,796,473 lekë pa TVSH.

OE “B ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 59,789,314 lekë pa TVSH dhe vlerë 71,747,177 lekë me TVSH.

BOE “E ” & “L ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 72,171,954 lekë pa TVSH.

BOE “SH ” & “K ” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 46,968,934 lekë pa TVSH.

BOE “K ” & “Udha” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 61,094,398 lekë pa TVSH.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE, për të cilët, referuar procesverbalit, të datës 25.07.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

OE/BOE	Kualifikuar/S’kualifikuar
BOE “SH ” & “SH ” ShPK	S’kualifikuar: për shkak se, Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”: BOE kane deklaruar në “Shtojcën 8” Mjekun E.H dhe Ing. L. P. pajisur me Certifikatë Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave. Certifikata e paraqitur nuk jane te vlefshme pasi permbajne datë skadence 28.02.2023. BOE nuk plotëson pikën 2.3.12 të kriterëve të veçanta të DST, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara në DST për mjetin ESKAVATOR ME GOMA, GREJDER ME GOMA, FADROMA ME GOMA, MINIESKAVATOR ME GOMA. Sqarojmë se për mjetet e mesiperme BOE ka paraqitur fature TVSH, Deklarate Doganore, por AK në DST ka përcaktuar se për mjetet me goma që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit si: - çertifikaten e pronesisë; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit. BOE nuk plotëson pikën 2.3.11 te DST BOE nuk kane paraqitur kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “B ” Sh.P.K me ofertën ekonomike me vlerë 59,789,314 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 23,447,708 lekë/28% më pak.

-S’kualifikimi i ofertës nga KVO qëndron.

**Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>13</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

<sup>13</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Nuk është plotësuar pika **2.2.3** e **DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Tiranë, Elbasan, Vorë, Belsh, Librazhd dhe Cerrik përgjatë periudhës 2021 dhe përgjatë vitit 2022 nuk janë dorëzuar për aktivitetet e kryera në Bashkinë Tiranë, Elbasan, Vorë dhe Librazhd.

-Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin maji 2023, për të cilin është maturuar detyrimi i energjisë elektrike.

Nuk plotësohet kërkesa për mjetet e marra me qira nga A.K , pasi në kontratën e qirasë nuk specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

-Nuk është plotësuar pika **2.3.12**, pasi sipas shtojcës 8, kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targë AB997HA, kamioni me targë AA538FT, kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton me targë EL361C, autobetoniere me targë AA092JN të marra me qira, OE nuk ka dorëzuar certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.

-Nuk është plotësuar pika **2.3.12**, pasi sipas shtojcës 8, për kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, OE ka deklaruar mjetin me targë AA578OD, i cili e ka marrë me qira me Nr.2206 Rep., Nr.1016 Kol., datë 14.06.2023, nuk është dorëzuar certifikata për transportin e mallrave për të tretë dhe me qira.

Nuk plotësohet pika 2.3.6/a, pasi Dëshmia e aftësisë profesionale për z. R.S i ka mbaruar afati.

-Certifikatat e aftësisë profesionale për shoferin A.K të pajisur me leje drejtimi të kategorisë C, i ka mbaruar afati;

-Certifikatat e aftësisë profesionale për shoferin A.K të pajisur me leje drejtimi të kategorisë DE, i ka mbaruar afati;

-Certifikatat e aftësisë profesionale për shoferin B.H të pajisur me leje drejtimi të kategorisë DE, i ka mbaruar afati;

-Certifikatat e aftësisë profesionale për shoferin L.B të pajisur me leje drejtimi të kategorisë C, i ka mbaruar afati;

### **Konkluzion.**

OE “B ”, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

**-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. H.H , Kryetar, z. XH.B dhe znj. K.LL , Anëtar.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 145/1 prot., datë 12.04.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 32/5 prot., datë 18.04.2024, “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” znj. D.B , znj. A.H , z. J.M , znj. K.LL , z. XH.B , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se, për këtë objekt prokurimi, është cituar se janë aplikuar kriteret kualifikimi të paargumentuara dhe jo në përputhje me rregullat e LPP, konkretisht: Njësia e Prokurimit për këtë objekt prokurimi sqaron se: Në procesverbalin e hartimit të dokumentave të tenderit, për çdo kriter kualifikues është vendosur baza ligjore, në bazë të të cilit është kërkuar si kërkesë kualifikuese.

1.Kërkesa e pikës 3.4 të DST, për inxhinier mjedisi drejtues teknik në licensën e shoqërisë, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit. Përveç faktit që kemi të bëjmë me një vepër publike të një lloji të vecantë – asfaltim, e cila përmban kategori punimesh speciale dhe teknike të rëndësishme të vecantë të mbrojtjes së mjedisit. Në akt konstatim është përmendur që njësia e prokurimit ka kërkuar inxhinier ndërtimi profili transport, ndërkohë që në procedurat e tjera nuk e ka kërkuar, duke vepruar në dy standarte. Njësia e Prokurimit në lidhje me këtë citim gjykon se ky këndvështrim është i padrejtë nga Grupi i audituesve pasi një kërkesë e tillë është vendosur edhe në objekte të tjera, Fakti që këto kriteret nuk janë të vendosura në të gjithë DST të publikuara nga AK Bashkia Librazhd, nuk do të thotë që ne kemi vepruar me dy standarte, pasi AK i referohet edhe objekteve të mëparshme të ngjashme, dhe në asnjë dispozitë ligjore apo normative të prokurimeve publik nuk citohet apo shkruhet që duhet të kemi të njëjtët kriteret të vecante teknike për cdo lloj procedure prokurimi, pasi objektet e prokurimit mund të kenë edhe kriteret teknike të vecanta referuar llojit të objektit të prokurimit, tipologjisë së punimeve, vlerës së fondit limit, faktit që kemi të bëjmë me asfaltim rruge apo rikonstruksion banesa



etj. Pra vendosja e tyre është specifike në varësi të objektit të prokurimit dhe të mirëargumetuara, sikurse janë të vlerësuara të tilla edhe nga APP.

2.Njësia e Prokurimit gjykon dhe argumenton se është e padrejtë që përgjegjësia ligjore ti mbetet njësisë së prokurimit për kriteret e vecanta teknike, për të cilat Titullari I AK, ka përcaktuar një komision të vecantë për hartimin dhe përcaktimin e tyre në perputhje me objektin e prokurimit, sikurse është e sanksionuar shumë mirë në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik. Ashtu sikurse, duhet vlerësuar fakti që Njësia e Prokurimit ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me APP, dhe ka pranuar çdo sugjerim apo rekomandim të tyre për çdo procedurë prokurimi, për të respektuar dhe zbatuar në mënyrë të plotë parimin e transparencës dhe të një vendimmarrje të drejtë. Ndodhur në keto rrethana do të kërkonim një gjykim me të drejtë kundrejt anetare të njësisë së prokurimit pasi kanë respektuar pothuajse në mënyrë të plotë çdo rekomandim të APP.

3.Kërkesa e pikës 3.5 të DST, për 3 punonjës teknik ndërtimi, është një kërkesë në perputhje me objektin e prokurimit dhe është kërkuar si staf mbështetës dhe jo si drejtues teknik në license, çka mund të plotësohet nga OE të interesuar edhe nëpërmjet një kontratë të thjeshtë pune. Duke patur në konsideratë që kemi të bëjmë me asfaltim rruge të një zone rurale, kemi gjykuar dhe argumentuar që është e nevojshme që kompania e cila do të zbatojë punimet të ketë të punësuar edhe teknike ndërtimit të mjaftueshëm. Është vlerësuar një kriter i vlefshëm dhe i sakte nga APP.

4.Kërkesa e pikës 3.9 të DST, për mjetet e kërkuar, janë kërkesa të cilat përputhje me objektin e prokurimit, zërat e punimeve dhe specifikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu për çdo procedurë prokurimi Titullari i AK, ka ngritur grupe pune të vecantë për përlllogaritjen e fondit limit, hartimit të kriterëve të vecanta teknike, listes së mjeteve, grafikut të punimeve etj. Njësia e Prokurimit mbështetur në analizen teknike dhe ligjore të këtij komisioni ka përcaktuar edhe në DST, formulimin e kriterëve teknike të vecanta në DST, sikurse 3.9 në DST, përfshirë stafin teknik, mjetet e nevojshme, shoferët, manovratorët etj. Vendosja e çdo kriteri të vecantë është e dokumentuara dhe argumentuar teknikisht dhe ligjërisht me dosjen teknike të përlllogaritjes së fondit limit dhe nga projektuesi.

5.Kërkesa e pikës 3.9/a, të DST, sqarojmë linje inerte dhe jo fabrika asfaltoshtruese: Njësia e Prokurimit argumenton dhe sqaron se ky kriter i vecantë kualifikues, për nyje inertesh e cila duhet të ndodhet në distancë me të madhe se 35 km nga objekti që të mundësohet përmbushja standrteve të përcaktuara në VKM Nr 628 date 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, mbështetet në cilësitë teknike dhe kapacitetet teknike të prodhimit dhe transportimit të inerteve dhe në VKM nr. Nr 628 datë 15.07.2015 “Per miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”. Distanca e kërkuar jo me të madhe se 35 km nga objekti, është kërkuar për të ruajtur cilësinë materialet inerte në mënyrë që punimet dhe materialet për realizimin e objektit të jenë cilësore dhe të ruajne vetinë e tyre.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Librazhd, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**Pretendimi i Subjektit:** Komisioni i Vlerësimit të ofertave, në bazë të materialeve që disponohen në dosjet e prokurimit por edhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit publik arsyeton se duhet të merret për bazë dhënia e këtij opinionit.

1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

2. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

3. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

4. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

5. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

6. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

7. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Librazhd, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

#### - **Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.**

Për periudhën 01.05.2023 – 31.12.2023, Bashkia Librazhd referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 24 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë kontrate 11,875,124 lekë pa TVSH.

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej 361 OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar 156 OE/BOE.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

-4 procedura prokurimi (blerje të vogla) për periudhën objekt auditimi me vlerë kontrate 2,671,955 lekë të fondit të kontratave të lidhura për periudhën 01.05.2023-31.12.2023;

Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 4 raste urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas pikës 8 në udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

- Në 2 raste komisioni i blerjeve të vogla nuk ka argumentuar teknikisht kriteret që ka kërkuar në ftesën për ofertë.

- Në 4 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

- Në 3 raste afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla si dhe nuk janë përlllogaritur penalitetet;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Pika 4 në nenin 75, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 2 në nenin 80 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pika 8 dhe 17 në Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Pika 5 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e panit të zbatimit të kontratës”; Pika 43 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik; Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbtimit të buxhetit”; Neni 12 dhe 13 i Ligjit për Normat Teknike Profesionale për Arkivat si dhe nenin 32 në ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

### **Më hollësisht rastet trajtuar si më posht vijon:**

#### **1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Dekori i Qytetit Viti i Ri”.**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 978 datë 23.10.2023, për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit të kontratës, përcaktimi i specifikimeve teknike si dhe hartimin e grafikut të lëvrimit për procedurën e prokurimit me përbërje si vijon, z. Ç.V , Kryetar, znj. T.H dhe z. E.N Anëtarë;

-Urdhri nr. 391, datë 03.04.2023, i ndryshuar, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, znj. M.D , znj. K.LL dhe znj. M.M ;

-Urdhri nr. 1004, me nr. 6945 prot., datë 31.10.2023, i prokurimit për dekorin e qytetit për vitin e ri.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 833,333 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.1085, datë 21.11.2023 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. C.V , z. A.A dhe z. E.S ;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 11.12.2023 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 6946 prot., datë 31.10.2023, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 49/2023, datë 18.01.2023, në vlerën e 830,400 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: znj. M.D , znj. K.LL dhe znj. M.M , ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “A.Ç” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 650,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 06.11.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 06.11.2023 OE “A.Ç” shpk, nuk ka paraqitur dokumentat e procedurës së prokurimit pranë AK si dhe nuk ka bërë kërkesë tërheqje; AK ka vazhduar me OE “E ” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 678,900 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 07.11.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 07.11.2023 OE “E ” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “E ” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, për shkak të një llogaritje gabim. Kërkesa e tërheqjes administrohet në dosjen fizike dhe në sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “E ” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 692,000 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 141,333 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 08.11.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Librazhd përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. B.P dhe Operatorit Ekonomik “E ” Shpk me administrator z. E.L është lidhur Kontratë Publike për furnizimin e mallrave me nr. 7301 prot., datë 20.11.2023 për “Dekori i Qytetit për Vitin e Ri sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Librazhd dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 7 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas pikës 8 në udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-OE “E ” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Nuk administrohet deklaratë garancie për mallin e prokuruar, për ti dhënë garanci autoritetit kontraktor për mallin e prokuruar;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 7 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues ka lidhur kontratën me Bashkinë Librazhd më datë 20.11.2023, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 27.11.2023, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 11.12.2023, pra 14 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, znj. M.D , znj. K.LL dhe znj. M.M si dhe komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave me përbërje z. Ç.V , z. A.A dhe z. E.S .*

## **2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Pastrim Pyjesh AH”.**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 516 datë 12.05.2023, për ngritjen e komisionit të përlogaritjes së fondit limit të kontratës, përcaktimi i specifikimeve teknike si dhe hartimin e grafikut të lëvrimit për procedurën e prokurimit me përbërje si vijon, z. A.B, Kryetar, z. Q.F dhe z. A.K Anëtarë;

-Urdhri nr. 526, datë 16.05.2023, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. D.T , znj. K.LL dhe znj. M.M ;

-Urdhri nr. 526, me nr. 3510 prot., datë 16.05.2023, i prokurimit për pastrim pyjesh AH.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 995,808 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.1022, datë 06.11.2023 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim me përbërje: z. Q.F , z. A.K dhe z. R.Ç ;

-Procesverbali (pa nr. prot.) datë 18.12.2023 i marrjes në dorëzim mbi punimet e kryera për përmisimin e pyjeve;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 3518 prot., datë 16.05.2023, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 1/2023, datë 28.12.2023, në vlerën e 1,168,992 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. D.T , znj. K.LL dhe znj. M.M , ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “B.Ç” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 699,900 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 19.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 19.05.2023 OE “B.Ç” shpk, është tërhequr nga procedura e prokurimit; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave OE “B.Ç” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “V.Ç” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 799,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.05.2023 OE “V.Ç” Shpk nuk ka paraqitur dokumentat pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “L ” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 892,980 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 24.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 24.05.2023 OE “L” Shpk nuk ka paraqitur dokumentat pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “4 S” Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 940,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.05.2023 OE “4 S” Shpk nuk ka paraqitur dokumentat pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “J ” Shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 944,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 29.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 29.05.2023 OE “J ” Shpk nuk ka paraqitur dokumentat pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “O ” Shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 969,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 30.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 30.05.2023 OE “O ” Shpk është tërhequr nga procedura e prokurimit; Sipas informacionit të pasqyryar në dokumentet e vlerësimit të ofertave OE “O ” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me BOE “C ” Shpk dhe “S” Shpk i renditur në vendin e shtatë me ofertën 974,160 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 21,648 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 30.05.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Librazhd përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. B.P dhe BOE “C ” Shpk me administrator z. H.C dhe “S ” Shpk me administrator K. S është lidhur Kontratë Publike për shërbime me nr. 3860 prot., datë 02.06.2023 për “Pastrim Pyjesh AH” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Librazhd dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, afati i realizimit të shërbimit do të jetë 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas pikës 8 në udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se komisioni i blerjeve të vogla nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përcaktimin e sipërfaqeve dhe zonave ku duhet të kryhet pastrimi i pyjeve si dhe nuk janë bërë matjet në terren dhe sipërfaqja e përcaktuar në ftesën për ofertë nuk është e argumentuar dhe dokumentuar.

-Nuk është kërkuar formulari i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 për OE pjesmarrës;

-**Në pikën 2.3.3**, në ftesën për ofertë është kërkuar që OE ofertues per realizimin e shërbimit duhet të ketë në përberje minimumi 2 specialistë të profileve me eksperiencë pune në fushat respektive, në profesionet si më poshtë:

-1 (një) Inxhinier.Pyjesh (Drejtuesi teknik),

-1 (një) Inxhinier Pyjesh

Kërkesa për të pasur 2 Inxhinier pyjesh nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, vendosja e 2 inxhinierve është e panevojshme në realizimin e kësaj kontrate.

-**Në pikën 2.2.4**, Subjekti gjithashtu, duhet të ketë në përbërjen e tij nga Janari 2023 e në vazhdim, gjithsej 10 punonjës të regjistruar (Staf teknik dhe punëtorë), që do të vërtetohen nga listepagesat mujore dhe kontributet e derdhura - Numri i punonjësve të mësipërm nuk është i argumentuar nga AK, duke u bazuar në analizë teknike, grafikun e punimeve, orët e punës që duhen për të realizuar secilin prej zërave të punimeve sipas preventivit.

-**Në pikën 1.3.5**, është kërkuar një mjet por në asnjë rast nuk është kërkuar dhe disponimi i një shoferi.

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-OE “C ” Shpk dhe “S ” Shpk i shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

**Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, z. D.T , znj. K.LL dhe znj. M.M .**

**3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje Stufa Zjarri”.**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 680 datë 23.06.2023, për ngritjen e komisionit të përlogaritjes së fondit limit të kontratës, përcaktimi i specifikimeve teknike si dhe hartimin e grafikut të lëvrimin për procedurën e prokurimit me përbërje si vijon, znj. M.D , Kryetar, znj. V. G.dhe z. A.T , Anëtarë;

-Urdhri nr. 886, datë 20.09.2023, për ngritjen e komisionit të prokurimit me përbërje, znj. E.P , znj. K.LL dhe znj. M.M ;

-Urdhri nr. 886, me nr. 6068 prot., datë 20.09.2023, i prokurimit për blerje stufa zjarri.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 625,000 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr. 6995, datë 02.11.2023 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje, z. A.A , znj. T.H dhe z. A.A ;

-Procesverbali nr. prot., s’ka, datë 13.11.2023 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 6091 prot., datë 20.09.2023, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 82/2023, datë 13.11.2023, në vlerën e 491,970 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje, znj. E.P , znj. K.LL dhe znj. M.M , ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “A.K ” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 409,975 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 215,025 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.09.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Librazhd përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. B.P dhe OE “A.K ” Shpk me administrator z. M.K është lidhur Kontratë Publike për furnizimin e mallrave me nr. 6917 prot., datë 30.10.2023 për “Blerje Stufa Zjarri” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Librazhd dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 7 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas pikës 8 në udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-OE “A.K ” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 7 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues ka lidhur kontratën me Bashkinë Librazhd më datë 30.10.2023, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 06.11.2023, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 13.11.2023, pra 7 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura

nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, znj. E.P , znj. K.LL dhe znj. M.M si dhe komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave me përbërje z. A.A , znj. T.H dhe z. A.A .*

#### **4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion i Taracës së Godinës Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”.**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.1055 datë 15.11.2023, për ngritjen e komisionit të përlogaritjes së fondit limit të kontratës, përcaktimi i specifikimeve teknike si dhe hartimin e grafikut të lëvrimin për procedurën e prokurimit me përbërje si vijon, znj. A.H , Kryetar, z. XH.B dhe znj. T.H , Anëtarë;

-Urdhri nr. 1056, datë 16.11.2023, për ngritjen e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, me përbërje, znj. M.D , znj. K.LL dhe znj. M.M ;

-Urdhri nr. 1056, me nr. 7249 prot., datë 16.11.2023, i prokurimit për rikonstruksionin e taracës së godinës së Njësisë Administrative Qëndër, Bashkia Librazhd.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 666,709 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.131, datë 29.01.2024 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. XH.B , z. E.GJ dhe znj. A.H ;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 06.02.2023 i marrjes në dorëzim në dorëzim të punimeve;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 7287 prot., datë 16.11.2023, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzohet dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: znj. M.D , znj. K.LL dhe znj. M.M , ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “SH.M ” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 548,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 20.11.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 19.05.2023 OE “SH.M ” shpk nuk ka paraqitur dokumentat e procedurës së prokurimit pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “A ” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 590,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.11.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.05.2023 OE “A ” Shpk nuk ka paraqitur dokumentat e procedurës së prokurimit pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “R ” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 595,820 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 70,889 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.11.2023 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Librazhd përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. B.P dhe OE “G ” Shpk me administrator z. T.K është lidhur Kontratë Publike për shërbime me nr. 7640 prot., datë 05.12.2023 për “Rikonstruksion i taracës së godinës njësisë Administrative Qendër Bashkia Librazhd” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Librazhd dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, afati i realizimit të shërbimit do të jetë 10 ditë nga data e lidhjes së kontratës;

#### ***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas pikës 8 në udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Në hartimin e kriterëve, komisioni i përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike duhet ti argumentoj teknikisht dhe ligjërisht sipas preventivit të punimeve. Në ftesën për ofertë është kërkuar manovrator por në asnjë rast nuk është kërkuar mjet që duhet për procedurën e prokurimit.

**-Në pikën 3.2,** Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

1) **NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve** (Punime për prishjen e ndërtimeve) - Nuk është në përputhje me preventivin e punimeve, sipas të cilit nuk ka zëra konkret punimesh që përputhen me këtë kategori licence të kërkuar.

**-Në pikën 3.3,** Duke vlerësuar llojin, volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve të vendosur nga projektuesi për këtë objekt, çdo shoqëri pjesëmarrëse, duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi i një punësim mesatar minimumi prej 7 personave gjithësej (duke përfshirë dhe stafin drejtues dhe teknik), për periudhën Korrik - Shtator 2023 - Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 7 të punësuar me formimin profesional hidraulik, elektrikist Shofer etj., ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet "Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin".

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, për numrin e punonjësve që ka në dispozicion OE i shpallur fitues, ka deklaruar se ka 3 shoferë ndërkohë që nga AK nuk është kërkuar asnjë mjet.

**-Në pikën 3.4,** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm :

1.a-Inxhinier ndërtimi.

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

-Diplomë

b-Çertifikuar për sigurimin teknik e mbrojtjes ne pune

-Çertifikatë trajnimi;

2- Të ketë të punësuar.

a-Drejtues të mjeteve të rënda (monovrator) 1 (një)

b-Suvatues/murator me dëshmi nga shkolla të mesme profesionale 2 (dy)

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

- Dëshmi kualifikimi

-Kërkesa e mësipërme për drejtues të mjeteve të rënda është e panevojshme dhe nuk argumentohet teknikisht dhe ligjërishit pasi AK në ftesën për ofertë nuk ka kërkuar asnjë mjet.

**-Në pikën 3.5,** Shoqëria duhet të paraqesë:

a-Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)

b-Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme)

-Nuk argumentohet vendosja e certifikatave të mësipërme dhe rolin që kanë ato në vërtetimin e cilësisë së punimeve që do kryhen në këtë procedurë prokurimi. Për certifikatat e mësipërme nuk është vendosur edhe mundësia e dorëzimit të certifikatës ekuivalente të saj, të njohura nga standardet shqiptare.

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-OE "G" Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues ka lidhur kontratën me Bashkinë Librazhd më datë 05.12.2023, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 15.12.2023, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 06.02.2024, pra 51 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.



**Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, znj. M.D , znj. K.LL dhe znj. M.M si dhe komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave me përbërje z. XH.B , z. E.GJ dhe znj. A.H .**

**2.4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.**

### **1. “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjia Mirakë Plane Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd.**

#### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1424 prot date 16.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd, të përfaqësuar nga Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë z. B.P dhe Operatorit Ekonomik “B ” SHPK, me përfaqësues z. A.P me licencë profesionale NZ 3625/24. Vlera e kontratës është 21,296,088 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1389 prot, datë 15.03.2023, është lidhur kontrata me OE “Z ” SHPK me Drejtues Ligjor z. L.H , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3360/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 415,722 lekë me tvsh. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3966 prot., datë 07.06.2023, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “S ” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2010/4 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 60,000 lekë me TVSH. Aktkolaudimi është mbajtur në datën 22.09.2023. Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit në dosje administrohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim, e hartuar me shkresën nr. 6619 prot., datë 13.10.2023 nga ing. XH.B , ing. E.Q dhe ing. Mjedisi A.H , në zbatim të Urdhrit të titullarit me nr. 918, datë 02.10.2023.

#### **Projektpreventivi**

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “Z ” ShPK në vitin 2022.

#### **Zbatimi i punimeve**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 16.03.2023, duhet të përfundonin në datën 16.04.2023. Është bërë pezullimi i punimeve në datën 27.03.2023 (pas 11 ditëve punë) deri në datën 10.05.2023 dhe kanë përfunduar me datë 30.05.2023.

Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 1639 prot, datë 27.03.2023 është bërë kërkesë për pezullim punimesh, për shkak të kontestimit të banorëve pasi gjatë procesit të gërmimit u bë dëmtimi i tubacionit të ujësjellësit, realizuar me kontributin e banorëve. Është mbajtur në datën 27.03.2023 procesverbali i pezullimit të punimeve, i nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i Invesitorit. Me shkresën e protokolluar me nr. 3448 prot., datë 10.05.2023 është bërë njoftimi i rifillimit të punimeve. Është mbajtur në datën 10.05.2023 procesverbali i rifillimit të punimeve, i nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i Invesitorit. Është mbajtur Aneks kontrate, me nr 1685 prot., datë 28.03.2023, sipas të cilit është bërë shtyrja afatit të përfundimit të punimeve me 45 ditë.

Është hartuar dhe miratuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që shtohen/hiqen në vlerën 1,176,474/1,176,968 lekë pa TVSH (ose rreth 5.5 % e vlerës totale), i nënshkruar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Librazhd, z. B.P .

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 1424 prot datë 16.03.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 21,296,088 lekë <b>OE fitues “B ” SHPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh <b>21,295,594 lekë</b> -Vlera pa tvsh <b>17,746,328 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 74 ditë. Fillimi punimeve: 16.03.2023 Perfundimi punimeve : 30.05.02023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament me nr 1685 prot., datë 28.03.2023, shtyrja e afatit me 45 ditë.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “Z ” SHPK	Licenca Nr: MK 3360/3	Kontrata me nr 1389 prot, datë 15.03.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “S ” SHPK	Licenca Nr: MK 4146/1	Kontrata nr. 3966 prot., datë 07.06.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 22.09.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Datë 13.10.2023		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **224,115 lekë pa tvsh.**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV bordura 15 x 30 cm, çmimi” dhe “FV tub çeliku Ø>200 mm të paizoluara, për intersektimin e KUB”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1424 prot datë 16.03.2023.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1389 prot, datë 15.03.2023.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 3966 prot., datë 07.06.2023.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 224,115 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. L.H me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. S.Ç me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, nuk është observuar nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve.

## **2. “Rikonstruksion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd.**

### Kontratata

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1967 prot datë 11.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd, të përfaqësuar nga Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë z. B.P dhe Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë “A ” ShPK & “Z ” SHPK, me përfaqësues respektivisht z. A.GJ me licencë profesionale NZ 4947/9 dhe z. Z.Z .

Vlera e kontratës është 46,800,089.4 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 61 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshi të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1688 prot., datë 28.03.2023, është lidhur kontrata me OE “Z ” SHPK me përfaqësues z. L.H , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3360/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 902,527 lekë me tvsh. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 4963 prot., datë 24.07.2023, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “S ” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2010/4 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 96,000 lekë me TVSH. Aktkolaudimi është mbajtur në datën 03.09.2023. Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit në dosje administrohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim, e hartuar me shkresën pa nr. prot., datë 29.09.2023 nga ing. J.M , administratori i Nj.A. Polis Partizan Ballolli dhe ing. mjedisi A.H , në zbatim të Urdhrit të të titullarit me nr. 903, datë 22.09.2023.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje Infrastrukturore me nr. 637, datë 03.05.2023.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “Z ” ShPK në vitin 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 04.05.2023, duhet të përfundonin në datën 31.07.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e punimeve.

Me shkresën nr. 20 prot., datë 20.06.2023, mbikëqyrësi i punimeve ka përcjellë kërkesën e sipërmarrësit të punimeve për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 30 ditë, për shkak të ankesave të banorëve dhe kushteve amosferike. Ne shkresën nr. 4401, date 26.06.2023 është hartuar Aneksi i Kontratës, sipas të cilit, miratohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 30 ditë, deri në daën 01.08.2023.

- Pas kërkesës së sipërmarrësit të punimeve, me shkresën me nr. 16 prot, datë 16.06.2023, Mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar investitorit Bashkia Librazhd kërkesën për rishikim projekti. Pas kësaj kërkesë, është hartuar dhe miratuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që htohen/hiqen në vlerën 6,620,702/5,257,592 lekë me TVSH (ose rreth 14.5 % e vlerës totale), i nënshkruar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Librazhd, z. B.P . Këto ndryshime do të kërkojnë edhe përdorimin e fondit rezervë në vlerë 1,135,924 lekë.

Është bërë negociimi i çmimit të një zëri pune “FV bordura betoni 15 x 25 cm”, i cili rezultoi të jetë pranuar më i ulët se çmimi i manualit të çmimeve në fuqi.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 1967 prot datë 11.04.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 46,800,089.4 lekë <b>BOE fitues “A ” ShPK &amp; “Z ” SHPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 31,125,719 lekë -Vlera pa tvsh 25,938,099 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 61 ditë , Zbatuar 172 ditë. Fillimi punimeve: 04.05.2023 Përfundimi punimeve : 30.12.2019		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament me nr 4401, date 26.06.2023, shtyrja e afatit me 30 ditë	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “Z ” SHPK	Licenca Nr: MK 3360/3	Kontrata me nr 1688 prot, datë 28.03.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “S ” SHPK	Licenca Nr: MK 4146/1	Kontrata nr. 4963 prot., datë 24.07.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 03.09.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Nuk ka.		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë ...lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti

Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **138,800 lekë pa tvsh**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1967 prot datë 11.04.2023; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1688 prot, datë 28.03.2023; Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 4963 prot., datë 24.07.2023.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 138,800 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. L.H me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. S.Ç me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, nuk është observuar nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve.

**2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.**

Bashkia Librazhd ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 10, datë 08.02.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi. Ky plan është ndryshuar me Vendim të KKT-së nr. 08, datë 28.12.2020.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit

**Lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe përdorimit për periudhën 01.05.2023 - 31.12.2023**

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Librazhd, rezulton se për afatin e auditimit **01.05.2023 deri në 31.12.2023**, ka pasur **61 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh**, më konkretisht, ka pasur **17 aplikime për pajisje me leje zhvillimi** (miratuar 12 / refuzuar 5); **3 aplikime për pajisje me leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>** (miratuar 2 / refuzuar 1); **11 aplikime për pajisje me leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m<sup>2</sup>** (miratuar 8 / refuzuar 3); **8 aplikime për pajisje me deklaratë paraprake për kryerje punimesh** (miratuar 7 / refuzuar 1); **6 aplikime për pajisje me çertifikatë përdorimi** (miratuar 5 / refuzuar 1); **4 aplikime për pajisje me leje infrastrukture** (miratuar 2 / refuzuar 2). Informacioni i mësipërm është evidentuar i detajuar në tabelën përmbledhëse në *Tabelën nr. 1*.

*Tabela nr. 1 – 01.05.2023-31.12.2023*

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	17	12	5
Leje ndërtimi mbi 250m <sup>2</sup>	3	2	1
Leje ndërtimi deri 250m <sup>2</sup>	11	8	3
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	8	7	1

Rikonstrukcion	1	1	0
Çertifikatë përdorimi	6	5	1
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m <sup>2</sup>	1	0	1
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	0	0	0
Ndryshim funksioni	2	1	1
Njoftim fillim punimesh	8	7	1
Shtyrje afati leje ndërtimi	0	0	0
Leje infrastrukture	4	2	2

Burimi: DPZHMT, Bashkia Librazhd

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (këtu e në vazhdim DPZHMT), Bashkia Librazhd, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të vogël se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **8 leje**, ndërsa çertifikata përdorimi janë miratuar **5 të tilla**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m<sup>2</sup> dhe çertifikata përdorimi:

Nr.	Kategoria	Objekti	Zhvilluesi	Vendimi	Preventivi
1	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	Ndërtim i shkollës së mesme 'Polis' dhe ndërtim Palestre	Bashkia Librazhd	Vendim nr. 688, datë 06.12.2023	111,776,515 lekë
2	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m <sup>2</sup>	Banesë individuale 1 kat + çati	Z. F.RR	Vendim Nr. 665; datë 09.10.2023	4,495,290 lekë
3	Çertifikatë përdorimi	Shtesë anësore të objektit ekzistues 1 kat shërbim dhe shtesë ndërkat	Z. B.A	Vendim nr. 659, datë 31.08.2023	-

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

**1.** Leje ndërtimi për ndërtimin e shkollës së mesme 'Polis' dhe ndërtim palestre, me adresë në fshatin Polis, me zhvillues Bashkia Librazhd, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon një prerje teknike dhe dy fasada teknike, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

- Mungon planvendosja e miratuar dhe pozicionimi mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika c);

- Mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 16 të Ligjit Nr. 124/2015, "Për efikasitetin e energjisë", i ndryshuar, si dhe nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika e), ë), g);

- Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri, së bashku me dokumentacionin shoqërues, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika e), ë), g), si dhe pika 1/1, nënpika iv) e po këtij neni;

- Mungon studimi sismik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqërues, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika e), ë), g), si dhe VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me

*vertetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, shtojca 2;*

- Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore, siç janë çertifikata e regjistrimi në QKB ose ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon relacioni teknik për projektin elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemve të ngrohje-ftohjes, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

- Mungojnë licencat personale profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik, elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemve të ngrohje-ftohjes, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

**2. Leje ndërtimi për banesë individuale 1 kat + çati, me adresë në fshatin Mirakë, Bashkia Librazhd, me zhvillues z. F.RR , për të cilën është marrë Vendimi Nr. 665, datë 09.10.2023, me problematika si më poshtë vijon:**

- Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesit e projektit arkitektonik, rievimit topografik dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, siç janë çertifikata e regjistrimi në QKB ose ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje teknike. Fasadat teknike nuk janë të sakta, pasi janë pamje tre-dimensionale, pra nuk janë hartuar sipas rregullave teknike për hartimin e dokumentave ndërtimore, nuk japin informacion mbi dimensionimin e fasadave dhe materialet e përdorura, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).

**3. Çertifikatë përdorimi për shtesë anësore të objektit ekzistues 1 kat shërbim dhe shtesë ndërkati, me adresë në Rruga “Babje”, Bashkia Librazhd, me zhvillues z. B.A , për të cilën është marrë Vendimi nr. 659, datë 31.08.2023., me problematika si më poshtë vijon:**

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika i);

- Mungon akti përkatës (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), i lëshuar nga institucionet kompetente për menaxhimin e mbetjeve urbane, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon projekti “A”, ose projekti i ndryshuar, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika g);

- Mungojnë fotografitë të objektit në të katërta orientimet, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika j). Grupi i auditimit nuk mund të shprehet nëse objekti i ndërtuar është i njëjtë me atë të miratuar;

- Mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, më konkretisht mungon akti i përfundimit të themeleve dhe kuota 0.00, përfundimi i karabinasë për shtesën, përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik, përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike

ekzistuese, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 27/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1;

- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika c), ç), e), ë), g); pika 1/1, nënpika iv); neni 27/1, pika 1; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), gj), i), j); Ligji Nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, neni 16; Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, shtojca 2.

### **Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:**

- Z. M.D , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (Për procedurat nr. 1, 2, 3);
- Znj. B.B , në cilësinë e ish-drejtorit të DPZHMT (Për procedurat nr. 2,3);
- Z. K.B , në cilësinë e ish-drejtorit të DPZHMT (Për procedurën nr. 1);
- Znj. A.H , në cilësinë e spec.-ing. proj. pranë DPZHMT (Për procedurën nr. 1);
- Z. E.GJ , në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT (Për procedurën nr. 1);
- Z. J.M , në cilësinë e përgj. sek. pranë DPZHMT (Për procedurat nr. 2, 3);
- Znj. J.B , në cilësinë e përgj. sek. pranë DPZHMT (Për procedurat nr. 2, 3);

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 32/5 prot.; datë 18.04.2024, është observuar nga funksionarët e DPZHMT, Bashkia Librazhd, z. K.B , në cilësinë e ish-drejtorit të DPZHMT, znj. A.H , në cilësinë e specialist-inxhinier projektsh pranë DPZHMT dhe z. E.GJ , në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT për periudhën nën auditim dhe aktualisht në cilësinë e drejtorit të DPZHMT, me anë të shkresës me nr. 145/1 prot; datë 12.04.2024, si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me të gjitha konstatimet e Grupit të Auditimit, mbi praktikën e miratimit të lejes së ndërtimit për ndërtimin e shkollës së mesme ‘Polis’ dhe ndërtim palestres, me adresë në fshatin Polis, me zhvillues Bashkia Librazhd, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, shprehen se: “Theksojmë se kjo leje është miratuar në kushte emergjence dhe nuk janë respektuar të gjitha fazat dhe etapat e nevojshme, po gjithësesi me kushtin që dokumentacioni i plotë për dosjen tejkniko-ligjore do të dorëzohet fizikisht në bashkinë Librazhd, për arsye se:

1. Në bazë të Akt Eksperizës së thelluar Nr. 977 Prot, datë 07.06.2023, të mbajtur nga Institututi i Ndërtimit struktura e objektit në gjendjen ekzistuese nuk i plotësonte kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për sigurinë e jetës së nxënësve dhe rekomandohej të merreshin masa urgjente për largimin e menjëhershëm të nxënësve dhe për ndërprerjen e çdo aktiviteti në ambiente të kësaj shkolle. Ndaj dhe bashkia mori masa për largimin e nxënësve dhe mbarëvajtjen e mësimave në ambiente të marra me qira, të cilat ishin jo fort të përshtatshme për zhvillimin e planit mësimor.

2. Për shkak se fondi për rindërtimin e kësaj shkolle do të lëvrohej nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhej që e gjithë procedura e prokurimit dhe alokimit të fondit të realizohej brenda muajit dhjetor, ndryshe ky fond do të digjej.

3. Bazuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimit të territorit”, Nenin 46, pika 3, ky objekt përjashtohet nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si pasojë nuk sjell dëm ekonomik.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehemi se, duke mirëkuptuar afatet kohore të cituara nga ju dhe duke i marrë ato si të mirëqena, qëndrimi i Grupit të Auditimit është si vijon: Marrë në konsideratë faktin se objekti i miratuar është një shkollë, e cila do jetë në shërbim të nxënësve dhe jo vetëm, nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (këtu e në vazhdim DPZHMT), Bashkia Librazhd do të duhej të ishin marrë masa për shqyrtimin e praktikës brenda afateve të kërkuara nga ju. Së pari, shqyrtimi i praktikës së lejes së zhvillimit është i ngjashëm

*me atë të lejes së ndërtimit dhe në vazhdimësi të njëra tjetrës, pra nuk do të sillte shtyrje të afateve. Hartimi i projekteve ndërtimore si studimi sizmik dhe gjeologjik, raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë dhe projekti i mbrojtjes nga zjarri janë projekte të cilat ndikojnë në cilësinë e jetesës në këto ambiente dhe sigurinë e saj, për këtë arsye nuk do të duhej të ishin neglizhuar. Gjithashtu, DPZHMT do të duhej të kishte kërkuar mendimin e të gjithë autoriteteve, duke qenë se aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 03.10.2023, ndërsa leja e ndërtimit është miratuar në datën 06.12.2023, si dhe duke marrë parasysh faktin që mendimi i autoriteteve maksimalisht merr dhjetë ditë pune. Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.***

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Librazhd dhe Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6, DPZHMT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

**1.** Leje ndërtimi për ndërtimin e shkollës së mesme ‘Polis’ dhe ndërtim palestere, me adresë në fshatin Polis, me zhvillues Bashkia Librazhd, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, me problematika si vijon: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me kërkesën dhe dhënien e mendimit nga autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, rezulton se nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

**2.** Leje ndërtimi për banesë individuale 1 kat + çati, me adresë në fshatin Mirakë, Bashkia Librazhd, me zhvillues z. F.RR , për të cilën është marrë Vendimi Nr. 665, datë 09.10.2023, me problematika si vijon: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me kërkesën dhe dhënien e mendimit nga autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, rezulton se nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Ujësjellës-Kanalizime (UK) dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 21, pika 6.

### **Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:**

- Z. M.D , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (Për procedurat nr. 1, 2);
- Znj. B.B , në cilësinë e ish-drejtorit të DPZHMT (Për procedurën nr. 2);
- Z. K.B , në cilësinë e ish-drejtorit të DPZHMT (Për procedurën nr. 1);
- Znj. A.H , në cilësinë e specialist - ing. projektsh pranë DPZHMT (Për procedurën nr. 1,);
- Z. E.GJ , në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT (Për procedurën nr. 1);
- Z. J.M , në cilësinë e përgjegjësit të sektorit pranë DPZHMT (Për procedurat nr. 2);
- Znj. J.B , në cilësinë e përgjegjëse sektori pranë DPZHMT (Për procedurat nr. 2);

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve (DPZHMT), Bashkia Librazhd ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të lejes së zhvillimit. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në:

**1.** Leje ndërtimi për ndërtimin e shkollës së mesme ‘Polis’ dhe ndërtim palestere, me adresë në fshatin Polis, me zhvillues Bashkia Librazhd, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, me problematika si vijon: Në zbatim të nenit 9 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja nga autoritetet vendore



dhe përmban nivel prone apo grup pronash. Gjithashtu, për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, nuk ka parashikim për hartimin e Planit të Detajuar Vendor.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.

### **Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:**

- Z. M.D , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (*Për procedurat nr. 1, 2*);
- Z. K.B , në cilësinë e ish-drejtorit të DPZHMT (*Për procedurën nr. 1*);
- Znj. A.H , në cilësinë e specialistes - ing. projektsh pranë DPZHMT(*Për procedurën nr. 1*);
- Z. E.GJ , në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT (*Për procedurën nr. 1*).

#### ***Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit:***

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në 3 (tre) raste, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në:

a. Lejen e ndërtimit për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, për të cilën: projekti arkitektonik nuk është i plotë; mungon planvendosja e miratuar; mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë; mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri; mungon studimi sizmik dhe gjeologjik; mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB; mungon relacioni teknik për projektin elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes; mungojnë licencat personale profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik, elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes.

b. Lejen e ndërtimit për të cilën është marrë Vendimi Nr. 665, datë 09.10.2023, për të cilën: mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB; projekti arkitektonik nuk është i plotë;

c. Çertifikatën e përdorimit, për të cilën është marrë Vendimi nr. 659, datë 31.08.2023, për të cilën: mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit; mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane; mungon projekti “A ”; mungojnë fotografitë të objektit në të katërta orientimet; mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit; mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 (dy) raste Bashkia Librazhd dhe DPZHMT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023: Nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

b. Leje ndërtimi, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 665, datë 09.10.2023: Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Ujësjellës-Kanalizime (UK) dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 1 (një) rast, Bashkia Librazhd ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të lejes së zhvillimit ose Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023.

## **2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor. (IMTV).**

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit, grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2023, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë, struktura e IMTV dhe formimi profesional i stafit të kësaj strukture, dosjet e procedurave të

mbajtura nga IMTV, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori.

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2023 -31.12.2023, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMTV), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

1.Në lidhje me plotësimin e kriterëve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve në nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” janë konstatuar:

Duke ju referuar përcaktimeve të nenin 11 të ligjit Nr. 183/2014 datë 24.12.2014, të arsimimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit përcaktohet se: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit”, 3 punonjësit nuk e plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë.

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Librazhd, të paraqitur në tabelën e mëposhtme, kryeinspektori nuk ka profilin e duhur arsimor për pozicionin e punës, 1 inspektor është më arsim të mesëm ndërsa 1 inspektor ka përfunduar arsimin e lartë por jo në profilin e duhur.

1.Z.SH.G , me pozicion kryeinspektor, ka përfunduar Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, me titull oficer ushtarak; 2.Z.L.T , me pozicion inspektor i cili është me arsim të mesëm; 3.Z. G.B , me pozicion inspektor ka përfunduar në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, me titull mësues për lëndët histori-gjeografi; të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Data e fillimit
1	SH.G	Kryeinspektor i IMTV-së	Akademia Ushtarake “Skënderbej”	08.09.2016 e në vazhdim
2	L.T	Inspektor	Shkolla e Mesme	08.02.2021 e në vazhdim
3	G.B	Inspektor	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, me titull mësues për lëndët histori-gjeografi	19.06.2023 e në vazhdim

*Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori I IMTV Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se nga IMTV, për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar programi vjetor i punës së inspektoratit, si dhe programet mujore të punës, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 në nenin 24 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” dhe pika 12 në nenin 48 të Rregullores së Bashkisë Librazhd, miratuar me vendimin nr. 20, datë 28.12.2020 të Titullarit.

-Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacione periodike 3/mujore për IKMT-në për problematikat dhe masat e marra ndaj subjekteve që rezultojnë në shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Në raport me vendimet e marra nga IMTV për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për

vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore Bashkia Librazhd, gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, ka marrë 5 vendime për “Dënim me gjobë”, të cilat nuk janë arkëtuar.

VITI 2023									
Nr.	Vendim i gjobës	Date e gjobës	Emër Mbiemër	Adresa	Gjobitur (leke)	Paguar	NR. Serial 00000	Gjendja e Gjobës	Nr. Vendimi Prishje
1	20	03.07.2023	A.T	Lagja Pylli i Bicit, Fshati Dragostinjë	500,000		20	Proces gjyqësor	-
2	21	03.08.2023	S.F	Nj. Adm Hotolisht, Bushtricë	500,000		21	Proces gjyqësor	Vendim nr.17 dt.03.08.2023
3	22	21.08.2023	L.P	Pallati i ri, ish Turizmi	50,000		22		-
4	23	10.10.2023	Q.Q	Nj. Adm. Lunik, fshati Zgosht	300,000		23		-
5	24	27.10.2023	B.K	Lagja Shesë, Librazhd	500,000		24		Vendim nr.18 dt.27.10.2023
					<b>1,850,000</b>				

*Burimi: Sektori i IMTV Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

3.Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023, janë mbajtur 7 procesverbale konstatimi, nga të cilat janë nxjerrë 5 vendime për gjoba, 1 vendim për pezullimin e punimeve dhe 2 vendime për prishjen e tyre.

Rezulton se nga 7 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, gërma b, ç dhe d të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe nenit 52 “Kundërvajtjet administrative” pika “e” në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba në 2 raste, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

-Nga auditimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se Kryeinspektori i IMTV në vijim të konstatimit të shkeljes, pasqyruar në procesverbalin nr. 38, datë 31.07.2023, ka nxjerrë vendimin nr.17, datë 03.08.2023 dhe procesverbalin nr. 42, datë 03.11.2023, ka nxjerrë vendimin nr.18, datë 27.10.2023 për prishjen e punimeve të ndërtuara pa leje nga subjekti “S.F” dhe “B.K”.

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme, konstatohet se nuk administrohet shkresa drejtuar policisë bashkiake për ekzekutimin e vendimit për prishjen e punimeve të kryera nga subjekti “S.F” dhe “B.K”, nuk administrohet procesverbali i dokumentimit të prishjes së punimeve të kundërligjshme, ç’ka nuk vërtetohet ekzekutimi i vendimit për prishjen e punimeve.

4.Lidhur me gjobat e vendosura, konstatohet sërish mangësi në veprimtarinë e IMTV, pasi masa e gjobës për 3 subjektet e gjobitura, është aplikuar gabim, pasi me ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

*e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me....*

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar 50,000/ 300,000/ 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përlllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pak se 35,000 lekë për metër katror.

-Lidhur me këto mangësi, audituesit kanë sqaruar, se do duhej që në stafin e IMTV-së të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më minimum gjobe në vlerë të përcaktuar, por kërkohet ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përlllogaritjet dhe nxjerr masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

5. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se Kryeinspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

6. Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, Kryeinspektori i IMT, nuk ka përcjellë Kallëzime Penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje nga organet përkatëse, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

7. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se Kryeinspektori ka nxjerrë 2 vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

8. Lidhur me konstatimet e mësipërme, në asnjë rast nuk disponohej një dosje e hapur për subjektin kundërvajtës, por procesverbalet e mbajtura dhe aktet që ka nxjerrë inspektorati, ishin vetëm nëpër blloqe, duke mos pasur një praktikë estetike të administrimit të dokumentacionit.

9. Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se procedurat nuk dispononin fotot e konstatimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se:

Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta

*a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.*

10. Për periudhën objekt auditimi, ndërmjet IMTV-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe e Zhvillimit të Territorit, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, çertifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Librazhd e, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, ku citohet: “Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar”.

11. Lidhur me gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2023, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar, për dy subjekte është bërë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv si dhe në asnjë rast nuk janë aplikuar kamat vonesat.

12. Në lidhje me gjobat e nxjerra përgjatë vitit 2020 – 2022, rezulton se janë në total 17 gjoba me vlerë 3,180,000 lekë, nga të cilat 8 i takojnë vitit 2020 me vlerë 730,000 lekë, 6 gjoba janë të vitit 2021 me vlerë 1,150,000 lekë dhe 3 gjoba janë të vitit 2022 me vlerë 1,300,000 lekë. Janë likuiduar 5 gjoba të vitit 2020 me vlerë 330,000 lekë, dhe janë debitor 3 gjoba në vlerë 400,000 lekë. Janë likuiduar 2 gjoba të vitit 2021 me vlerë 600,000 lekë dhe janë debitor 4 gjoba me vlerë 550,000 lekë. Janë likuiduar 3 gjoba të vitit 2022 me vlerë 850,000 lekë dhe janë debitor 3 gjoba me vlerë 850,000 lekë.

Lidhur me gjobat e pa likuiduara, rezulton se për asnjërën prej tyre, nuk janë bërë kërkesë padi drejtuar gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv. Kryeinspektori i IMTV, është mjaftuar vetëm me përcjelljen e tyre pranë Zyrës së Financës e cila ka bërë kontabilizimin e tyre, dhe

nuk ka asnjë procedurë tjetër të ndjekur nga punonjësit e Bashkisë Librazhd për ndjekjen e procedurave tjera ligjore për arkëtimin e këtyre gjobave. Për 3 gjobat e vitit 2020 dhe 4 gjobat e vitit 2021, është tejkualuar afati 2 vjeçar, duke bërë që këto gjoba të parashkruhen, veprime të cilat ndikojnë në të ardhurat e Bashkisë Librazhd.

#### **Konkluzion.**

Nga ana e IMTV-së nuk rezulton të jetë mbajtur asnjë relacion shpjegues apo informues drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe institucioneve bashkëvepruese si Drejtorisë Vendore, ASHK Elbasan dhe IKMT-së Drejtorisë Rajonale Elbasan, mbi vijueshmërinë e punës në zbatim të detyrave të lëna si dhe në lidhje me problematikat apo pengesat e hasura përgjatë punës me qëllim përmbushjen e përgjegjësi të parashikuara në ligj në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe të realizimit të misionit të saj, në garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, sipas kuadrit rregullator të fushës, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore në fushën përkatëse.

*Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mbajnë përgjegjësi z. SH.G me cilësinë Kryeinspektori IMTV-së, z. L.T me cilësinë inspektor i IMTV-së dhe z. G.B me cilësinë inspektor IMTV-së.*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërma janë në kundërshtim me Pika 1 në nenin 12 në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar: Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

#### **2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 316/10 prot., datë 01.09.2023, rezulton se:

Nga Bashkia Librazhd me shkresën nr. 6308 prot., datë 28.9.2023 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujorë, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekt, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a- Nga **22 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, 9 masa janë zbatuar pjesërisht dhe **10 masa nuk janë zbatuar.**

b- Nga 3 masa shpërbllim dëmi me vlerë 2,529 mijë lekë, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se 2 masa me vlerë 1,078 mijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe **1 masë me vlerë 127 mijë lekë nuk është zbatuar.**

c- Nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative me vlerë 100,783 mijë lekë, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se janë në proces zbatimi dhe pjesërisht zbatuar 2 masa me vlerë 97,799 mijë lekë dhe **2 masa me vlerë 2,983 mijë lekë e pazbatuar.**

d- Nga një masë administrative, pranuar 100% **por e pazbatuar.**

e- Nga 2 masa disiplinore, pranuar 100% nga subjekti dhe zbatuar.

**Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara, zbatuar pjesërisht/proces, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të rriskut të secilës strukturë dhe të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit, kodi etikës rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit.

Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.

*Deri më 31.10.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton i **pazbatuar**.

**2.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin me tre punonjës të Njësisë së Auditit të Brendshëm.

-Njësia e Auditit të Brendshëm të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë, si dhe të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave raportin vjetor të veprimtarisë audituese dhe planin strategjik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton i **pazbatuar**.

**4.1.Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Kryetari i Bashkisë Librazhd të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione”. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nëpërmjet dokumentacionit financiar të trashëguar, të nxjerrë të dhënat e nevojshme për aktivet e hyra e veprimet me to për llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerën e paraqitur në PF për këtë llogari.

*Brenda datës 31.12.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Për rekomandimin e mësipërm nuk mund të shprehemi, pasi Bashkia Librazhd është duke hartuar pasqyrat financiare me qëllim raportimin e tyre brenda afatit ligjor.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 rezulton **pazbatuar**.

**5.1.Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Librazhd pagesat e vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në përfundimin e investimit dhe, pas realizimit të punimeve ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-62 të raportit përfundimtar të auditimit).

*Brenda datës 31.12.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Për rekomandimin e mësipërm nuk mund të shprehemi, pasi Bashkia Librazhd është duke hartuar pasqyrat financiare me qëllim raportimin e tyre brenda afatit ligjor.

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 rezulton **pazbatuar**.

**6.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, kryesisht të disa prokurimeve të realizuara gjatë vitit 2023, rezulton se jo të gjitha kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë hartuar në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

**7.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve, edhe në rastet e ofertave me vlerën më të ulët.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, kryesisht të disa prokurimeve të realizuara gjatë vitit 2023, rezulton se jo në të gjitha prokurimet e zhvilluara OE është shpallur fitues në kushtet e plotësisimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

**8.1.Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të jap miratim vetëm për lejet e ndërtimit të cilat kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Gjithashtu të vlerësohet si dokumentacion i rëndësishëm edhe policat e sigurimit për projektuesit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, kryesisht të disa lejeve të ndërtimit të miratuara gjatë vitit 2023, rezulton se jo në të gjitha procedurat administrohet dokumentacioni i plotë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 8.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

**9.1.Rekomandim:** Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Librazhd, të marrë masa që për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkelje të saj, përveç nxjerrjes së vendimeve të gjobave, të vijohet me veprimet e mëtejshme për pezullimin e punimeve, vendimin për prishjen e tyre, deri në kallëzim penal, sipas përcaktimeve ligjore për secilin rast.

**9.2.Rekomandim:** IMT të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.

**9.3.Rekomandim:** IMT Bashkia Librazhd, të hapë dosje individuale për secilën procedurë, duke shmangur praktikën e mbajtjes së dokumenteve në blloqe, si dhe të dokumentojë në çdo rast praktikën e kontrollit apo kundërvajtjes me foto të situatës së konstatuar.

**9.4.Rekomandim:** Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për hartimin e kërkesave drejtuar Gjykatës për kthimin e gjitha gjobave në titull ekzekutiv, për të shmangur kalimin e afatit dhe parashkrimin e tyre.

**9.5.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa që struktura e IMT të përbëhet nga punonjës të cilët plotësojnë kriteret e formimit arsimor, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se për rekomandimet e mësipërme nuk është marrë asnjë masë, vazhdon të jetë e njëjta situatë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.1 rezulton i **pazbatuar**

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.2 rezulton i **pazbatuar**

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.3 rezulton i **pazbatuar**

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.4 rezulton i **pazbatuar**

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.5 rezulton i **pazbatuar**

**10.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve plotësimin e dosjes teknike për objektet në zbatim, hap pas hapi dhe konform kërkesave ligjore.

*Në vijimësi*

**10.2.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kërkojnë mbulimin e tubacionit tek mbikalimi i përroit, para përfundimit të periudhës së riparimit të defekteve.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se jo në të gjitha rastet janë plotësuar dosjet teknike nga mbikëqyrësit e

punimeve si dhe për sa i përket mbulimit të tubacionit tek mbikalimi i përroit nuk ka na është vënë dokumentacion në dispozicion.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.2 rezulton i **pazbatuar**.

**11.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë masat që me specialistë të fushës të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe për krijimin e regjistrit të aseteve.

*Deri më 30.11.2023*

**11.2.Rekomandim:** Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, të marrë masa dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin duhur për regjistrim në ASHK të aseteve. Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

*Deri më 30.11.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Financave janë marrë masa për planifikimin në buxhetin e vitit 2024, fonde për regjistrim të Aseteve në ASHK në vlerën 1,000,000 lekë sipas kërkesës së Sektorit të Aseteve.

**Zbatimi:** Rekomandimi 11.1 rezulton i **pazbatuar**.

**Zbatimi:** Rekomandimi 11.2 rezulton i **zbatuar**.

**12.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 112 pronave të rregjistruara në ASHK Librazhd pa vlerë, si dhe pas procesit të vlerësimit të bëjë paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiare të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Për rekomandimin e mësipërm nuk mund të shprehemi, pasi Bashkia Librazhd është duke hartuar pasqyrat financiare me qëllim raportimin e tyre brenda afatit ligjor.

**Zbatimi:** Rekomandimi 12.1 rezulton në **pazbatuar**.

**13.2.Rekomandim:** Bashkia Librazhd të marrë masa që në lidhjen e kontratave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor, së bashku me sipërfaqen e dhënë me qira, të tarifohet edhe servituti e kalimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Asetet e dhëna me qira, të jenë të pajisura me certifikatën e pronësisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Drejtoria e Menaxhimit dhe administrimit të Pyjeve dhe Kullotave kanë kryer disa Akt verifikime për matjen e rrugëve auto të sipërfaqeve të dhëna në përdorim.

**Zbatimi:** Rekomandimi 13.2 rezulton në **proces**.

## **B.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

(Në vijim janë 3 rekomandime të pa zbatuara nga Bashkia Librazhd, të cilat rikërkohen për zbatim)

### **A. Masa organizative**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në zbatim të procedurave për rekrutimin e punonjësve, të marrin masa për plotësimin me 3 punonjës të Njësisë së AB, siç është miratuar dhe në strukturën organizative të bashkisë.

*Në vijimësi*

**1.2.Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në



përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimet e mësipërme nuk janë zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton i **pazbatuar**.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.2 rezulton i **pazbatuar**.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim paisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Financave janë marrë masa për planifikimin në buxhetin e vitit 2024, fonde për rregjistrim të Aseteve në ASHK në vlerën 1,000,000 lekë sipas kërkesës së Sektorit të Aseteve.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

## **B. Masa për shpërbllim dëmi**

**(Në vijim janë 3 rekomandime, prej të cilave 2 të pa zbatuara dhe 1 i zbatuar pjesërisht nga Bashkia Librazhd, të cilët kërkohen për zbatim):**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, date 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21- 33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërbllimin e dëmit në vlerën **1,204,469 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **976,500 lekë pa TVSH** nga bashkimi i OE "K " SHPK & "L " & "K" shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 469 prot., date 20.10.2020, me objekt "Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz", Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur rezulton se nga ana e Bashkisë Librazhd janë bërë njoftimet për shlyerje detyrimi me shkresën nr. 5940/4, datë 15.09.2023 dhe rinjoftimi me shkresën nr.7362, datë 22.11.2023, detyrimi është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023 me urdhër të titullarit të institucionit nr. 318 datë 24/03/2023.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **126,560 lekë pa TVSH** nga BOE "M " SHPK & "SH " SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 prot datë 08.04.2021, me objekt "Ndërtim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin" (Faza II dhe faza III), Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësive vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nuk administrohet asnjë dokumentacion ku të pasqyrohen masat e marra nga Bashkia Librazhd për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton i **pazbatuar**.

**3.1 Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **101,409** lekë, si rezultat i keq llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Subjekti H. Z. është njoftuar me shkresën nr.3737 prot., datë 29.05.2023 dhe ka kryer pagesën më datë 09.06.2023 në vlerën 101,409 lekë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 rezulton i **zbatuar**.

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara.**

**(Në vijim është 1 rekomandim i pa zbatuar nga Bashkia Librazhd, i cili rikërkohet për zbatim):**

**1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **85,373,491** lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi **1** rezulton në **proces zbatimi**.

**C. Masa disiplinore**

**(Në vijim janë 2 masa disiplinore të pa zbatuara nga Bashkia Librazhd, të cilat rikërkohen për zbatim)**

**C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratë pune:**

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjës në lidhje me këto shkelje, **i rekomandohet Kryetarit të Bashkisë Librazhd** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**”, për:

1.S.A me detyrë Juriste në Sektorin e Prokurimeve,

2.J.B me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit,

**Për shkeljet e mëposhtme:**

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullari i AK për zhvillimin e një procedure tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeje*”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “*Autoriteti ose enti kontraktor*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i 157 ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*”.

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se janë vendosur 8 masa disiplinore “**Vërejtje**”, ndaj 2 punonjësve si më poshtë:

-Znj. J.B , Përgjegjës i Sektorit të Projektive dhe Zbatimit të Kontratave, vendosur masë disiplinore me Urdhrin nr.955, datë 16.10.2023.

-Znj. S.A, Specialist Jurist në Sektorin Juridik, vendosur masë disiplinore me Urdhrin nr.976, datë 20.10.2023.

## **B. Masa për shpërblim dëmi.**

**1.1.Rekomandim:** Bashkia Librazhd të marrë masat për zbritjen e vlerës **1,032,834 lekë**, nga garancia e punimeve kontraktorit, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike, si dhe referencë e gabuar e çmimit për një zë punimi.

*Brenda periudhës së garancisë së punimeve*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga ana e Bashkisë Librazhd janë bërë njoftimet për shlyerje detyrimi me shkresen nr.5940, datë 15.09.2023 dhe rinjoftimi me shkresen nr.7362, datë 22.11.2023, detyrimi është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023 me urdhër të titullarit të institucionit nr.70, datë 18.01.2024.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton në **process zbatimi.**

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës **1,079,976 lekë**, nga vlera e sigurimit të kontratës, kontraktorit BOE “E SHPK dhe L SHPK”, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.

*Brenda periudhës së garancisë së punimeve*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga ana e Bashkisë Librazhd janë bërë njoftimet për shlyerje detyrimi me shkresen nr.7362/3, datë 15.09.2023 dhe rinjoftimi me shkresen nr.5940/4, datë 22.11.2023, detyrimi është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023 me urdhër të titullarit të institucionit nr.70, datë 18.01.2024.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton në **process zbatimi.**

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës **416,245 lekë**, nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit “A ” SHPK, për punime të certifikuar, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.

*Brenda periudhës së garancisë së punimeve*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga ana e Bashkisë Librazhd janë bërë njoftimet për shlyerje detyrimi me shkresen nr.5940/2, datë 15.09.2023 dhe rinjoftimi me shkresen nr.7362/2, datë 22.11.2023, detyrimi është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023 me urdhër të titullarit të institucionit nr.70, datë 18.01.2024.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton në **process zbatimi.**

## **C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjek të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 96,164,783 lekë, nga debitorët privat dhe familjar.

*Deri më 31.12.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se masat për arkëtimin e vlerës debitorë, nuk janë marrë në rend shterues.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrin masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 13 subjektet

debitor, sipas të dhënave në aneksin nr. 2, bashkëlidhur raportit të auditimit, të vlerës së qirasë prej 2,983,140 lekë, si rezultat i mos pagesave të plota të detyrimeve kontraktuale në kontratat për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjor.

*Deri më 31.10.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nuk administrohet asnjë masë e marrë nga Bashkia Librazhd, për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton i pazbatuar.

**3.2. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej **1,635,518 lekë** ndaj subjektit Lulzim Hasballa, për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

*Deri më 31.10.2023*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Bashkia Librazhd i është drejtuar me shkresat nr.4549 prot., datë 03.07.2023; nr.6470 prot., datë 05.10.2023 dhe nr.6467 prot., datë 05.10.2023, por jo të ketë vazhduar me masa të tjera, me qëllim arkëtimin e detyrimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.2 rezulton i zbatuar pjesërisht.

#### **D. Masa administrative**

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Librazhd, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga:**

- **Shoqëria “N ”** me përfaqësues ligjor z. E.N , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd, faza e parë” dhe “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten si më poshtë:

- Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, u konstatua se për një zë të ri punimi është bërë referencë e gabuar e çmimit, veprim nga i cili, nga ana e kontraktorit është përfituar më tepër vlera 572,676 lekë. Nga verifikimi sipas zërave III.3.5, V.2.5 dhe VI.3.5 “Rrethim me zgarë metalike të galvanizuar...”, u konstatua se materiali i përdorur nuk është zgarë metalike e galvanizuar, pro rrjetë teli dhe rrjetë gabion. Nga llogaritjet rezulton përfitim i padrejtë nga ana e kontraktorit me vlerë 460,158 lekë.

- Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, janë konstatuar mangësi në lidhje me zërin “F.V puseta plastike 40 x 40 x 40 cm, kapak të fortë RC 1084+1086”, të cilat nuk janë vendosur me dimensionet e parashikuara.

Pemët e mbjella nuk kanë diametrin e parashikuar, diferenca e çmimit të pemëve të vendosura me ato të përcaktuara në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit me vlerë 98,616 lekë është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori. Nuk janë vendosur 6 stola me vlerën 144,000 lekë, si dhe zërat 4.b.5, 6.b.5, 7.d.6 dhe 8.b.5 “Rrafshim betoni me kuarc me ngjyrë”, sasia 1163 m<sup>2</sup> nuk është realizuar sipas specifikimeve, me pasojë përfitim të padrejtë të kontraktorit me vlera 837,360 lekë.

- Sipas kontratës “Rikonstrukcion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”, kanali nuk është ndërtuar sipas dimensioneve të paraqitura në librezë masash dhe situacion përfundimtar, për zërat “Struktura monolite betoni C 16/20 për kanale”, “Shtresë zhavorr lumi t=10 cm” dhe “Gërmim dheu”, duke shkaktuar përfitim të padrejtë nga ana e kontraktorit me vlerë 416,245 lekë.

Veprime në kundërshtim me:

-Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.

VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4.

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga IVMT nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e masës administrative ndaj subjektit të mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi i mësipërm rezulton i **pazbatuar**.

### **E. Masa disiplinore.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; nenin 64 shkronjën g të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 11, kreun IV dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Librazhd, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore (**në proporcion me shkeljen e kryer**), për punonjësit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në raportin përfundimtar të auditimit.

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se janë vendosur 8 masa disiplinore “Vërejtje”, ndaj 8 punonjësve si më poshtë:

Znj. B.B , Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;

Znj. E.P , Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës;

Znj. S.K , Përgjegjës i Sektorit Juridik;

Z. M.G , Përgjegjës i Sektorit të Transportit, Tregut dhe Parkimit;

Znj. S.O , Përgjegjës i Sektorit të Financës;

Z. D.T , Përgjegjës i Sektorit të IT;

Znj. J.B , Përgjegjës i Sektorit të Projektive dhe Zbatimit të Kontratave;

Znj. S.A, Specialist Jurist në Sektorin Juridik.

Për masat disiplinore, nuk administrohet dokumentacion i cili të vërtetojë regjistrimin e tyre në regjistrin qendror të personelit.

**Zbatimi:** Rekomandimi rezulton i **zbatuar pjesërisht**.

*Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi z. M.D , Kryetar i Bashkisë Librazhd, z. B.P , Sekretar i Përgjithshëm, z. R.M , Përgjegjës i Auditit të Brendshëm.*

**Kriteri:** Ligji nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronja “j”. Shkresa nr.683/26 prot, datë 23.05.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

**Shkaku:** Mosmarrje e masave për vënien në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

**Ndikimi/Efekt:** Risk i shtuar në aktivitetin e Bashkisë Librazhd, ku mangësi të konstatuara në auditimin e mëparshëm vazhdojnë të përsëriten.

**Rëndësia:** I Lartë.

## **2.8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Konstatohet se përbërja e GMS nuk është në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, pasi nuk janë miratuar si anëtar të GMS të gjithë menaxherët e nivelit të lartë.

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

- Për vitin 2023 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.

- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

- Në Bashkinë Librazhd nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Librazhd.

- Në Bashkinë Librazhd, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/1, faqe 12-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm në planet vjetore të auditimit nuk ka programuar auditimin e fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë duke mos dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

- Në disa dosje auditimi nuk dokumentohet dhe nuk administrohet shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar.

- Konstatohet se punonjësit pjesë e NJA nuk janë të certifikuar, sipas kërkesave të neni 11, pika 2, shkronja “c” të Ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/1.1, faqe 15-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**2.1.Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd, të marrë masa:

- Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.
- Pajisen me certifikatë të auditit të brendshëm të gjithë punonjësve të kësaj njësie me qëllimin rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

### Në vijimësi

**3.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekti auditimi, nga data 01.05.2023 deri në 31.12.2023, nga Bashkia Librazhd janë realizuar procedura me vlerë të vogël **24** procedura me vlerë fondi limit prej 12,896,183 lekë dhe vlerë kontrate 11,875,124 lekë, me një diferencë nga fondi prej 1,021,059 lekë. Nga grupi i KLSH mbi bazën e materilitet janë vlerësuar për auditim **4** procedura me fond limit 3,125,042 lekë, nga ku është konstatuar se:

- **Në 4 raste** urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas përcaktimit ligjor.
- **Në 2 raste** komisioni i blerjeve të vogla nuk ka argumentuar teknikisht kriteret që ka kërkuar në ftesën për ofertë.
- **Në 4 raste** dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- **Në 1 rast** nuk administrohet deklaratë garancie për mallin e prokuruar, për ti dhënë garanci autoritetit kontraktor për mallin e prokuruar;
- **Në 3 raste** afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla si dhe nuk janë përlllogaritur penalitetet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 4 në nenin 75, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 2 në nenin 80 në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pika 8 dhe pika 17 në Udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Pika 5 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e panit të zbatimit të kontratës”. Neni 32 në ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4, faqe 36-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël të marrë masa që:

- Në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.
- Në çdo rast të mos respektimit të kushteve të kontratës (afateve), të llogariten penalitetet.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**4.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekti auditimi nga Bashkia Librazhd janë realizuar gjithsej **31** procedura me vlerë të lartë me fond limit 224,289 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 191,648 mijë lekë, më një diferencë nga fondi limit për vlerën 32,641 mijë lekë ose 14.5 % e fondit të prokuruar.

Grupi i auditimit mbi bazën e materialitetit nga **31** procedura ka vlerësuar për auditim **5** procedura prokurimit me fond limit 208,165,932 lekë pa TVSh.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në **5** procedura, konkretisht: “Blerje fouristrade SUV për administratën e Bashkisë”, “Blerje materiale për lyerje dhe shërbime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësitë Administrative”, “Ndërtim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj. Adm. Polis Bashkia Librazhd”, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara” dhe tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, rezulton se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe se këto kriterë nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën

e kontratës. Mungon argumentimi apo përlllogaritja për nevojën e fuqisë punëtore apo makinerive sipas zërave e volumeve të punimeve.

- Në 4 procedura me fond limit 205,249 mijë lekë pa TVSh, konkretisht: “Blerje materiale për lyerje dhe shërbetime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësitë Administrative”, “Ndërtim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj.Adm. Polis Bashkia Librazhd”, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara” dhe tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e DST të miratuara nga AK Bashkia Librazhd. KVO në vlerësimin e ofertuesve është mjaftuar vetëm me vetëdeklaratën e operatorëve mbi përmbushjen e kriterëve e cila ngarkohet në sistem dhe nuk janë marrë me verifikimin e dokumentacionit fizik nëse përputhet me formularin e vetëdeklarimit ose jo.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4 në faqet 36-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë të gjithë masat që në dokumentet standarde të tenderit të argumentohet vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe se këto kriterë të jenë në përputhje dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i vlerës progresive të detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE, në Bashkinë Librazhd deri në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 2,035,749 lekë, vlerë e cila i përket vetëm detyrimit të krijuar gjatë vitit 2023. Prej këtyre detyrimeve, vlera 698,449 lekë ka si burim financimi buxhetin e shtetit, ndërsa vlera 1,337,300 lekë, ka si burim financimi të ardhurat e veta. Detyrimi prej 1,337,300 lekë ka si arsye mungesën e fondeve buxhetore nga të ardhurat e veta të Bashkisë Librazhd dhe përbëhet tre fatura tatimore të pa likuiduara. Pra, Bashkia Librazhd gjatë vitit 2023 ka marrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion për vlerën 1,337,300 lekë. Krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura gjatë një viti buxhetor sjell mos respektim të detyrimeve kontraktuale midis Bashkisë Librazhd dhe kontraktorve, me pasojë mundësinë e lindjes së detyrimeve financiare shtesë si penalitet për njësinë vendore, si dhe mbart detyrimin për vitin pas ardhës, duke rënduar buxhetin e këtij viti.

Veprimet e mësipërme janë kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masa për eliminimin e praktikave të marrjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, me qëllim uljen e riskut për lindjen e detyrimeve shtesë financiare, si rezultat i mos respektimit të detyrimeve kontraktuale me kontraktorët.

#### Në vijimësi

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi menaxhimin e aseteve (pronave), të kaluar me VKM në përdorim dhe pronësi ndaje Bashkisë Linazhd dhe Njësi administrative (ish- Komunave Orenjë, Polis, Qendër, Stebleve, Hotolisht, Lunik), rezulton se:

Sipas VKM-ve kësaj njësie vendore i janë transferuar gjithsej 4484 pasuri, si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **1446 pasuri në pronësi** dhe **2941 pasuri në përdorim**.



**Nga Bashkia Librazhd** nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Gjithashtu u konstatua se, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Nga 1446 prona në pronësi janë certifikuar deri më 31.12.2023 gjithsej 228 pasuri dhe 1011 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie. Ndërsa në lidhje me pronat në përdorim nuk është ndërmarrë asnjë veprim për verifikimin dhe zbatimin e procedurave për kalimin në pronësi me VKM.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3/4, faqe 33-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrrejë një grup pune me specialist të fushës për verifikimin e të gjithë pronave të kaluar në pronësi dhe përdorim Bashkisë Librazhd, si dhe hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në teren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

**6.2.Rekomandimi:** Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, për pasurit e pa regjistruara, të marrin masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Librazhd.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, pasi ka mangësi në dokumentacionin shoqëruës dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, konkretisht për:

**a. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 688, datë 06.12.2023, me zhvillues Bashkia Librazhd,** me problematika si vijon: Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon një prerje teknike dhe dy fasada teknike; Mungon planvendosja e miratuar dhe pozicionimi mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese; Mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me dokumentacionin shoqëruës; Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri, së bashku me dokumentacionin shoqëruës; Mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqëruës; Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve

dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore; Mungon relacioni teknik për projektin elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes; Mungojnë licencat personale profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik, elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes.

**b. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 665, datë 09.10.2023, me zhvillues z. F.RR , me problematika si vijon:** Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB; Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje teknike. Fasadat teknike nuk janë të sakta, pasi janë pamje tre-dimensionale;

**c. Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. 659, datë 31.08.2023, me zhvillues z. B.A , me problematika si vijon:** Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar; Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane; Mungon projekti “A ”; Mungojnë fotografitë të objektit në të katërta orientimet; Mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit; Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika c), ç), e), ë), g); pika 1/1, nënpika iv); neni 27/1, pika 1; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), gj), i), j); Ligjin Nr. 124/2015, “Për efincencën e energjisë”, i ndryshuar, neni 16; Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, shtojca 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/5, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd, të marrë masa:

- Për çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të kërkojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.

- Përpara miratimit lejeve të sigurohet mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve si: *plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efincencës së energjisë*, etj.

- Të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Librazhd dhe Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6, konkretisht për:

**a.** Për lejen e ndërtimit, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, u konstatua se nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

**b.** Për lejen e ndërtimit, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 665, datë 09.10.2023, u konstatua se nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Ujësjetës-Kanalizime (UK) dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/5, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd para miratimit të lejeve të ndërtimit të kërkojë mendimin e autoriteteve përkatëse mbi konformitetin e objektit në zhvillim në raport me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve. Gjithashtu të kërkojë dhe marrë mendim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), mbi statusin juridik të pronave në zhvillim.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të lejes së zhvillimit. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për ndërtimin e shkollës së mesme ‘Polis’ dhe ndërtim palestere, me adresë në fshatin Polis, me zhvillues Bashkia Librazhd, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, me problematika si vijon: Në zbatim të nenit 9 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja nga autoritetet vendore dhe përmban nivel prone apo grup pronash. Gjithashtu, për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, nuk ka parashikim për hartimin e Planit të Detajuar Vendor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/5, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd të miratojë lejet e ndërtimit shoqëruar me lejet e zhvillimit ose Planet e Detajuara Vendore për njësitë strukturore ku ndodhet parcela në zhvillim.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), u konstatua se:

- Struktura ka funksionuar me punonjës të cilët nuk plotësojnë kriteret lidhur me formimin arsimor.

- Janë mbajtur 7 procesverbale konstatimi nga të cilat janë nxjerrë 5 vendime për gjoba, 1 vendim për pezullimin e punimeve dhe 2 vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

- Nuk disponohet asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi dhe mungon korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Kryeinspektori nuk ka miratuar plane mujore dhe vjetore të punës, nuk administrohen dosje për praktikat e ndjekura nga IMTV, si dhe nuk dokumentohen me foto praktikat e mbajtura.

- Lidhur me gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2023, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar si dhe në 2 raste është bërë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv. Në lidhje me gjobat e vendosura për vitin 2022 janë debitorë në vlerën 850,000 lekë dhe për vitin 2023 janë debitorë në vlerën 1,850,000 lekë. Lidhur me gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2023, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar, për dy subjekte është bërë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv si dhe në asnjë rast nuk janë aplikuar kamat vonesat. Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, ç, d, f), neni 11; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; pika 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Librazhd, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/6, faqe 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

**10.2.Rekomandimi:** Nga ana e sektorit të IMTV-së të merren masa për hartimin dhe zbatimin rigoroz të programit vjetor/mujor të inspektimit, si dhe të raportojë periodikisht sipas detyrimit ligjor pranë IKMT-së.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**10.3.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe IMTV Bashkia Librazhd të marrin masa për:

- Të ndjekur procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve dhe që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjambat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 2,700,000 lekë, nga të cilat 850,000 janë për vitin 2022 dhe 1,850,000 lekë për vitin 2023.

- Të ndjekë të gjitha rastet që nuk kanë paguar gjambat brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesat përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

**Brenda datës 30.6.2024**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 316/10 prot., datë 01.09.2023, rezulton se:

Nga Bashkia Librazhd me shkresën nr. 6308 prot., datë 28.9.2023 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujorë, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekt, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a- Nga **22 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, **5 masa janë zbatuar pjesërisht**, 4 masa janë në proces zbatimi dhe **10 masa nuk janë zbatuar**.

b- Nga **3 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,529,055 lekë**, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat **nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 2,529,055 lekë**.

c- Nga **4 masa** për eliminimin e efekteve negative me vlerë 100,783,441 lekë, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se 1 masë është në proces zbatimi me vlerë 96,164,783 lekë, 1 masë është zbatuar, **1 masë është zbatuar pjesërisht** me vlerë 1,635,518 lekë dhe **1 masë me vlerë 2,983,140 lekë është e pazbatuar**.

d- Nga një masë administrative, pranuar 100% **por e pazbatuar**.

e- Nga 2 masa disiplinore, pranuar 100% nga subjekti dhe **e zbatuar**.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/7, faqe 77-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

### **A. Masa organizative të lëna në auditimet e mëparshëm:**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të riskut të secilës strukturë dhe të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit, kodi etikës rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit.

*Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.*

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin me tre punonjës të Njësisë së Auditit të Brendshëm.

*-Njësia e Auditit të Brendshëm të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë, si dhe të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave raportin vjetor të veprimtarisë audituese dhe planin strategjik.*

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të

kualifikimit të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve, edhe në rastet e ofertave me vlerën më të ulët.

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të jap miratim vetëm për lejet e ndërtimit të cilat kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Gjithashtu të vlerësohet si dokumentacion i rëndësishëm edhe policat e sigurimit për projektuesit.

**9.1.Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Librazhd, të marrë masa që për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkelje të saj, përveç nxjerrjes së vendimeve të gjobave, të vijohet me veprimet e mëtejshme për pezullimin e punimeve, vendimin për prishjen e tyre, deri në kallëzim penal, sipas përcaktimeve ligjore për secilin rast.

**9.2.Rekomandimi:** IMT të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.

**9.3.Rekomandimi:** IMT Bashkia Librazhd, të hapë dosje individuale për secilën procedurë, duke shmangur praktikën e mbajtjes së dokumenteve në blloqe, si dhe të dokumentojë në çdo rast praktikën e kontrollit apo kundërvajtjes me foto të situatës së konstatuar.

**9.4.Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për hartimin e kërkesave drejtuar Gjykatës për kthimin e gjitha gjobave në titull ekzekutiv, për të shmangur kalimin e afatit dhe parashkrimin e tyre.

**9.5.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa që struktura e IMT të përbëhet nga punonjës të cilët plotësojnë kriteret e formimit arsimor, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

**10.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve plotësimin e dosjes teknike për objektet në zbatim, hap pas hapi dhe konform kërkesave ligjore.

**10.2.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kërkojnë mbulimin e tubacionit tek mbikalimi i përroit, para përfundimit të periudhës së riparimit të defekteve.

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masat që me specialistë të fushës të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe për krijimin e regjistrit të asetëve.

**11.2.Rekomandimi:** Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, të marrë masa dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin duhur për regjistrim në ASHK të asetëve. Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 4193 Prot, datë 10.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

**14.1/1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në zbatim të procedurave për rekrutimin e punonjësve, të marrin masa për plotësimin me 3 punonjës të Njesisë së AB, siç është miratuar dhe në strukturën organizative të bashkisë.

**14.1/1.2. Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

**14.1/2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**14.1/1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 976,500 lekë pa TVSH nga bashkimi i OE “K ” SHPK & “L ” & “K 2007” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.469 prot datë 20.10.2020, me objekt “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njesisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**14.1/2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 126,560 lekë pa TVSH nga BOE “M” SHPK & “SH ” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 prot datë 08.04.2021, me objekt “Ndërtim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin” (Faza II dhe faza III), Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson

dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisve vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**14.1/1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **85,373,491 lekë**.

#### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masat për zbritjen e vlerës 1,032,834 lekë, nga garancia e punimeve kontraktorit, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike, si dhe referencë e gabuar e çmimit për një zë punimi.

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 1,079,976 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës, kontraktorit BOE “E SHPK dhe L SHPK”, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 416,245 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit “A ” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.

#### **C. MASA PËR ELIMINIM E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:**

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrin masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 13 subjektet debitor, sipas të dhënave në aneksin nr. 2, bashkëlidhur raportit të auditimit, të vlerës së qirasë prej **2,983,140 lekë**, si rezultat i mos pagesave të plota të detyrimeve kontraktuale në kontratat për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjor.

**3.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 1,635,518 lekë ndaj subjektit L. H., për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE**

-Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Librazhd, të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga:

- **Shoqëria “N ”** me përfaqësues ligjor z. E.N , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd, faza e parë” dhe “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.

**Menjëherë**

#### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd në vlerën **362,915 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, me vlerë të kontratës (me TVSh) 21,296,088 lekë, realizuar nga OE “B ” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 224,115 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1424 prot., datë 16.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe OE “B ” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4, faqe 36-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **224,115 lekë pa TVSh** nga OE “B ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1424 prot datë 16.03.2023, me objekt “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, me vlerë të kontratës (me TVSh) 46,800,089.4 lekë, realizuar nga BOE “A ” ShPK & “Z ” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 138,800 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1967 prot datë 11.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe BOE “A ” ShPK & “Z ” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4, faqe 36-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **138,800 lekë pa TVSh** nga BOE “A ” ShPK & “Z ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1967 prot datë 11.04.2023, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2024**

### **C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi masat e marra nga DTTV Bashkia Librazhd për arkëtimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë nga objektet informale për familjet dhe bizneset, rezulton se deri në datën 31.12.2023, nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, **213** persona me vlerë **9,049 mijë lekë**, nga e cila: detyrimi prej 6,373 mijë lekë nga debitorët familjare dhe detyrimi prej 2,675 mijë lekë nga debitorët me destinacion biznesi. Për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve pasi janë nxjerrë vetëm njoftim vlerësimet për detyrimin dhe nuk është vijuar masa të tjera shtrënguese, veprime në kundërshtim me kreun 11 të Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar të Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008, Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerë **9,049 mijë lekë**, sipas listës paraqitur në aneksin nr.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se deri në datën 31.12.2023 janë debitorë për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 83,713,560 lekë, e cila përbëhet:

- vlera prej 23,731,228 lekë nga 91 subjekte debitor të biznesit të madh.
- vlera prej 14,606,819 lekë nga 283 subjekte debitor të biznesit të vogël.
- vlera prej 3,029,351 lekë nga 66 ndërtesa social ekonomike.

- vlera prej 42,346,162 lekë nga taksapaguesit familjare qytet dhe ne njësite administrative. Vetëm për vitin 2023, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifatat vendore është 19,894,582 lekë, ose 21.44% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 7,256,268 lekë nga 58 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 2,441,949 lekë, nga 132 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 745,539 lekë nga 62 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 1,445,103 lekë nga 18 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 1,409,973 lekë nga 202 familjarët në qytet taksapaguesit familjar, detyrimi prej 6,595,750 lekë nga 4473 familjarët në gjashtë njësite administrative taksapaguesit familjar.

Nga auditimi u konstatua se për debitorët nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, por janë mjaftuar vetëm me njoftim vlerësimet për detyrimin dhe asnjë masë tjetër, veprime të cilat bien në kundërshtim me kreun 11 të Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar të Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008, Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Librazhd të angazhohet gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit për eliminimin e vlerës së detyrimeve prej 83,713,560 lekë.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Librazhd rezulton se, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime ShA nuk ka mbledhur për llogari të Bashkisë Librazhd 2,819,814 lekë, ndërsa për vlerën 5,114,663 lekë është shuma e mbledhur dhe pa xhiruar për llogari të bashkisë. Vlera e arkëtuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime ShA gjatë vitit 2023 është 2,933,953 lekë, (xhirimet e bëra). Bashkia Librazhd gjatë vitit 2023 ka bërë sistemime për taksapagues të kategorisë të cilët përjashtohen nga taksa e ndërtesës dhe kanë lehtësira në tarifatat vendore (invalid etj.), komisione për pagesën e agentit tatimor.

Për sa më sipër, debitorë familjare për taksa e tarifa vendore që mbeten deri 31.12.2023 nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime janë në vlerën 7,934,477 lekë (nga këto 5,114,663 lekë janë të arkëtuara dhe të pa xhiruara ndaj bashkisë dhe 2,819,814 lekë të pa arkëtuara e xhiruara nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime ShA, detyrime të prapambetura nga viti 2011-2023, (sipas akt- rakordimit të datës 17.01.2023 për gjendjen 31.12.2023).

Bashkia Librazhd sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2023. Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurave për taksat dhe tarifatat vendore pasqyrohen në kapitullin Anekse – **Aneksi nr.3**, tabela nr.2, bashkëlidhur raportit të auditimit. Për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 169,761,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 151,241,560 lekë ose 89.09 %, me një mosrealizim në vlerën 18,519 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Librazhd në lidhje me kontratat e qirave, rezultojë se:



Nga Bashkia Librazhd (Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave), janë lidhur gjithsej 73 kontrata me vlerë 15,565,631 lekë për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullosor.

Nga të dhënat e kësaj drejtorie konstatohet se deri në fund të vitit 2023, detyrimi i pa paguar për këto kontrata është në vlerën **2,206,200 lekë kjo për 10 kontrata**.

Nga bashkia (strukturat përgjegjëse), nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjorë për arkëtimin e vlerë së kontratave të palikujduar, veprime të cilat kanë çuar në rritjen e nivelit të debitorëve në këtë bashki. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.7850, datë 29.07.1994 “Për K.C.R.SH-në” neni 826 i tij; të VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”; Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet”; Ligjin Nr.9693/2007“Për fondin kullosor” si dhe Udhëzim Nr.1/2016 “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës dhe detyrimeve për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullosor në vlerë **2,206,200 lekë**, sipas listës paraqitur në aneksin nr.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil/ Largim nga puna”, për 4 (katër) punonjës, si më poshtë.

1. **Z. J.M**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit pranë DPZHMT,

2. **Znj. J.B**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit pranë DPZHMT.

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Për shkeljet e konstatuara, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara për 2 (dy) raste. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me:

- Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi, siç janë mangësi në plotësinë e projektit ndërtimor dhe projekteve përbërëse të tij, mangësi në dokumentacionin që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB, mangësi në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi.

- Mos-kërkimin e mendimit të autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

3. **Znj. A.H**, në cilësinë e spec.-Ing. Proj. pranë DPZHMT

4. **Z. E.GJ**, në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara për **1 (një)** rast. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me:

- Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi, siç janë mangësi në plotësinë e projektit ndërtimor dhe projekteve përbërëse të tij, mangësi në dokumentacionin që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB, mangësi në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi, në një rast mungon planvendosja e miratuar, mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë, projekti i mbrojtjes nga zjarri, studimi sizmik dhe gjeologjik, relacioni teknik për projektin elektrik, licencat personale profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik, elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes;
- Mos-kërkimin e mendimit të autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit;
- Për miratimin e lejes së ndërtimit, në kushtet kur zhvilluesi nuk është pajisur më parë me leje zhvillimi, dhe kur për parcelën në të cilën zhvillohet objekti, nuk është parashikuar hartimi i një Plani të Detajuar Vendor.

#### **F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

## V.ANEKSE

### Aneksi nr.2 – Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm trajtuar nga faqja nr.77 deri në faqen nr.85 të Raportit të Auditimit.

#### Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rek. gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(Në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Procesz batimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1	Masa organizative	22	3	5	4	10								
2	Shpërblim demi	3				3	3	2,529					3	2,529
3	Masa efekt adm. e fondeve publike	4	1	1	1	1								
4	Masa administrative	1				1								
4	Masa disiplinore	1				1								
	<b>Totali</b>	<b>31</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>5</b>	<b>16</b>	<b>3</b>	<b>2,529</b>					<b>3</b>	<b>2,529</b>

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për eliminimin e efekteve negative				
Rek. Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pjesërisht	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
100,783		96,164	1,635	2,983

### Aneksi nr.3 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.17 deri në faqen nr.32 të Raportit të Auditimit.

Tabela nr.1, Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti i kontratës	Fond Planifikim	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Pagar Viti 2023	Mbetja 31.12.2023	Komente
			Datë lidhjes se kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH				
1	Rehabilitim I Shesheve midis pallateve Lagjia Sheja	7,035,293	09.02.2023	30 dite	7,035,293	M Shpk	6,683,528	351,765	5% garanci
2	Blerje dhe instalim kaldaje per shkollen 9-vjecare Mirake Plane	1,186,512	14.02.2023	5 dite	1,162,512	G	1,162,512		Likujduar
3	Rikonstruksion I rrugeve rurale dhe veprave te artit te bashkise Librazhd	9,935,916	14.02.2023	30 dite	9,935,916	G	9,439,120	496,796	5% garanci
4	Zgjerim I trotuarit ne rrugen Arberia Librazhd	6,090,855	16.02.2023	15 dite	6,090,855	Z	5,785,933	304,522	5% garanci
5	Rehabilitim I shesheve dhe rrugeve lagjia Mirake Plane Nj.Adm.Polis	21,296,089	16.03.2023	1 muaj	21,296,088	B shpk	20,230,813	1,064,780	5% garanci
6	Ndertim I kendit sportiv ne shkollen e mesme te bashkuar Orenje	4,768,558	23.03.2023	19 dite	4,768,558	A	4,526,977	238,262	5% garanci
7	Riparime te pjesshme ne kanalet vaditese ne B.Librazhd	4,200,000	28.03.2023	30 dite	4,158,427	A	3,950,505	207,922	5% garanci
8	Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Cercan (me dy faza financimi)	36,261,733	28.03.2023	4 muaj	36,261,733	KMK	28,564,802	2,503,411	1,503,411 5% dif. 1,000,000 detyrim
9	Rikonstruksion I rrugeve rurale dhe veprave te artit te bashkise Librazhd	5,000,000	30.03.2023	28 dite	4,925,832	G	4,678,518	246,238	5% garanci
10	Rikonstruksion I rruges Mirake-Gjovac,Nj.Adm.Polis(me tre faza fin)	63,278,532	11.04.2023	61 dite	46,800,089	A Shpk Z Shpk	20,983,249	1,104,383	5% garanci
11	Blerje tuba per kanalet vaditese 2023	2,100,000	14.04.2023	30 Dite	1,908,792	A Shpk	1,908,792		Likujduar
12	Ndërtim Central Park (Parku Qendror)Faza II	40,611,147	14.04.2023	4 muaj	32,445,135	L	13,269,563	7,341,584	Në proces likuidimi
13	Rikonstruksion ne tregun e qytetit	3,132,000	03.05.2023	14 dite	3,054,125	Z Shpk	2,897,994	152,526	5% garanci
14	Sistemim asfaltim I rrugës Spathar(Loti I) B.Librazhd(tre faza fin)	99,988,926	11.05.2023	4 muaj	66,858,494	B	35,390,694	4,703,930	Në proces likuidimi
15	Blerje paisje elektronike	500,000	12.05.2023	7 Dite	384,800	A.H	384,800		Likujduar
16	Zgjerim miniparku I qershive +ndertim vendtakimi per automjetet	7,247,989	23.05.2023	24 dite	7,200,921	G			Pa likujduar
17	Hidroizolimi I shkollave dhe institucioneve Bashkia Librazhd	5,000,000	30.05.2023	30 dite	3,900,108	A SHPK	3,705,103	195,005	5% garanci
18	Rikonstruksion kanali Rocit ,Nj.Hotolisht ,kanali Orenje Floq Kanali Letem (Geshtenje ne vazhdim) kanali kullues Studen (2 faza fin)	18,600,000	05.06.2023	3 muaj	14,383,270	A SHPK	9,877,648	519,876	5% garanci
19	Studime projektme Asfaltim I rruges Funeares -Zdrajsh ( Loti 3) Nj.adm. Orenje	1,057,831	05.06.2023	30 dite	1,057,831	E	1,057,831		Likujduar
20	Blerje makine korrse bari	500,000	16.06.2023	7 dite	359,760	S.A	359,760		Likujduar
21	Studime projektme per objekte te ndryshme	4,102,142	26.06.2023	30 dite	3,544,200	Z	3,544,200		Likujduar
22	Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Kokreve faza I-re Nj.Adm Hotolisht	99,884,423	11.08.2023	6 muaj	71,747,177	B	20,953,246	8,546,754	Në proces likuidimi

	(3faza fin)								
23	Ndertim i shkolles se Mesme Polis+Palester Nj.Polis(3 faza fin)		11.08.2023		15,600,687	E SHPK	7,795	2,507,165	Në proces likuidimi
24	Blerje fouristrade SUV per administraten e Bashkise	3,500,000	02.10.2023	30 dite	3,468,000	A	3,468,000		Likujduar
25	Blerje paisje inxhinierike GPS-GNSS Rover	479,887	16.10.2023	5 dite	462,000	S SHPKshpk	462,000		Likujduar
26	Permisimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara 2023(2 faza)		16.11.2023	80 dite	5,920,049	R	2,390,188	1,346,916	Në proces likuidimi
27	Rikonstruksion I terraces se godines Nj.Adm Qender	800,051	05.12.023	10 dite	714,984	R			Në proces likuidimi
28	Ndertim ure metalike hd=5m fshati Gurakuq Nj.Adm.Orenje B.Librazhd	2,604,640	21.12.2023	10 dite	2,342,367	G	1,848,439	493,928	Në proces likuidimi
29	Mbikqyrje kolaudime 2023	5,000,000			4,598,790		1,534,468	3,064,322	Sipas afateve
30	Furnizim vendosje barriere mbrojtese ne disa ruge te qytetit Librazhd	3,711,960	22.12.2022	15 dite	3,594,120	I	3,594,120		Likujduar
31	Rikonstruksion i kanaleve vaditese per vitin 2022.(2 faza)	12,000,000	05.10.2022	40 dite	11,428,050	A shpk	5,155,114	271,322	5% garanci
32	Instalim kamera sigurie ne rruget kryesore te qytetit (faza e dyte)	15,000,000	02.11.2022	60 dite	14,636,280	I	14,636,280		
33	Rikonstruksion I rruges Kraste Gizavesh bashkia Librazhd	118,206,786	08.11.2022		69,019,363	2 T shpk	27,937,089	1,470,373	5% garanci
34	Permisimi I banesave ekzistuese per komunitete e varfera dhe te pafavorizuara		08.11.2022		4,915,744	B	3,315,510	174,501	5% garanci
35	Rikonstruksion i shkalleve hyrese te bashkise Librazhd	889,894	05.12.2022	7 dite	863,352	E shpk	848,633		Likujduar
36	Pyllezime ne pyjet e bashkise Librazhd	1,200,000	13.12.2022	15.08.2024	899,880	B.Ç P.F	748,800	151,080	Ne proces
37	Bashkefinancim I TVSH FOOD HUB	4,937,486	06.12.2022	30janar 2023	4,937,486	E	1,992,580	853,963	5% garanci
	466 te likujduara						12,422,846		
	<b>Totali grant i pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura</b>	<b>610,108,650</b>			<b>492,681,068</b>		<b>294,503,694</b>	<b>38,311,324</b>	
	<b>Buxheti shtetit</b>								
1	Ndertim ujesjellesi fshati Polis Gostime Nj.Adm Polis.B.Librazhd	79,467,648	11.10.2021	5 muaj pas apr.lejes	77,721,107	M	49,723,163	2,590,693	5% garanci
2	Permisimi I banesave ekzistuese per komunitete e varfera dhe te pafavorizuara 2022 (2 faza)		08.11.2022		27,160,052	B	9,916,702	521,932	5% garanci
3	Permisimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara 2023(2 faza)		16.11.2023	80 dite	23,680,197	R	12,776,549	2,121,865	Në proces likuidimi
4	Blerje paisje Mobilierie shkolla 9-vjecare Dragostunje	1,267,692	28.12.2023	15 dite	1,239,972	K			Terhequr fondet nga ministria
5	Ndertim I shkolles se Mesme Polis+Palester Nj.Polis(3 faza fin)		11.08.2023		88,403,897	E SHPK	45,129,592	2,375,242	5% garanci
	<b>Totali transfert e kushtezuar M.linje</b>						<b>117,546,006</b>	<b>7,609,732</b>	
	<b>Totali i vitit 2023</b>						<b>412,049,700</b>		

Burimi: Bashkia Librazhd

**Tabela nr.2.** Treguesit Fiskale për vitin 2023.

Nr	Lloji i Takses ,Tarifes	Planifikimi 2023	Fakti Progresiv Janar Dhjetor2023	Realizimi në %
	<b>Te ardhura tatimore</b>			
	<b>Te ardhura nga taksat vendore</b>			
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	320,000	90,464	28
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	10,000,000	12,206,635	122
3	Taksa mbi ndertesat	16,000,000	12,424,701	78
4	Takse mbi truallin	600,000	655,002	109
5	Takse toke bujqesore	5,450,000	2,597,087	48
6	Taksa e kalim të drejtës së pronesisë	800,000	955,997	120
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture ndertimet e reja	5,100,000	2,690,398	53
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga legalizimet	3,000,000	3,710,090	124
9	Takse tabele	620,000	329,400	53
10	Takse hoteli	170,000	105,000	62
11	Taksa e regjistrimit pervitshem te automjeteve	14,500,000	13,458,035	93
12	Takse nga Renta	360,000	110,005	31
	<b>Shuma</b>	<b>56,920,000</b>	<b>49,332,814</b>	<b>87</b>
	<b>Të ardhura jo tatimore</b>			
	<b>Të ardhura nga tarifat vendore</b>			
1	Tarife pastrimi	19,000,000	17,550,712	92
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	3,500,000	2,624,392	75
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	120,000	120,000	100

4	Tarifa e shërbimit veterinar	200,000	200,000	100
5	Tarife e tregut të organizuar	1,200,000	1,080,590	90
6	Tarifa leje për tregëtim ambulator	60,000	31,000	52
7	Tarife parkimi	1,300,000	1,453,567	112
8	Tarife për dhënie licenze e certifikate transporti	500,000	703,300	141
9	Tarife për leje të drejta, vertetime, informacione	750,000	97,377	13
10	Tarife për zënie të hapsirës publike	2,150,000	1,899,860	88
11	Tarife për librat e udhëtimit të udhëtarëve brenda vendit	150,000	112,500	75
12	Tarifa për autorizime ushtrimaktiviteti, karburantret autorizime për karburantet.	2,000,000	1,400,000	70
13	Tarifa të tjera nga Urbanistika	1,650,000	554,000	34
14	Tarife për linjat ajrore dhe nentokesore	430,000	430,000	100
15	Tarife për mbetjet inerte	210,000	3,500	2
16	Tarifa për ndikimin në mjedis	7,000,000	5,777,800	83
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	100,000	71,000	71
18	Interesa kamatvonesa, taksat	1,500,000	1,727,700	115
19	Detyrimi I prapambetur nga taksat	19,000,000	15,336,887	81
	<b>Shuma</b>	<b>60,820,000</b>	<b>51,174,185</b>	<b>84</b>
	<b>Tarifa në sektorin e pyjeve dhe kullotave</b>			
1	Tarifa në Sektorin e Pyjeve	12,700,000	16,819,963	132
2	Tarifa në Sektorin e Kullotave	350,000	208,600	60
3	Tarifa nga shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet	21,500,000	14,490,127	67
4	Nga shfrytëzimi I druve të zjarrit nga fshataresia	5,600,000	2,583,000	46
5	Nga shfrytëzimi I prodhimeve të dyta pyjore, të tjera	300,000	251,002	84
6	Te ardhura nga përdorimi vertetimeve të transportit, kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	620,000	445,908	72
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor që dalin nga rrallimet	200,000	-	-
	<b>Shuma</b>	<b>41,270,000</b>	<b>34,798,600</b>	<b>84</b>
	<b>Te ardhura të tjera</b>			
1	Qera e shitje të truallit	600,000	356,720	60
2	Qera ndërtesë	370,000	469,343	127
3	Pagesa e prindërve çerdhe	1,400,000	1,515,172	108
4	Pagesa e prindërve kopesht	5,140,000	5,033,037	98
5	Detyr. të prapamb. nga kopshtet çerdhe dhe qendra ditore	916,000	317,188	35
6	Gjoha nga I.N.U.V, policia	2,250,000	184,540	8
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	75,000	26,250	35
8	Sponsorizime	-	8,015,511	
9	Te ardhurat nga shitja	-	18,200	
	<b>Shuma</b>	<b>10,751,000</b>	<b>15,935,961</b>	<b>148</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>169,761,000</b>	<b>151,241,560</b>	<b>89.09</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

**Tabela nr.3,** Likuidimi i kontratave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe detyrimi i ngjellur pa likuiduar në 31.12.2023.

Nr	NIPT	Subjekti	Adminstratori	Aktiviteti	Vendndodhja	Kontrata					Detyrimi 31.12.2023
						Nr	Date	Afati	Data e perfundimit	Vlera vjetore	
1	K...E	C	H	Mbarshtim flore	Polis	2792	18.05.2017	10 vjet	15.05.2027	-	-
2	K...A	P	R.B	Shesh depozitimi	Vulçan	4068	14.07.2016	8 vjet	13.07.2024	63,870	-
3	L...N	CH	M.M	Komp.pularie	She Dragostunj	3735	27.06.2017	9 vjet	27.06.2026	83,500	-
4	L...T	L	L.F	Hec	Spathar	129	25.02.2013	9 vjet	24.02.202	197,519	-
5	K...E	D	SH.G	Hec	Zalli Okshtunit	4663	21.07.2017	10 vjet	23.06.2027	2,410,000	-
6	K...Q	C	H.GJ	Hec	Zalli Rrapunit	11-Jan	09.01.2015	9 vjet	08.01.2024	1,021,410	-
7	L...F	E	M.A	Hec	Kuturman	2470	15.05.2018	9 vjet	14.05.2027	816,900	-
8	K...O	G	A.XH	Hec	Polis	5873	14.10.2016	9 vjet	13.10.2025	539,632	-
9	K...T	D	I.M	Hec	She Dragostunje	2063	04.04.2019	9 vjet	03.04.2028	828,800	-
10	K...N	D	I.C	Hec	POLEMI Kostenje	5006	08.08.2017	10 vjet	07.08.2027	623,100	1,246,200
11	J...K	G SHPK	J.D	Hec	VARDARI Mexixe	5006/1	08.08.2022	5 Vjet	07.08.2027	540,700	-
12	K...T	G	I.G	Hec	Prevalli	5852	04.10.2017	10 vjet	04.10.2027	444,910	-
13	J...N	O	A.A	AnteneCelulare	Stebleve	4672	18.09.2018	9 vjet	22.07.2027	361,000	361,000
14	L...S	H.B	H.B	Vep.Turistike	Fushe Studen	7588	17.12.2018	10 vjet	06.12.2028	82,000	-
15	J...D	R.R	R.R	Agropylltari	Dardhe	7444	07.12.2018	10 vjet	06.12.2028	2,000	-
16	L...M	A.H	A.H	Akuakulture	Xhyre	7461	11.12.2018	10 vjet	06.12.2028	38,000	-
17	L...M	A.H	A.H	Akuakulture	Xhyre	49	06.01.2020	10 vjet	26.11.2030	37,900	-
18	K...T	R Shpk	B.L	Hec	Hotolisht	6704	26.10.2018	10 vjet	26.10.2028	284,650	-

19	L...U	B.L V.M	B.L V.M	Agropylltari	Zdrajsh	511	01.02.2019	10 vjet	30.01.2029	112,000	224,000
20	L...N	A.B	A.B	Vep. Turistike	Llangë,Turistike	514	01.02.2019	10 vjet	30.01.2029	135,000	-
21	K...D	A.H	A.H	Pikëgrumbull	RrapunLibrazhd	515	01.02.2019	10 vjet	30.01.2029	15,500	15,500
22	K...A	K	A.J	Hec	Mirake	998	12.02.2019	10 vjet	08.02.2029	311,160	-
23	L...H	S.SH	S.SH	Agropylltari	Gurakuq	2406	23.04.2019	10 vjet	23.04.2029	28,800	-
24	L...H	S.SH	S.SH	Agropylltari	Gurakuq	529	03.02.2020	9 vjet	03.02.2029	85,000	-
25	L...P	S.RR	S.RR	Agropylltari	Dardhë	2407	23.04.2019	10 vjet	23.04.2029	10,000	-
26	L...J	H.M	H.M	Pikë grumbullimi	Zgosht	2408	23.04.2019	10 vjet	23.04.2029	5,000	-
27	F...V	I.B	I.B	Vep. Turistike	Dragostunje	526	03.02.2020	9 vjet	03.02.2029	47,250	-
28	L...K	E.A	E.A	Vep. Turistike	Mirake	527	02.02.2020	9 vjet	03.02.2029	24,750	-
29	L...G	L Grup	S.K	Vep. Turistike	Togëz	528	03.02.2020	9 vjet	03.02.2029	41,250	7,500
30	M...G	B.K	B.K	Vep.Turistike	Kuturman. ng.89a	2919	14.07.2020	10 vjet	14.07.2030	23,100	-
31	K...C	E Shpk	B.P	Vep.Turistike	Polis. ng.147b (1-2)	2954	15.07.2020	10 vjet	13.07.2030	22,325	-
32	M...L	R.T	R.T	Vep.Turistike	Polis. ng. 147b (3)	2955	15.07.2020	10 vjet	13.07.2030	8,250	-
33	L...M	G.P	G.P	Vep.Turistike	Polis.ng. 148b (2)	3035	17.07.2020	10 vjet	15.07.2030	10,775	-
34	K...H	A.B	A.B	Vep. Turistike	Polis, ng.152b	3062	21.07.2020	10 vjet	15.07.2030	8,250	-
35	L...F	E	E.A	Linja Hec Kalis	Kuturman	4691	26.10.2020	10 vjet	26.10.2030	241,230	-
36	M...C	S.F	S.F	Qellime pushimi etj	Bushtricë	5614	09.12.2020	10 vjet	26.11.2030	8,250	9,000
37	L...D	I.P	I.P	Agropylltari	Xhyre	639	03.02.2021	10 vjet	03.02.2031	6,500	-
38	K...N	H.Ç	H.Ç	Vep.Turistike	Xhyre	641	03.02.2021	10 vjet	03.02.2031	318,600	-
39	K...A	P.N	P.N	Vep. Turistike	Hotolisht	640	03.02.2021	10 vjet	03.02.2031	110,500	-
40	K...T	C&S ,1 2	A.C	HEC	Rrapun Librazhd	7229	23.11.2018	10 vjet	23.11.2028	932,280	-
41	M...U	I Grup	I.B	Vendosje antene	Fushe Studen	1926	31.03.2021	10 vjet	28.03.2031	8,000	-
42	M...Ë	A.B	A.B	Agropylltari	Funares	1925	31.03.2021	10 vjet	23.03.2031	12,500	-
43	L...G	A.T	A.T	Shesh depozitimi	Mirake	2660	12.05.2021	10 vjet	12.05.2031	33,000	-
44	L...E	Illir Cota	I.C	Vep.Turistike	Librazhd	2662	12.05.2021	10 vjet	12.05.2031	38,000	-
45	J...S	S Shpk	K.S	Vep.Turistike	Dardhe	2664	12.05.2021	10 vjet	12.05.2031	110,000	-
46	J...Q	A Shpk	SHA	Vep.Turistike	Funares	2661	12.05.2021	10 vjet	12.05.2031	66,000	-
47	M...G	O.B	O.B	Vep.Turistike	Dardhe	2663	12.05.2021	10 vjet	12.05.2031	9,300	-
48	K...L	V	A.K	Antene Celulare		5353	20.11.2020	10 vjet	26.09.2029	340,000	-
49	M...B	B.D	B.D	Vep. Industriale	Librazhd. ng. 166a	3061	21.07.2020	10 vjet	15.07.2030	15,000	45,000
50	L...P	K Shpk	B.H	Vep.turistike	Fushe Studen	1165	25.02.2021	10 vjet	10.02.2031	12,375	36,750
51	J...N	O	B.A	Antene Celulare	Librazhd Qender	212	15.04.2022	10 vjet	15.04.2032	203,500	203,500
52	M...C	A.M	A.M	FERMER	POLIS	4283	26.09.2022	10 vjet	22.09.2032	24,750	-
53	M...C	A.M	A.M	FERMER	POLIS	4284	26.09.2022	10 vjet	22.09.2032	30,000	-
54	J...S	S Shpk	Kol S	Kend lojrash	Dardhe-Xhyre	4332	28.09.2022	10 vjet	28.09.2032	143,000	-
55	L...L	A.B	A.B	pike tranziti	Polis	4282	26.09.2022	10 vjet	26.09.2032	15,000	-
56	K...R	A.B	A.B	Agropylltari	Librazhd	4311	27.09.2022	10 vjet	27.09.2032	6,800	-
57	M...Ë	H.M	H.M	FERMER	cermenike	4307	27.09.2022	10 vjet	27.09.2032	10,000	-
58	M...A	N.ZH	N.ZH	Vep Turistike	Polis	4310	27.09.2022	10 vjet	26.09.2032	16,500	-
59	L...T	A.RR	A.RR	Pik Tranziti	Polis	4486	07.10.2022	10 vjet	07.10.2032	20,500	-
60	M...E	A.C	A.C	Vep Turistike		4312	26.09.2022	10 vjet	26.09.2032	85,500	-
61	M...H	Y	B	Vep Turistike	Polis	4309	27.09.2022	10 vjet	26.09.2032	57,750	57,750
62	M...O	Y	I	Vep Turistike	Polis	4478	14.10.2022	10 vjet	27.09.2032	57,750	-
63	L...N	E	M	Vep Turistike	Klenje	4273	26.09.2022	10 vjet	25.09.2032	110,000	-
64	H...Q	D	B	Kullote	Librazhd	5064	08.11.2022	10 vjet	08.11.2032	170,000	-
65	M...N	A	Q	Vep Turistike		5098	10.11.2022	10 vjet	27.09.2032	10,000	-
66	K...N	O sha	S.D		Kuturman	4825/1	26.10.2022	1 VIT	26.10.2022	579,520	-
67	E	P.B	H	Egnatia Shushice		2449	29.04.2021	10 vjet	2449	2,052,825	-
68	F...V	I.B	I.B	Vep Turistike	Librazhd	694	06.02.2023	10 vjet	06.02.2033	82,500	-
69	M...A	XH.K	XH.K	Vep Turistike	Klenje	696	06.02.2023	10 vjet	06.02.2033	16,500	-
70	M...S	C Shpk	R.X	Vep Turistike	Klenje 2	3946	06.06.2023	90000	06.06.2033	90,000	-
71	M...S	C Shpk	R.X	Vep Turistike	Klenje 3	3947	06.06.2023	120000	06.06.33	120,000	-
72	M...R	M SHPK	A.B	Vep Turistike	Klenje 2	3920	05.06.2023	10 vjet	05.06.2023	128,900	-
73	M...P	G.A		Vep Turistike	Polis	4147	15.06.2023	10 vjet	15.06.2023	8,500	-
		<b>TOTALI</b>								<b>15,565,631</b>	<b>2,206,200</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

**Aneksi nr.4 – Mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit trajtuar nga faqja nr.33 deri në faqen nr.36 të Raportit të Auditimit.**

Tabela nr.1, VKM nr 1108 datë 30.12.2015, Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë të Bashkia të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë të Bashkia e infrastrukturës së ujëtjes dhe kullimit				
Bashkia	Skema ujites, kod	Emertimi	Burimi ujqor	Kanale të para dhe të dytë km
Librazhd	LB-XH-U-2	Rezervuar Vehcan	Burime	2
Librazhd	LB-PI-U-4	Kanali Vilez	Burime	3.5
Librazhd	LB-H-U-12	Hotolisht	Burime	3
Librazhd	LB-H-U-11	Rezervuari Dardhe	Burime	1
Librazhd	LB-DO-U-9	Rezervuar Librazhd Katund	Burime	1.5
Librazhd	LB-LU-U-9	Kanal Polen	Lumi Shkumbin	6
Librazhd	LB-LE-U-1	Kanali Letem	Burime	12
Librazhd	LB-B-U-6	Kanali I Vogel	Burime	0.5
Librazhd	LB-PO-U-7	Kanali Doci	Lumi Shkumbin	1
Librazhd	LB-DO-U-2	Kanali Allani	Lumi Shkumbin	13
Librazhd	LB-Z-U-6	Kanali Gurre Mushare	Burime	2
Librazhd	LB-O-U-1	Kanali Gurre Madhe	Burime	6
Librazhd	LB-Q-U-6	Kanali Peshtan	Burime	6
Librazhd	LB-H-U-7	Kanali Gurre	Lume	5
Librazhd	LB-D-U-7	Kanali Tjere	Burime	2.2
Librazhd	LB-PO-U-6	Kanali Gostime Gjere	Perroi Gostime	0.9
Librazhd	LB-PO-U-8	Kanali Quksi	Perroi Rrajces	8
Librazhd	LB-PO-U-10	Kanali C	Burime	1
Librazhd	LB-DO-U-1	Kanali Rine	Perroi I Qarrishtes	21
Librazhd	LB-DO-U-3	Kanali Mezi	Perroi I Qarrishtes	9
Librazhd	LB-DO-U-6	Kanali Madh	Burime	1
Librazhd	LB-DO-U-8	Kanali Lize	Burime	0.6
Librazhd	LB-LU-U-6	Kanali Roc	Lume	0.5
Librazhd	LB-LE-U-4	Kanali Uljat	Lume	1
Librazhd	LB-LE-U-6	Kanali Mali	Burime	7
Librazhd	LB-LE-U-7	Kanali Ligate	Burime	0.5
Librazhd	LB-K-U-1	Kanali Kuturman	perroi Gurakuqit	8
Librazhd	LB-Z-U-3	Kanali Gurre Gege	Burime	3
Librazhd	LB-H-U-6	Kanali Ferre	Burime	6.5
Librazhd	LB-LU-U-1	kanali Alimane	lume	0.9
Librazhd	LB-B-U-7	Kanali Pulze	Burime	1
Librazhd	LB-ST-U-2	Kanali Gropa Madhe	burime	6
Librazhd	LB-XH-U-3	Kanali Kobile	Lume	0.6
Librazhd	LB-H-U-5	Kanal i Verri	Burime	0
Librazhd	LB-H-U-9	Kanali Tjere	Burime	1.2
Librazhd	LB-D-U-4	Kanali Spathar	Burime	3.71
Librazhd	LB-D-U-5	Kanali Mali	Burime	27
Librazhd	LB-D-U-6	Kanali Kuqes	Burime	1
Librazhd	LB-PO-U-5	Kanali Zabel	Burime	0.8
Librazhd	LB-G-U-1	Kanali Myzyr	Burime	1.5
Librazhd	LB-G-U-4	Kanali Muzhaqi	Burime	1
Librazhd	LB-G-U-5	Kanali Xhevari	Burime	1
Librazhd	LB-LU-U-4	Kanali Gurre Zeze	Burime	3
Librazhd	LB-LU-U-8	Kanali Isuf	Lume	0.5
Librazhd	LB-LE-U-2	Kanali Zgosht	Burime	12
Librazhd	LB-LE-U-5	Kanali Katund	Burime	2
Librazhd	LB-K-U-4	Kanali Mulli	Lume	0.6
Librazhd	LB-Z-U-4	Kanali Gures 1	Lume	4
Librazhd	LB-Z-U-5	Kanali Gurre Shterpe	Burime	5
Librazhd	LB-Z-U-7	Kanali Mezit	Peroi Rapun	10
Librazhd	LB-Z-U-8	Kanali Kace	Burime	2
Librazhd	LB-SO-U-1	Kanali Gaferi	lume	4
Librazhd	LB-SO-U-2	kanali Sopot	burime	6
Librazhd	LB-H-U-2	Kanali Roc	burime	1.1
Librazhd	LB-H-U-3	Kanali Zall	lume	1.5
Librazhd	LB-H-U-4	Kanali Verbe	Burime	1
Librazhd	LB-PO-U-11	Kanali I Gjeres	Lume	2.5
Librazhd	LB-G-U-2	Kanali Noni	Burime	4
Librazhd	LB-DO-U-4	Kanali Rapun	Lume	7
Librazhd	LB-DO-U-5	Kanali Katrafil	Burime	1.2
Librazhd	LB-LU-U-3	Kanali Fush Mal	Burime	1.5
Librazhd	LB-LU-U-5	Kanali Gurre Lushe	Burime	1
Librazhd	LB-LU-U-7	Kanali Tusku	Lume	1
Librazhd	LB-K-U-2	Kanali Ologut	Burime	1.2
Librazhd	LB-K-U-3	Kanali Zallit	lume	6.5
Librazhd	LB-O-U-2	Kanali Suli	Burime	1
Librazhd	LB-O-U-5	Kanali Sane	lume	0.5
Librazhd	LB-GU-U-1	Kanali Ballgjin	Burime	0.8
Librazhd	LB-GU-U-3	Kanali Alimete	lume	2
Librazhd	LB-LU-U-2	Kanali Aligjete	Burime	1
Librazhd	LB-H-U-8	Kanali Stalle	Burime	0.8
Librazhd	LB-PO-U-4	Kanali Minil	Burime	1.2
Librazhd	LB-PO-U-9	Kanali Ballolli	lume	1
Librazhd	LB-DO-U-7	Kanali Arrze	Burime	0.8

Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë të Bashkia e infrastrukturës së ujërës dhe kullimit				
Librazhd	LB-LE-U-3	Kanali Mire	lume	0.7
Librazhd	LB-O-U-4	Kanali Gjinit	Burime	1
Librazhd	LB-GU-U-2	Kanali Lari	Burime	0.6
Librazhd	LB-GU-U-5	Kanali Elezi	lume	3
Librazhd	LB-GU-U-3	Kanali Cani	Burime	1
Librazhd	LB-GU-U-4	Kanali KNoshe	Burime	1
Librazhd	LB-B-U-2	KU.St.Gurre	Lum Shkumbin	5.5
Librazhd	LB-XH-U-1	KU St Xhyre	Lum Shkumbin	9
Librazhd	LB-H-U-10	KU St Hotolisht	Lum Shkumbin	1
Librazhd	LB-D-U-1	KU St Spathar	Burime	8
Librazhd	LB-H-U-10	KU ST Hotolisht	Lum Shkumbin	1
Librazhd	LB-D-U-1	KU St Spathar	Burime	8
Librazhd	LB-D-U-2	KU St Librazhd	Lum Shkumbin	0

Burimi: Bashkia Librazhd

Tabela nr. 2, VKM nr 847 date 28.10.2020 sipas listës bashkangjitur

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr. Pasurisë	Sipërfaqia sipas V.K.M.		Dt./nr. aplikimit	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Sipërfaqia sipas Faktit	
				Truall	Ndert			Truall	Ndert
1	Pyll (Zabzun) Nja.Stebleve	38 69	1093/1	5450 m2			19.04.2023	5450 m2	
2	Pyll (Zabzun) Nja Stebleve	38 69	1093/2	167203 m2			19.04.2023	167203m2	
3	Kullote (Zabzun) Nja. Stebleve	38 69	1072/3	69550 m2			19.04.2023	69550 m2	
4	Kullote (Zabzun) Nja. Stebleve	3869	1072/4	4523723 m2			19.04.2023	4523723 m2	
5	Kullote (Zabzun) Nja. Stebleve	38 69	1072/5	2000 m2			24.06.2023	2000 m2	
6	Kullote (Zabzun) Nja. Stebleve	38 69	1072/6	4521723 m2			24.06.2023	4521723 m2	
7	Pyll (Dardhe ) NJA Hotolisht	14 43	572	54240 m2			29.06.2023	54240 m2	
8	Pyll (Dardhe ) NJA Hotolisht	14 43	574	372787 m2			29.06.2023	372787 m2	
9	Pyll (Dardhe ) NJA Hotolisht	14 43	574/1	4500 m2			29.06.2023	4500 m2	
10	Pyll (Dardhe ) NJA Hotolisht	14 43	574/2	369060 m2			29.06.2023	369060 m2	
11	Pyll (Dardhe ) NJA Hotolisht	14 43	572/1	5500 m2			29.06.2023	5500 m2	
12	Pyll (Dardhe ) NJA Hotolisht	14 43	572/2	48740 m2			29.06.2023	48740 m2	
13	Pyll (Dragostunje) Nja Qender	15 27	554	189764 m2			05.01.2023	189764 m2	
14	Pyll (Dragostunje) Nja Qender	15 27	554/1	5000 m2			05.01.2023	5000 m2	
15	Pyll (Dragostunje) Nja Qender	15 27	554/2	10000 m2			05.01.2023	10000 m2	
16	Pyll (Dragostunje) Nja Qender	15 27	554/3	174764 m2			05.01.2023	174764 m2	
17	Pyll (Kuturman) Nja Qender	23 51	2973	16446 m2			06.01.2023	16446 m2	
18	Pyll (Kuterman) Nja Qender	23 51	2975	41945 m2			06.01.2023	41945 m2	
19	Pyll (Babje) Nja Qender	10 63	659/2	382225 m2			31.03.2023	382225 m2	
20	Pyll (Babje) Nja Qender	10 63	659/1	2000 m2			31.03.2023	2000 m2	

Burimi: Bashkia Librazhd

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETI